



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
Psikologji me profil: Psikologji Klinike**

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As.Dr. Valentina Haxhiymeri

Prof. Dr. Aliriza Arënliu

Shkurt / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master i Shkencave në: Psikologji me profil: Psikologji Klinike

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në: Psikologji me profil Psikologji Klinike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKA Nr. 295, datë 20.12.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i II- të
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2021- 2022 8 PAE /6 PAK Mbulimi i ngarkesës mësimore rezulton: 55 % PAE /45 % PAK
18	Numri i studentëve:	- 2020 - 2021: 35 studentë; - 2021 - 2022: 39 studentë;
19	Komente / të tjera:	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është institucion publik i arsimit të lartë, hapur me Vendim nr.207, datë 30.05.1957 të Këshillit të Ministrave. Përgjatë viteve, ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh kryesisht në strukturën e tij. Pavarësisht kësaj, UT mbetet institucioni i arsimit të lartë më i madh në vend. UT është akredituar institucionalisht me Vendim nr. 84, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 4 vite. Afati i vlefshmërisë së akreditimit institucional përfundon në 26.10.2022.

Fakulteti i Shkencave Sociale, ku ofrohet programi i studimit i marrë në vlerësim është pjesë përbërëse e strukturës akademike të Universitetit të Tiranës. Fillimisht, ky fakultet është hapur me VKM nr. 348, datë 31.07.1992 me emërtim “Fakulteti i Punës Sociale”. Në vitin 1993, me Urdhër nr.18 date 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, fakulteti emërtohet “Fakulteti i Shkencave Sociale” duke përfshirë në strukturën e tij edhe departamentin e “Psikologjisë dhe Pedagogjisë”.

Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike është hapur në vitin 2008, me VKM nr. 1246, datë 10.09.2008 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë pranë Universitetit të Tiranës, në vitin akademik, 2008-2009”, me emërtim fillestar “Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve”, me 120 kredite, me kohëzgjatje normale të studimeve dy vite akademike, dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND.

Referuar Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 295, datë 20.12.2011, Këshilli i Akreditimit bazuar në kompetencën që i jep Ligji nr. 974, datë 21.05.2007, Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ka rekomanduar Ministrin të Arsimit dhe Shkencës hapjen e programit Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Klinike, ofruar nga Universiteti i Tiranës. Institucioni nuk disponon Urdhër të MASH për licensimin e këtij program studimi.

Sipas Urdhërit të MASH, nr. 297, datë 20.07.2012, me nr. 3917/1 Prot., “Për regjistrimin e formës së diplomave të programeve të studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” të UT”, ku urdhërohet se “... në zbatim të Udhëzimit nr. 12, datë 18.03.2009 “Për krijimin e Regjistrimit Shtetëror dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, (i ndryshuar) për FSHS, kërkohet regjistrimi i formës së diplomës së këtij program studimi si “Master i Shkencave” në Psikologji, me profil në “Psikologji klinike” (fq. 5).

Bazuar në informacionin e dhënë verbalisht nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, gjatë vizitës në institucion, datë 20.07.2022, mësohet se në vitin 2017, si rrjedhojë e nismës për riorganizimin e programeve të studimit, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 të AL, zhvillimet shkencore dhe kërkesat e tregut të punës për shërbime psikologjike, programi i studimit mori emërtimin aktual. Përgjatë viteve programi ka pësuar ndryshime në kurrikul, me synim përshtatjen e lëndëve formuese me kërkesat e nevojave të tregut dhe për të përditësuar kurset me zhvillimet shkencore të kësaj fushe studimore në Evropë dhe më gjerë.

Programi i studimeve Master i Shkencave në Psikologji Klinike, është program i ciklit të dytë të studimeve universitare, i klasifikuar në nivelin 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të

Kualifikimeve. Programi përman 120 kredite ECTS, zhvillohet me një kohëzgjatje 2 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë. Oferta akademike e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike ka për mision formimin e psikologëve të ardhshëm klinikë, të pajisur me:

- dije të avancuara në teoritë dhe shprehjet klinike psikologjike, si dhe metodat e kërkimit;
- aftësitë për të kuptuar dinamikat psikologjike individuale, familjare dhe grupore;
- aftësitë për të aplikuar dijen e avancuar psikologjike ndaj problemeve të shëndetit mendor;
- aftësitë e duhuara në mënyrë që ata të jenë në gjëndje të ndjekin karrierë në sektorin publik, privat, si dhe në sektorin jofitimprurës,
- një themel solid akademik në mënyrë që ata të jenë të suksesshëm në ndjekjen e studimeve doktorale, pas përfundimit të programit Master i Shkencave (*dokumenti "Strategjia e zhvillimit të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike" (2020-2024), seksioni III "Vizioni/Misioni", fq. 5*);

Programi studimeve i ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike, ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë Psikologji i cili vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore në fushën e psiko-pedagogjisë, në përbërje të Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës (*sipas Statutit të UT, 2018, Kreu II "Organizimi dhe strukturat përbërëse", Neni 11 "Njësitë përbërëse të UT", Pika 2, fq. 7*).

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, në FSHS, të UT, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i kontraktuar nga ASCAL.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim profesional, të pavarur dhe objektiv, të bazuar në tregues real dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, mbi të cilin do të ngrihet gjykimi i Bordit të Akreditimit të ASCAL për akreditimin e tij. ASCAL bazuar në *"Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017"*, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.As.Dr. Valentina Haxhiymeri dhe Prof. Dr. Aliriza Arënliu. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Vizita u realizua në datat 20 dhe 21 Korrik 2022. Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije përmes trajnimeve paraprake nga specialistë të sektorit përkatës të ASCAL. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të

jashtëm për programin e studimit të ciklit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, në FSHS, të UT, është:

- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- “Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë” miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021,
- “Raporti i Vlerësimit të Brendshëm” (mars, 2022);
- Dosja e VV me një tërësi të dispozitave normative, akteve dhe dëshmime të ngarkuara nga IAL në e-ASCAL, si dhe të dhëna të tjera të siguruara nga vizita në institucion, ushtruar në datat 20 dhe 21 korrik, 2022, sipas një agjende të paracaktuar nga ASCAL, dhe informacioni i publikuar në faqen e webit-it të IAL-së.



Parimet kryesore që udhëhoqën veprimtarinë e GVJ janë:

- Qëndrim korrekt, pa paragjykime dhe plot respekt ndaj drejtuesve të IAL-së, stafit, studentëve dhe përpjekjes së tyre për të arritur standardet dhe cilësinë e dëshiruar;
- Bashkëpunim i singertë, nën frymën e besimit reciprok, për të siguruar një vlerësim të paanshëm, real, të mbështetur në dëshmi dhe tregues të matshëm të cilësisë;
- Objektivitete në shqyrtimin dhe prezantimin e rezultateve të vlerësimit të jashtëm lidhur me nivelin e arritjes së standardeve dhe cilësisë;
- Transparencë për të mundësuar një proces konstruktiv të rishikimit të RVJ përpara publikimit të tij.

Për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të jashtëm, kontribuan jo vetëm ekipi i caktuar nga ASCAL, por edhe autoritetet drejtuese, stafi dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, të FSHS, në UT, për të cilët GVJ shpreh vlerësime të posaçme për gatishmërinë dhe frymën e bashkëpunimit të treguar, si dhe për sensin e mirëkuptimit dhe besueshmërinë që ata i dhanë GVJ, duke vënë në dispozicion të tyre dokumentacionet e nevojshme për vlerësim.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 06.01.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/4 Prot, datë 06.01.2023. Universiteti i Tiranës më datë 25.01.2023, njofton me anë të shkresës Nr. 45/3 Prot, datë 24.01.2023, “Mbi Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimit Bsc në “Psikologji” dhe Msc në “Psikologji, me profil Psikologji Klinike”.

Referuar shkresës së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Tiranës, me Nr. 45/3 Prot., datë 24.01.2023, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në përgjigje të procesit të rishikimit të përmbajtjes së Draft/Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil Psikologji Klinike, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi me vëmendje të posaçme momentet e diskutueshme të përshkruara në këtë shkresë dhe konkludoi si më poshtë:



1. GVJ sqaron se rekomandimi përkatës lidhur me Standardin II.2, kriteri 3, është bazuar në shqyrtimin e të dhënave të pasqyruara në dokumentin (Evidenca 81/4.6 Te dhenat tabelore per personelin akademik te programit te studimit.pdf, tabela 12.1 dhe 12.2, fq. 26-27), për personelin akademik (PAE dhe PAK) të anagazhuar për mbulimin e lëndëve / realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Të dhënat tregojnë se për realizimin e këtij programi studimi janë përfshirë PAK jo vetëm tituj akademik dhe gradë shkencore, por edhe me nivel kualifikimi MSc. Në këtë kuadër, GVJ sugjeron që të respektohet Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59 i tij “Për kategoritë e personelit akademik”, Pika 6, ku specifikohet se: *Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës*. **Rekomandimi i GVJ për këtë çështje mbetet i pandryshuar.**
2. GVJ sqaron se rekomandimet përkatëse lidhur me Standardin II.5, kriteri 2, janë bazuar në shqyrtimin e të dhënave të pasqyruara në (dokumentin nr. 81/4.6 Te dhenat tabelore per personelin akademik te programit te studimit, në veçanti tabelave përmbledhëse të këtij dokumenti, si dhe Materialin nr. 11, ngarkesa mesimore 21-22 MSC Klinik.docx, Seksioni “Vizita dy ditore në IAL, dhe domumentacioni shtesë, e-ASCAL). **GVJ vendos që të mbeten të pandryshuara rekomandimet** lidhur me përmbushjen e Standardit II.5, kriteri 2.
3. GVJ sqaron se sugjerimi përkatës lidhur me Standardin III.3, kriteri 4, është bazuar në shqyrtimin e programeve lëndore të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (Materiali 99/5.3 Programet mesimore te lendeve, e-ASCAL). Në këtë kuadër, GVJ ka konstatuar se “një pjesë e syllabuseve kanë nevojë të përditësojnë literaturën duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse kryesisht të 5 viteve të fundit. Gjithashtu, janë vërejtur raste kur literatura e rekomanduar dominohet kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze dhe ofrohet për studentët me një numër të jashtëzakonshëm titujsh për studim, p.sh, 57 tituj/ për lëndë ose 82 tituj/për lëndë, ku shumica është në gjuhë të huaj angleze. (Materiali 78/4.3, Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, fq. 27-30; 42-45; e-ASCAL). Prandaj, GVJ këshillon institucionin që të konsiderojë këtë rekomandim me përmbajtjen si vijon: *Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë fondin e të librave (fizik dhe elektronik) që numëron aktualisht biblioteka e institucionit, GVJ sugjeron që të rritet përpjekja e përbashkët e stafit akademik për të siguruar përditësimin në vazhdimësi të literaturës bazë dhe ndihmëse në syllabuset lëndore, si dhe t`ju vihet në dispozicion studentëve në gjuhën e programit të studimit.* (Standardi III.3, kriteri 4).
4. Përsa u përket sugjerimeve/rekomandimeve të tjera të renditura në shkresën me Nr. 45/3 Prot., datë 24.01.2023 të IAL-së, vërehet se institucioni pranon nevojën për përmirësimin e tyre dhe deklaron se është angazhuar në procese vetëpërmirësimi.

Së fundi, duke vlerësuar si serioz dhe të dobishëm angazhimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Tiranës/Fakultetit të Shkencave Sociale në procesin e rishikimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, grupi i vlerësimit i uron suksese të mëtejshme në përpjekjen e tij për të përmirësuar cilësinë dhe arritur standardet e dëshiruara.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në, Psikologji, me profil: Psikologji Klinike

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti i Tiranës është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi në përputhje tërësore me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare. Në Statutin e UT (2018), Neni 5 i tij “Misioni”, deklarohet se “ <i>Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron një gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tre shtyllave të misionit të arsimit të lartë: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut...</i> ”. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë (DPP), në FSHS, të UT-së, është në përputhje me interesat kombëtare, me Ligjin Nr.80/2015 “ <i>Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë</i> ”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij. Sipas “ <i>Kornizës konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i> ”, programi ka si objektiv përgatitjen e psikologëve të ardhshëm klinikë “ <i>me aftësi dhe shkathtësi specifike, për t’u përballur dhe trajtuar një gamë të gjerë çështjesh klinike... të pajisur me aftësi të kërkimit shkencor cilësor dhe sasior që i lejon ata të thellojnë më tej studimet e tyre, si dhe me kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional në bashkëveprim me profesionistët e tjerë në fushën e shëndetit mendor</i> ”. (Dokumentit 76/4.1 Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL, fq.3)

	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike, i referohet nivelit 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimeve të ofruara nga UT, përfshi edhe programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky synim gjen shprehje në dokumentin “Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2018-2023”, seksioni “Mësimdhënia dhe Studentët”, ku mes të tjerash, theksohet se “Programet e studimit në UT kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin e konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor...”, si edhe në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë, 2020-2024”, ku shprehimish thuhet se “Në programet e ofruara, DPP është përpjekur të përshtasë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, si dhe të praktikojë modelet më të mira kurrikulare të vendeve perndimore” (fq.7).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin, si dhe fushën e veprimtarisë së UT-së, Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë (DPP). Ky kriter pasqyrohet qartë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statutin e UT (2018), Neni 5 i tij “Misioni”, ku mes të tjerash, IAL delaron se “Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxisim rritjen personale dhe intelektuale për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale” (fq.3); - Dokumentin “Strategjia e zhvillimit të FSHS, 2018-2023”, ku përshkruhet se “FSHS ka si mision që nëpërmjet ndërthurjes së mësimdhënies cilësore me kërkimin shkencor dhe shërbimet, të përgatisë specialistë të aftë, të pajisur me dije, aftësi dhe qëndrime që mund të marrin vendime të përgjegjshme në një botë diverse dhe që ndryshon; qytetarë me një perspective globale që mendojnë në mënyrë kritike,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kanë përgjegjësi sociale, që pranojnë diversitetin dhe synojnë të ushtrojnë ndikim në zhvillimin e shoqërisë; t'i shërbejnë komunitetit akademik dhe shoqërisë si një burim informimi për shkencat sociale duke adresuar çështje me interes të përbashkët” ;

- Dokumentin “Strategjia e zhvillimit të DPP, 2020-2024”, ku theksohet se nëpërmjet programeve të studimit të ofruara “DPP synon të përgatisë jo vetëm profesionistë të kualifikuar në fushën e kërkimeve psikologjike, por edhe studentë të përgjegjshëm e të kulturuar të një shoqërie që reflektojnë vlerat më të larta, morale dhe etike, në shërbim të shoqërisë, të zhvillimit cilësor dhe të qëndrueshëm të vendit”.
- Kornizën konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në “Psikolog Klinik”, Pika 2, e tij theksohet se “Parimet dhe kërkesat themelore të programit burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, Statuti dhe rregullore të UT në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe specifikisht të shprehura në formimin e psikologëve klinikë” (fq.2).
- Dokumentin “Rregullore e programit Master i Shkencave në “Psikolog Klinik” (2019), Neni 6 “Misioni i MSH-PK”, ku theksohet se MSH ka si mision:
 - a) Ofrimin e dijeve të integruara me qëllim që të aftësojë studentët të ofrojnë shërbime bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si intervistim, vlerësim, përshkrim klinik dhe diagnostikim, hartim i planeve të trajtimit dhe ofrimi i terapive, apo ndërhyrjeve specifike për problematika dhe grupmosha të ndryshme;
 - b) Zhvillimin e aftësive për të punuar në ekipe multidisiplinare , apo për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të shëndetit mendor, duke koordinuar dijet dhe ekspertizën në funksion të adresimit profesional dhe efektiv të të problemeve të shëndetit mendor’
 - c) Zhvillimin e aftësisë për të kuptuar dhe përdorur rezultatet e kërkimeve shkencore bashkëkohore në

<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>fushën e psikologjisë klinike, si dhe për të hartuar dhe udhëhequr studime në fushë (fq.3).</p>
	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. Hapja e programit në vitin 2008, me emërtim fillestar “<i>Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve</i>” (DND), dhe më pas riemërtimi i tij si Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, është paraprirë nga analiza e tregut të punës mbi nevojat për psikologë klinikë. Në vizitën në institucion, GVJ mësoi se përgjatë viteve programi i studimit, ka pësuar ndryshime jo vetëm në emërtim, por edhe në kurrikul, me synim përshtatjen e lëndëve formuese me kërkesat e nevojat e tregut dhe zhvillimet shkencore të kësaj fushe studimore në Evropë dhe më gjerë. Referuar dokumentit “Strategjia e zhvillimit të FSHS, 2018-2023” vërehet se një nga drejtimet e zhvillimit strategjik të institucionit është “Zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të studimit në përgjigje të kërkesave të tregut të punës” (fq.7). Në dokumentin “<i>Strategjia e zhvillimit të DPP, 2020-2024, Prioriteti IV, Obejktivi 8</i>”, njësia bazë ka shpallur si objektiv strategjik “Rishikimin e kurrikulave me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal ...” (fq.8).</p> <p>Në dokumentin “<i>Strategjia e zhvillimit të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i>” (2020-2024), seksioni III “Vizioni”, përshkruhet se “Oferta akademike e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave Psikologji, me profil: Psikologji Klinike është konceptuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndihmojë studentët në zhvillimin e njohurive shkencore dhe aftësive të nevojshme për t’u bërë profesionistë të zotë në një shoqëri që është gjithnjë në ndryshim; - të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkenctarë të rinj në fushën e psikologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të shkencës në arsimin e lartë; - të krijojë një ambjent, i cili inkurajon kërkimin rigoroz shkencor psikologjik dhe të integrojë kërkimin shkencor në mësimdhënien;

	<p>- të kontribuojë në shërimin e plagëve psikologjike të individit, familjes dhe shoqërisë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;</p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor.</p> <p>Referuar dokumentit “Kornizës kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike”, çështja 4 “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve”, mësohet se “Programi i studimeve, është program studimesh universitare i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite. Lëndët mësimore janë përzgjedhur nga disa fusha studimi të psikologjisë, si: Metodatat e kërkimit shkencor; Vlerësimi dhe trajtimi i çrregullimeve të ndryshme; Praktikumet në zhvillimin e aftësive klinike; Njohja e thelluar e teorive në fusha të ndryshme si trauma, llojet e ndryshme të terapive individuale dhe familjare” (fq. 4). Në çështjen 7 të këtij dokumenti “Për njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, mësohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orientuara drejt thellimit të shprehive klinike, për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit, udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse me tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 6).</p> <p>Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike” (2020-2024), seksioni III “Vizioni/Misioni”, përshkruhet se “Oferta akademike e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike, është konceptuar për të formuar të rinj dhe të reja të pajisur me:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - dije të avancuara në teoritë dhe shprehjet klinike psikologjike, si dhe metodat e kërkimit; - aftësitë për të kuptuar dinamikat psikologjike individuale, fsmiljsre dhe grupore; - aftësitë për të aplikuar dijen e avancuar psikologjike ndaj problemeve të shëndetit mendor; - aftësitë e duhuara në mënyrë që ata të jenë në gjëndje të ndjekin karrierë në sektorin public, privat, si dhe në sektorin jofitimprurës; - një themel solid akademik, në mënyrë që ata të jenë të suskshëm në ndjekjen e studimeve doktorale, pas përfundimit të programit Master; 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.2

Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>UT ka hartuar dokumentin “Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2018-2023” i cili përcakton “parimet udhëzuese për zhvillimin e mëtejshëm dhe liston masat bazë që duhet të merren në mënyrë që UT-ja të përballojë sfidat e të ardhmes”. Bazuar në dokument, FSHS ka projektuar “Strategjinë e zhvillimit të FSHS-së, 2018-2023”, dhe në vijim DPP-ja, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka përshtatur “Strategjinë e zhvillimit të DPP, 2020-2024” dhe “Strategjinë e zhvillimit të programit, 2020-2024”.</p> <p>Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike” (2020-2024), seksioni III “Vizioni”, përshkruhet se “Oferta akademike e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike është konceptuar:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - të ndihmojë studentët në zhvillimin e njohurive shkencore dhe aftësive të nevojshme për t'u bërë profesionistë të zotë në një shoqëri që është gjithnjë në ndryshim; - të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkenctarë të rinj në fushën e psikologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të shkencës në arsimin e lartë; - të krijojë një ambjent, i cili inkurajon kërkimin rigoroz shkencor psikologjik dhe të integrojë kërkimin shkencor në mësimdhënien; - të kontribuojë në shërimin e plagëve psikologjike të individit, familjes dhe shoqërisë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare; <p>Përmbajtja e këtyre dokumenteve, tregon se programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil: Psikologji Klinike, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me strategjinë për zhvillim të UT/FSHS/DPP. Megjithatë, vërehet nevoja për të harmonizuar dokumentet e prodhuara nga DPP, me dokumentet strategjike të zhvillimit të hartuara nga UT dhe FSHS.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në Statutin e UT, Neni 92 "Programi i studimit Master i Shkencave", pika 1, përshkruan se "<i>Programet e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor", me njohuri të thelluara shkencore teorike dhe praktike në drejtimin përkatës</i>". Pika 2, specifikon se "<i>Ky program mund të realizohet me 120 kredite, me kohëzgjatje normale jo më shumë se dy vite akademike. Këtu përfshihen 30-40 kredite për një projekt kërkimor, nën udhëheqje të kualifikuar, i cili përfundon me diplomë (mikrotezë). Në përfundim të programit të ciklit të dytë, lëshohet diploma universitare "Master i Shkencave" në fushën e arsimit të kryer</i>" (Dokumenti 3/1.2, e-ASCAL).</p> <p>Në "Rregulloren e UT" (e ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik, nr. 26, datë 02.07.2015), Kreu III, përcakton organizimin, strukturën dhe elementet e programeve të studimit. Në Nenin 31 tregohet se "<i>UT ofron programe studimi të akredituara, të organizuara me module dhe të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe</i></p>

	<p><i>Grumbullimit të Krediteve (ECTS)” (Dokumenti 4/1.3, e – ASCAL).</i></p> <p>Statuti dhe rregullorja e UT përcaktojnë qartë drejtimitet prioritare akademike të programit të studimit dhe demonstrojnë se ky program hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të tyre. Në dokumentin “<i>Korniza kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i>”, çështja 2 “<i>Parimet dhe kërkesat e programit</i>”, është shprehur qartë se “<i>Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit, burojnë nga kuadri ligjor për AL, Statuti dhe Rregullore e UT në lidhje me rregullat dhe objektivat e zvjillimit të AL dhe specifikisht të shprehura në formimin e psikologëve klinikë</i>” (fq. 2).</p> <p>Gjithashtu, dokumenti “<i>Rregullore e programit Master i Shkencave në “Psikolog Klinik” (2019)</i>, në Nenin 3, thekson se “<i>Kjo rregullore bazohet në Ligjin nr. 80/2015 të AL, Statutin e UT, Rregulloren e UT, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me AL në Shqipëri</i>”.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron, se dokumentet rregullatore kanë nevojë të harmonizohen/rishikohen, duke siguruar kohezionin e duhur përsa i përket vitit të miratimit të Rregullores së UT (2015), dhe vitit të miratimit të Statutit të UT (2018). Është e pritshme që Rregullore e UT të burojnë nga Statuti i UT, dhe dokumentet e tjera rregullatore të FSHS të bazohen në Rregulloren e UT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Referuar Statutit të UT (2018), Kreu II “<i>Organizimi dhe strukturat përbërëse</i>”, Neni 11 “<i>Njësitë përbërëse të UT</i>”, Pika 2, përcakton se “<i>UT përbëhet nga 8 njësi kryesore, njësitë bazë dhe njësitë e tjera</i>”. Një nga njësitë kryesore të UT është Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS). Fakulteti ka në përbërje të tij 5 departamente që ushtrojnë veprimtarinë e tyre akademiko-shkencore në drejtime të caktuara të fushës sociale. Sipas Statutit (2018), njësia bazë e emërtuar “<i>Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë</i>” është në përbërje të Fakultetit të Shkencave Sociale (fq. 7).</p> <p>Në Rregulloren e UT (2015) Neni 13, “<i>Struktura Qendrore dhe e Njësive Përbërëse Kryesore</i>”, specifikohen se një prej njësive</p>

bazë të Fakultetit të Shkencave Sociale është “*Departamenti i Pedagogji Psikologjisë*” (fq. 11).

Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 9 “*Organizimi akademik*”, cilësohet se një nga njësitë bazë të FSHS është “*Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë*” (fq. 4).

Kjo njësi bazë është përfshirë në strukturën e Fakultetit të Shkencave Sociale, me Urdhër nr. 18 datë 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, nën emërtimin “*Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë*”.

Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike ofrohet nga “*Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë*” (DPP), shprehur në Rregulloren e programit Master i Shkencave në “*Psikolog Klinik*” (2019), Neni 5 “*Statusi i MSH-PK*”, pika 5.1, ku cilësohet se “*Programi Master i Shkencave në Psikolog Klinik është një nga profilet e studimit që ofrohet nga njësia bazë e Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë, të FSHS, në UT*” (fq. 3).

Bazuar në Rregulloren e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë (2021), Neni 5, Pika 5.1, “*DPP është njësi bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon, për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës dhe shkencor, si edhe për shërbimet administrative që mbulon*” dhe sipas Nenit 6, “*Për funksionet e DPP*”, ky departament “*nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore-shkencore, si edhe veprimtarine administrative*”.

Referuar dokumentit “*Strategjia e zhvillimit të Departamenti Pedagogji-Psikologjisë 2020-2024*” mësohet se DPP ka një histori të gjatë kontributesh në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë ...(fq.2).

Pavarësisht varietetit të emërtimit të departamentit të shprehur në dokumentet rregullatore të UT/FSHS/DPP (si: *Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë / Departamenti i Pedagogji Psikologjisë / Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë* / “*Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë*”), vlerësohet se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike të cilin ky

	<p>department ofron, është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të vetë institucionit, pra DPP, FSHS, UT.</p> <p><i>GVJ rekomandon të saktësohet dhe unifikohet emërtimi i njësisë bazë që ofron programin e studimit të marrë në vlerësim, në të gjitha dispozitat rregullatore dhe aktet e tjera në nivel institucional.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike, është hartuar e zhvillohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, me interesin kombëtar për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqënies së shoqërisë shqiptare, si dhe me trendet globale të zhvillimit, kërkimit shkencor dhe sigurimit të standardeve në ushtrimin e profesionit të psikologut klinik. Referuar dokumentit “Korniza kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike”, çështja 2 “Parimet dhe kërkesat e programit”, deklarohet se “Hartimi i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, rregulloret përkatëse, e dokument e tjera që shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithëshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në RSH” (fq2).</p> <p>Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike” (2020-2024), seksioni III “Vizioni”, përshkruhet se “Oferta akademike e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike është konceptuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndihmojë studentët në zhvillimin e njohurive shkencore dhe aftësive të nevojshme për t’u bërë profesionistë të zotë në një shoqëri që është gjithnjë në ndryshim; - të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkenctarë të rinj në fushën e psikologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të shkencës në arsimin e lartë; - të krijojë një ambjent, i cili inkurajon kërkimin rigoroz shkencor psikologjik dhe të integrojë kërkimin shkencor në mësimdhënien; - të kontribuojë në shërimin e plagëve psikologjike të individit, familjes dhe shoqërisë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.3

Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike, ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Referuar dokumentit “Korniza kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike”, çështja 3 “Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme”, përshkruhet se, Programi ka si objektiva të tij:</p> <ol style="list-style-type: none"> të ofrojë dije të integruara me qëllim që të aftësojë studentët të ofrojnë shërbime bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si intervistim, vlerësim, përshkrim klinik dhe diagnostikim, hartim i planeve të trajtimit dhe ofrimi i terapive, apo ndërhyrjeve specifike për problematika dhe grupmosha të ndryshme; të zhvillojë aftësitë (e studentëve) për të punuar në ekipe multidisiplinare, apo për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të shëndetit mendor, duke koordinuar dijet dhe ekspertizën në funksion të adresimit profesional dhe efektiv të problemeve të shëndetit mendor; të zhvillojë aftësinë për të kuptuar dhe përdorur rezultatet e kërkimeve shkencore bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si dhe për të hartuar dhe udhëhequr studime në fushë;

	<p>Realizimi i programit të studimit, bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional), disiplina të përafërta plotësuese si dhe ato të natyrës praktike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në vitin 2008, kur është hapur programi i studimit (me emërtim fillestar “<i>Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve</i>”) nuk ka qënë kusht kryerja e studimit të tregut lokal e ndërkombëtar të punës, përpara hapjes së një programi studimi.</p> <p>Megjithatë, FSHS në bashkëpunim me DPP, njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit, demonstroi se kryen studime dhe mbledh informata mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës me qëllim përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se “Këto studime dhe informata përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, vecanërisht me subjektet publike/private, me të cilët FSHS është në partneritet për realizimin e praktikës profesionale, për të identifikuar kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, si dhe për të siguruar informacion për zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës”.</p> <p>Një studim i tregut të punës i ndërmarrë nga DPP, në FSHS, “<i>Alumni në Master Shkencor në Psikologji Klinikë – Rezultate të punësimit</i>” (2021), përmban të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar në programet e studimit me profil profesionin e psikologut klinik (<i>Dokument 89/ 4.14 te dhëna permbledhese per punësimin real te studenteve te programit, e-ASCAL</i>). Referuar tabelës “Psikologë të licensuar sipas viteveve 2017-2021” rezultoni në total 338 ish-studentë të diplomuar në programin e studimit, janë licensuar për të ushtruar profesionin e psikologut klinik sipas ligjit për profesionet e rregulluara (<i>Dokument 90/ 4.14.1 Psikolog te licensuar sipas viteve, e-ASCAL</i>).</p> <p>Institucioni përfiton të dhëna për nevojat, kërkesat dhe zhvillimet e pritshme në sektorin e shërbimeve psikologjike edhe nga diskutimet me kolegët e FSHS (pedagogë me kohë të plotë ose të pjesëshme) të cilët janë përfshirë aktivisht në tregun lokal të shërbimeve psikologjike dhe kontribuojnë në agjensi private/publike me ekspertizën e tyre në këtë fushë</p>

	<i>(informacion i marrë nga vizita në institucion, datë 20.07.2022).</i>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formues, struktura, përmbajtja dhe rezultatet e pritshme të nxënit, të programit të studimit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Referuar dokumentit “Korniza kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike”, çështja 3 “Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme”, përkthehet se programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të mundësojë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave të mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike të lidhura me:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) çrregullime të veçanta si trajtimi i traumës, trajtimi i sjelljes deviante dhe çrregullimeve të personalitetit, terapitë e individuale, familjare dhe grupi; b) forma të ndryshme trajtimi të tilla si terapia familjare, terapia e artit dhe e lojës; c) kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional dhe bashkëpunimi me profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor, si p.sh., mjekë, psikiatër, neurologë, etj; d) aftësi në kërkimin shkencor cilësor dhe sasior; <p>Në vijim të çështjes 3 “Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme”, mësohet se në përfundim të studimeve, studentët duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të njohin me kompetencë metodat dhe instrumentet e kërkimit në fushën e psikologjisë klinike; • të jenë të aftë të konceptojnë, ndërtojnë dhe zbatojnë një projekt kërkimi; • të kujdesen për mirëqënien mendore të individëve, apo grupeve të ndryshme; • të zhvillojnë procesin e vlerësimit dhe diagnostikimit të patologjive, apo problematikave të tjera me natyrë klinike, të përshkruajnë dinamikën e patologjive; • të ofrojnë mbështetje emocionale dhe këshillim; • të adresojnë në mënyrë specifike një gamë të gjërë çështjesh klinike të lidhura me çrregullime dhe problematika klinike

	<p>të veçanta, grupmosha të ndryshme, duke përfshirë fëmijët, adoleshentët, të moshuarit, si dhe çështje të lidhura me bashkëveprimin me profesionistë të tjerë të fushës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të aftë të planifikojnë dhe ofrojnë programe trainimi për grupe të ndryshme profesionistësh, si dhe programe psikoedukimi për grupe në nevojë si përdorues shërbimesh, familjarë, nxënës, etj; • të aftë të integrojnë në punën e tyre dijet dhe gjetjet e kërkimeve të ndryshme në fushën klinike, si dhe të planifikojnë dhe zbatojnë kërkime dhe studime (fq. 4-5); <p>Në çështjen 4 të këtij dokumenti, “Për strukturën dhe karakteristikat e programit të studimeve”, shpjegohet se “Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikolog Klinik është program studimesh universitare i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera, janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite. Lëndët mësimore janë përzgjedhur nga fusha studimi të psikologjisë, si: “Metodat e kërkimit shkencor”; “Vlerësimi dhe trajtimi i çrregullimeve të ndryshme”; “Praktikume në zhvillimin e shprehive klinike”; “Njohja e thelluar e teorive në fusha të ndryshme si trauma”, llojet e ndryshme të terapive individuale dhe familjare (fq. 4).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Kornizës kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i>”, çështja 4 “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve”, mësohet se “Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite. Lëndët mësimore janë përzgjedhur nga disa fusha studimi të psikologjisë, si: Metodat e kërkimit shkencor; Vlerësimi dhe trajtimi i çrregullimeve të ndryshme; Praktikume në zhvillimin e aftësive klinike; Njohja e thelluar e teorive në fusha të</p>

	<p>ndryshme si trauma, llojet e ndryshme të terapive individuale dhe familjare” (fq. 4).</p> <p>Nga kjo pikëpamje, programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, në vende të tilla si Anglia, SHBA, Gjermania, Italia, etj., duke synuar lehtësimin e shkëmbimit të studentëve në kuadër projekti, si dhe transferimin e studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e programit Master i Shkencave në “Psikolog Klinik” (2019), në Nenin 13 “Lëvizja e studentëve”, përcaktohet se “Studentët mund të lëvizin në kuadër të shkëmbimeve dhe projekteve ndrkombëtare. Ata mund të kryejnë praktikën në institucione ndërkombëtare jashtë shtetit ose kurse studimi në një nga universitetet partnere. Kjo lëvizje nuk merret si ndërprerje e studimeve dhe rregullohet në bazë të rregullave të ekuivalentimit, për aq kohë sa është e mundur” (fq. 10). Sipas të dhënave institucionale, gjenden 6 raste të mobilitetit të studentëve në dy vitet e fundit (2020-2022) në kuadër të projekteve Erasmus+. (Evidenca 74/3.20 Te dhena per mobilitetin e studenteve dhe te pedagogete, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Profesioni i psikologut, megjithëse shumë i nevojshëm, ka qënë i panjohur përpara viteve 1990. Në këtë kuadër, përgjithësisht programet e studimit në këtë fushë janë realizuar në bashkëpunim ose reference të ngushtë me universitetet më në zë për përgatitjen e psikologëve të rinj. Si rrjedhojë, programet në fushën e psikologjisë, në veçanti profili “Psikolog klinik” ka ngjashmëri, në aspekte të ndryshme të programit, duke përfshirë përmbajtjen lëndore dhe objektivat formuese e kompetencave profesionale që synohen të zhvillohen në përfundim të programit. Gjithashtu një sërë elementësh të strukturës së këtij programi studimi, si organizimi me kredite sipas Sistemit Evropian të Trasferimit të Krediteve (ECTS), diploma dhe suplementi i saj, etj, janë të gjitha elemente të pranishme që janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional</p>	<p>Praktika profesionale është një nga komponentët kryesorë të programit të studimit, e cila sipas dokumentit “Korniza</p>

në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.

kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike”, çështja 3, ka për qëllim zhvillimin e shprehive profesionale konkrete të studentëve:

- a) për të ofruar shërbime bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si intervistim, vlerësim, përshkrim klinik dhe diagnostikim, hartim i planeve të trajtimit dhe ofrimi i terapive, apo ndërhyrjeve specifike për problematika dhe grupmosha të ndryshme;
- e) për të punuar në ekipe multidisiplinare, apo për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të shëndetit mendor, duke koordinuar dijet dhe ekspertizën në funksion të adresimit profesional dhe efektiv të problemeve të shëndetit mendor;
- f) për të kuptuar dhe përdorur rezultatet e kërkimeve shkencore bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si dhe për të hartuar dhe udhëhequr studime në fushë;

Referuar Planit Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim, praktika profesionale ka 12 ECTS dhe kryhet në disa qendra dhe institucione publike dhe private në vend me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Për të orientuar studentët në realizimin me sukses të praktikës profesionale, FSHS/DPP ka hartuar Rregulloren e Praktikës Profesionale (2018). (*Dokumenti 79/ 4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL*).

Në dokumentin “*Rregullore e FSHS*” (2018), Neni 25 “Praktikat Profesionale”, përshkruhet se “Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në planet mësimore. Me fillimin e vitit akademik, departmenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes dhe programin e saj. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e punonjësit arsimor të caktuar, duke respektuar rregullat e atij institucioni. Praktikrat kryhen në grupe mësimore sipas përcaktimeve për madhësinë e grupit që lejojnë udhëzimet e MAS. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një realcion për punën e kryer e cila vlerësohet nga personeli mësimor që drejton praktikën, pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me

	<p>note” (fq. 8) (Dokumenti 24/2.4 Rregullore e FSHS (2018), e-ASCAL).</p> <p>Referuar direktivave ndërkombëtare për profesionet e rregulluara, profesioni i psikologut klinik është i rregulluar me Ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e psikologut në RSH”, i cili sipas Nenit 2, ka për qëllim përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e profesionit të psikologut, garantimin e standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të psikologut.</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike ofrohet në gjuhën shqipe.</p> <p>Megjithatë, në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit në AL, institucioni ka përgatitur syllabuset e lëndëve dhe literaturën në anglisht, për të mirëpritur edhe studentë nga përtej vendit. Staf i akademik që zhvillon mësim në programin e studimit dëshmon se ka aftësi për të dhënë mësim në gjuhën angleze. FSHS/DPP tregon se deri tani nuk ka pasur kërkesa nga studentë të huaj për të ndjekur programin e studimit të marrë në vlerësim. DPP, njësi bazë që ka përgjegjësi për programin e studimit, ka shpallur si objektiv strategjik të zhvillimit ndërkombëtarizimin e programeve të studimit. Për të arritur këtë objektiv, DPP synon të rrisë kapacitetet akademike për të mundësuar ofrimin e programeve të studimit në gjuhë të huaj për të tërhequr studentë jo vetëm nga hapësira shqipfolëse por edhe hapësira e rajonit të Ballkanit dhe Europa, apo edhe më gjërë (fq. 11). (Dokumenti 57/3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit, e-ASCAL)</p>
<p>Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit, ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, si rrjedhojë edhe dokumentacioni është përgatitur, ruhet dhe arkivuar në gjuhën shqipe. Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se në kuadër të strategjisë së DPP për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, përfshi edhe programin e marrë në vlerësim, janë përgatitur suplementi i diplomës në gjuhën shqip dhe anglisht, syllabuset dhe literatura në shqip dhe anglisht, si dhe CV-të e personelit akademik në shqip dhe anglisht. DPP ka objektiv stretegjik të krijojë ofertë</p>

	akademike për tërheqjen e studentëve të huaj dhe profesoratis të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë</p>	<p>Sipas Statutit të UT (2018), Universiteti i Tiranës është krijuar në vitin 1957, si institucioni i parë universitar i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri. Mbështetur në traditat dhe arritjet arsimore dhe shkencore më të përparuara të vendit dhe ato botërore, UT është vlerësuar dhe ka zënë një vend të denjë ndër institucionet arsimore e shkencore në vend (fq.2). Ai përbëhet nga 6 njësi kryesore, duke përfshirë edhe FSHS. Fillimisht, fakulteti është hapur me VKM nr. 348, datë 31.07.1992 me emërtim “Fakulteti i Punës Sociale”. Në vitin 1993, me Urdher nr.18 date 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, fakulteti emërtohet “Fakulteti i Shkencave Sociale” duke përfshirë në strukturën e tij edhe departamentin e “Psikologjisë dhe Pedagogjisë”.</p> <p>FSHS dhe DPP demonstrojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit. Referuar dokumentit të marrë gjatë vizitës në institucion (<i>Te dhena të stafit të Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit për vitin akademik 2021-2022</i>), rezulton se Fakulteti i Shkencave Sociale për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 326 pedagogë, nga të cilët 73 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 Prof. Dr; - 20 Prof. Asoc; - 42 Dr; - 1 Msc;

	<p>dhe 253 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 9 Prof. Dr; - 12 Prof. Asoc; - 98 Dr; - 134 Msc; <p>Ndërsa departamenti përgjegjës për vitin akademik 2021-2022, ka 22 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 6 me titullin “Profesor”, 4 me titullin “Profesor i Asociuar”, dhe 12 me gradën “Doktor”. dhe 105 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët janë 6 me titullin “Profesor”, 4 me titullin “Profesor i Asociuar”, 43 “Doktor” dhe 52 me “Master i Shkencave”. Raporti midis PAE dhe PAK është në favor të PAK.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Në dokumentin “<i>Strategjittë e zhvillimit të FSHS, 2018-2023</i>”, citohet se vizioni i saj është “<i>të jetë një institucion elitar në arsimin e lartë, vatër e mësimdhënies me standardet evropiane, qendër e rëndësishme e kërkimit shkencor në fushat sociale në Shqipëri dhe në Rajon, ofrues shërbimesh për komunitetin, agent i ndryshimit të shoqërisë shqiptare</i>”</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHS-së, njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p>	<p>Në Rregulloren e DPP, 2021, Neni 6, pika 6.2 (fq. 3) përcaktohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) DPP ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, ku organizimi struktura dhe përmbajtja e këtyre programeve, ofrohen në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimet akademike të DPP-së, si dhe në përputhje të plotë me klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit shqiptar të fushës, si edhe direktivave evropiane në ato raste kur këto direktiva janë ratifikuar nga RSH; b) DPP përgjigjet për formulimin e profileve, si edhe të përmbajtjeve lëndore, për diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë së studimit që ndodhen nën administrimin e tij;

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DPP, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>FSHS, në UT, i cili ofron programin e studimit të ciklit të dytë demonstroi angazhimin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për AL, Statutin e UT (2018), dokumentet rregullatore, udhëzimet dhe aktet të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit përkatës, sigurimin e marrëdhënieve të bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Sipas Rregullores së FSHS (2018), Neni 4 “Për rregulloret e brendshme”, deklarohej si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. FSHS përdor rregullore të brendshme për aspekte të ndryshme të veprimtarisë dhe për struktura të caktuara të cilat miratohen nga organet dhe autoritetet drejtuese përkatëse të FSHS; 2. Rregulloret e njësisve bazë dhe të strukturave ndihmësakadematike dhe administrative shtrijnë efektin në njësitë dhe strukturat përkatëse, mbi personelin, studentët dhe bashkëpunëtorët e tyre; <p>Në Rregulloren e DPP (2021), Neni 5 “Organizimi i DPP”, përcaktohet se “DPP është njësi bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon, për kryerjen e aktivitetit</p>

mësimdhënës dhe shkencor, si edhe për shërbimet administrative që mbulon”; dhe në Nenin 6, “Funksionet e DPP”, pika 1 e tij, përkufizohet se “ DPP nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore-shkencore, si edhe veprimtarine administrative”, dhe në Nenin 8 “Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP”, Pika 8.1 “Kompetencat e Drejtuesit të Departamentit në drejtim të mësimdhënies”, përsëritet si vijon:

- a. Kujdeset për mbarëvajtjen e programeve të studimit të tre cikleve të studimit, si dhe programeve të lëndëve që menaxhon, duke bashkëpunuar me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Institucionit.*
- b. Miraton dhe ndjek zbatimin e planit strategjik për zhvillimin e programeve të studimit të departamentit, në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të FSHS, si edhe kryen studime periodike të tregut të punës. Etj.*

Në vijim, Neni 11 i këtij dokumenti “Për përgjegjësitë e koordinatorëve të programeve të studimit që mbulon DPP”, deklaron se “Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin, për çdo program studimi cakton një person në rolin e Koordinatorit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse”.

Në “Rregullore e programit Master i Shkencave në “Psikolog Klinik” (2019), në Nenin 1, përcaktohet se “Rregullorja e brendshme e Masterit Shkencor në Psikolog Klinik (MSH-PK) vendos rregullat normative të funksionimit të MSH-PK dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e këtij MSH-PK”.

Në Nenin 10.2.2 të këtij dokumenti “Për detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit”, përsëritet se koordinatori i programit të studimit, mes të tjerash, ka përgjegjësi “ të përgatisë në bashkëpunim me anëtarët e komitetit shkencor raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së kryer për përmbushjen e misionit dhe objektiveve të programit, identifikon pikat e forta dhe të dobëta, dhe paraqet



	<p><i>rekmandimet përkatëse për përmirësimin e programit të studimit (fq. 7) (dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).</i></p> <p>Relacioni mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike, datë 17.09.2021, përpiluar nga koordinatori i këtij programi, drejtuar përgjegjësit të DPP, përbën një praktikë të mirë pune dhe është një tregues tjetër i bashkëpunimit të frytshëm brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive, dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. (Dokumenti 72/3.18, Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>FSHS, si pjesë përbërëse e UT, dëshmon përmes “Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale” (materiali 71/3.17, e-ASCAL) dhe “Listës së projekteve 4 vitet e fundit” (Evidenca 6/5. Lista e projekteve 4 vitet e fundit, Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL); se ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit dhe disa jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-social, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, etj, për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve të cilët ndjekin programet e studimit të ofruara nga FSHS, duke përfshirë edhe ata që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se disa marrëveshje bashkëpunimi të UT/FSHS-së me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit kanë qënë frytdhënëse në organizmin konferencave të përbashkëta, uorkshop-et, ftesa për leksionet online, dhe aktivitete të tjera në nivel institucional. Në këto evente, studentët kanë qënë pjesëmarrës përkrahë pedagogëve të tyre me punime studimore duke përfitur për të zgjeruar dhe përditësuar njohuritë të tyre në fushën e studimit përkatës.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të</p>	<p>FSHS/DPP ka nënshkruar marrëveshje të posaçme bashkëpunimi me institucione brenda vendit, qendra të shërbimit psiko-social, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, etj, me synim realizimin e praktikave</p>

<p>posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>profesionale të studentëve të programit të studimit të marrë në vlerësim. <i>(Dokumenti 75/3.21 Tabele permbledhese me institucionet bashkepunuese per programin e studimit dhe praktiken, fq. 2-3; Dokumenti 79/ 4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit (2018), fq. 13-14, e-ASCAL).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>FSHS dëshmon se ka vendosur marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>Formati standard “<i>Marreveshja e praktikës</i>” i përfshirë në Rregulloren e Praktikës Profesionale (2018), të cilin aplikon FSHS në UT, është tregues konkret i formalizimit të një bashkëpunimi ndërinstytucional me agjensitë përkatëse sipas përgjegjësi reciproke lidhur me kryerjen, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikës profesionale <i>(Dokumenti 79/ 4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit (2018), fq. 7, e-ASCAL).</i></p> <p>Kohëzgjatja e marrëveshjeve varion nga 1 deri në 5 vite, dhe në disa raste me afat të pacaktuar. <i>(Materiali 73/3.19 Raporti i fundit periodik analitik i perfitimeve nga marreveshjet e bashkëpunimit ne funksio, fq. 1; e-ASCAL).</i></p> <p>Për të siguruar kontakte të drejtpërdrejta me agjensitë apo qendrat ku zhvillohet praktika, me qëllim mbarëvajtjen e praktikës profesionale të studentëve, FSHS/DPP ka caktuar një personel akademik si udhëheqës të praktikës. Sipas Rregullores së Praktikës Profesionale (2018), për detyrimet e udhëheqësit të praktikës, pikës 2 të saj, kërkohet që “<i>Udhëheqësi i praktikës të vendosë kontakte me agjensitë apo qendrat, në të cilat do të praktikohen studentët për të njohur me hollësi fushat, në të cilat studentët do të kenë mundësi të përfshihen</i>” <i>(Dokumenti 79/ 4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit (2018), fq. 4, e-ASCAL).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>FSHS në UT, dëshmon se garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. Bazuar në dokumentin “<i>Lista e projekteve 4 vitet e fundit</i>” dhe dokumentin “<i>Lista e projekteve qe kane patur ndikim ne zhvillimin e programit te studimit</i>”, dëshmohet se FSHS/DPP ka vendosur marrëveshje</p>

bashkëpunimi me institucione homologe vendase dhe të huaja në fushën e projekteve dhe kërkimit shkencor. (Evidenca 6/5. Lista e projekteve 4 vitet e fundit, Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL; Evidenca 87/4.12 Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit, e-ASCAL).

Në dokumentin “Raporti periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikim dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit” (2016-2021), çështja 4 “Produktet në fushën e kërkimit shkencor”, FSHS/DPP deklaron se “FSHS për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore dhe kualifikuese ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa IAL brenda dhe jashtë vendit dhe institucione të tjera shkencore dhe shtetërore” (Dokumenti 82/4.7 Te dhena të plota për kërkimin shkencor në kuadër të programit të studimit, fq. 6, e-ASCAL).

FSHS tregon se bashkëpunon me institucione homologe jashtë vendit në kuadër të projekteve për mobilitetin e personelit dhe studentëve. Sipas të dhënave për dy vitet e fundit (2020-2021; 2021-2022), rezultojnë 8 studentë dhe 8 pedagogë të cilët kanë përfituar nga projektet bashkëpunuese për mobilitet. (Evidenca 74/3.20 Te dhena për mobilitetin e studenteve dhe të pedagogëve, e-ASCAL).

Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se disa bashkëpunime të UT/FSHS-së me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit kanë qënë frytdhënëse në organizmin konferencave të përbashkëta, workshop-et, ftesa për leksionet online, dhe aktivitete të tjera në nivel institucional. Në këto evente, studentët kanë qënë pjesëmarrës përkrahë pedagogëve të tyre, me punime studimore duke përfituar për të zgjeruar dhe përditësuar njohuritë të tyre në fushën e studimit përkatës.

Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të FSHS” (2018-2023) FSHS/DPP ka shpallur si një prej drejtimeve prioritare të saj zhvillimin e partneriteteve. Institucioni është angazhuar për të përmbushuar objektivat si vijon: (1) Zgjerimi i partneriteteve për të mbështetur mësimdhënien, të nxënësve, punësimin e studentëve; (2) Zgjerimi i partneriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillim dhe kërkim. (Dokumenti 23/2.3.pdf, fq. 13-14, e-ASCAL). FSHS/DPP synon të arrijnë në të ardhmen

	një integrim më të mirë në Zonën Europiane të Kërkimit. (Dokumenti 23/2.3.pdf, fq. 12, e-ASCAL).			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	DPP, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se harton raporte të përgjithëshme të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, përfshi edhe programin e studimit në vlerësim. Referuar përmbajtjes së dokumentit “Raporti i fundit analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit të praktikës” vërehet se përcillet një informacion i përgjithshëm dhe jo analitik mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Gjithashtu, raporti nuk mban datë për të vlerësuar se kur është hartuar, si dhe nuk referon njësinë / strukturën e cila e ka hartuar. (Materiali 73/3.19 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion, fq. 1; e-ASCAL).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	UT garanton përmes dokumenteve rregullatore, relacioneve institucionale dhe dëshmimeve të personelit akademik se përpiqet të ndjekë një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve. Në Statutin e UT (2018), Kreu XIII “Kërkimi shkencor”, Neni 114 “Veprimtaritë e kërkimit shkencor”, pika 1, thekson se “UT kryen veprimtari kërkimore shkencore bazë ose të zbatuar, studime, ekspertizë shkencore, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e vendit” dhe pika 4 specifikon se “Njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UT nxisin realizimin e tyre nga personeli akademik”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Në vijim, Neni 118 i Statutit të UT (2018) "Për konferencat shkencore", në pikën 1, shprehet se "Në përmbushje të funksioneve lidhur me kërkimin shkencor, UT dhe /ose njësitë kryesore/bazë të saj, veç ose në bashkëpunim me njëri tjetrin, ose në bashkëpunim me IAL të tjera dhe njësitë e tyre, realizojnë konferenca shkencore, simpoziume, kongrese ose seminare të ndryshme".

Sipas Nenit 119 të Statutit të UT (2018) "Për botimet mësimore dhe shkencore", specifikohet se (1) UT ka të drejtë të botojë tekste dhe libra, të cilët shtjellojnë njohuri të lidhura ngushtë me programet e lëndëve që ofrohen në të gjitha ciklet e studimit. (2) Këto tekste mësimore shkencore do të botohen nën drejtimin dhe kujdesin e UT në rastet kur ato përmbushin kriteret përkatëse shkencore. (4) Të drejtën për botim e kanë të gjithë anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë dhe të ftuar. (5) Miratimi i botimeve bëhet nga një komision përkatës shkencor që ngrihet pranë çdo njësie kryesore.

Në Nenin 120 "Për financimet e kërkimit shkencor", pikën 4 përshkruhet se "Në buxhetin që përcaktohet për çdo njësi kryesore duhet të përcaktohet edhe një fond që duhet të mbështesë veprimtarinë mësimore / shkencore dhe botimet përkatëse" (Dokumenti 3/1.2, Statuti i UT, e-ASCAL)

FSHS/DPP raporton se bazuar në të dhënat për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit (2016-2021), rezultojnë në total të publikuara në mënyrë individuale 74 artikuj shkencorë, 132 referime në konferenca shkencore dhe 9 monografi. (Dokumenti 86/4.11. Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit, e-ASCAL)

Gjenden 11 projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ku stafi akademik i cili mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, rezulton i përfshirë në 4 vitet e fundit. (Evidenca 6/5. Lista e projekteve 4 vitet e fundit, e-ASCAL). Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik deklaroi se institucioni krijon mundësi që stafi akademik dhe ndihmësakademik të marrë pjesë pa pagesë në konferencat që organizon UT dhe FSHS. Gjithashtu, ata u shprehen se institucioni përpiqet të financojë pedagogët një herë në dy vjet

	<p>për një pjesëmarrje në një konferencë jashtë vendit, duke përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe fee të konferencës. Por, shumica e publikimeve në fushën e kërkimit shkencor, në revistat ndërkombëtare, mbulohet me shpenzimet e vetë pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>DPP në FSHS, deklaron në RVB se kryen vetë një herë në vit një analizë për ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të secilit pedagog, dhe të projekteve shkencore të departamentit. Në dosjen e VV gjenden dy raporte vjetore në nivel fakulteti, dhe jo departamenti. (Dokumenti 38/2.18-1.pdf dhe 39/2.18-2.pdf, FSHS, Raport vjetor për veprimtaritë e kryera 2019-2020; 2020-2021; e-ASCAL)</p> <p>DPP përgjegjëse për programin e studimit ka dorëzuar një dokument me titull “Raport periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit”. (Dokumenti 82/4.7, Te dhëna te plota per kerkimin shkencor ne kuader te programit te studimit; Dokumenti 86/4.11. Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit, e-ASCAL)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>FSHS ndjek një politikë të promovimit të rezultateve të kërkimit shkencor në nivel fakulteti duke mundësuar një here në vit organizimin e konferencave kombëtare e ndërkombëtare, si dhe aktivitete të tjera promovuese, si leksione të hapura, ceremoni të publikimit të librave, etj. Rezultatet në fushën e kërkimit shkencor bëhen pjesë e analizës vjetore të fakultetit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore botuese.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i Etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, pika 2 përcakton se “Çdo pedagog duhet të njohë dhe të respektojë kontributet shkencore të kolegëve dhe studentëve. Në leksione, publikime apo prezantime, pedagogët duhet të përdorin praktikën e pranueshme profesionale për materialet e huazuara”. (Dokumenti 6/1.5.pdf Kodi i Etikës së UT (2011), e-ASCAL).</p> <p>FSHS/DPP e bazojnë politikën e tyre për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” në RSH.</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>UT/FSHS inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj në përbërje të personelit akademik, për të ndërmarrë iniciativa vetjake në fushën e kërkimit shkencor. Në faqen e webit të UT, në kategorinë për kërkimin shkencor, institucioni publikon rregullisht thirrjet për aplikim drejtuar studentëve dhe pedagogëve, me qëllim që të nxisë përfshirjen e tyre në projekte kërkimi ose mobiliteti të mbështetra me fonde/grande kombëtare ose ndërkombëtare. Gjenden 11 projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (nga 16 të deklaruara) ku studentët dhe stafi akademik i cili mbulon programin e studimit, rezultojnë të përfshirë në 4 vitet e fundit. (Evidenca 6/5. Lista e projekteve 4 vitetet e fundit, e-ASCAL)</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të punimit të mikrotezës për mbrojtjen e diplomës, studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike janë të angazhuar në projektet e tyre kërkimore nën udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të DPP.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	------------------------------	-----------------------------	---

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

<p>Standardi II.1</p> <p>Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Kreu VII “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69 “Për format e studimeve dhe pranimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, mes të tjerash përcakton se “...Programet e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë”. Në Nenin 70 të Ligjit nr. 80/2015 për AL, “Për ciklet dhe programet e studimeve”, Pika 1, 2 dhe 4, shprehen si më poshtë:

1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).

2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.

Në Nenin 75, “Për programet e ciklit të dytë të studimeve”, Pika 1, përkufizohet se “Cikli i dytë i studimeve, përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve”. Sipas pikës 3 të Nenit 75, “Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe kohëzgjatje normale dy vite akademike”. Në Pikën 5, specifikohet se “Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer”.

Përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015 për AL janë pasqyruar në “Rregulloren e UT” (e ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik, nr. 26, datë 02.07.2015), ku përmes Nenit 31 “Për organizimin e studimeve” deklarohet se “UT ofron programe studimi të akredituara, të organizuara me module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)”.

Në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu IV “Për organizimin e programeve”, Neni 21, pika 2, shprehet se “FSHS ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sipas pikës 2 të këtij neni, “Sasia mesatare e krediteve të

	<p><i>grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit, ku 10 deri 12 orë punë duhet të jenë në auditor”.</i></p> <p>Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, Pika 4, “Për strukturën dhe karakteristikat e programit të studimeve”, përshkruhet se “Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikolog Klinik është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sitemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS. Disiplinat mësimore dhe dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite. Lëndët mësimore janë përzgjedhur nga disa fusha studimi të psikologjisë, si: Metodatat e kërkimit shkencor; Vlerësimi dhe trajtimi i çrregullimeve të ndryshme; Praktikume në zhvillimin e aftësive klinike; Njohja e thelluar e teorive në fusha të ndryshme, si trauma, llojet e ndryshme të terapive individuale dhe familjare (fq.4). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit, viti akademik 2019-2021, mësohet se përmban 15 lëndë / module, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale. Programi është shtrirë në 2 vite akademike dhe realizohet me 120 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). (Dokumenti 77/4.2. Plani mësimor i programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Për sa më sipër, programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky programi i referohet nivelit 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>

<p>Ilojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik</i>”, çështja 3 “<i>Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme</i>”, përshkruhet se: Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi, shprehje dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike të lidhura me:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) çrregullime të veçanta si trajtimi i traumës, trajtimi i sjelljes deviante dhe çrregullimeve të personalitetit, terapitë e individuale, familjare dhe grupi; b) forma të ndryshme trajtimi të tilla si terapia familjare, terapia e artit dhe e lojës; c) kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional dhe bashkëpunimi me profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor, si p.sh., mjekë, psikiatër, neurologë, etj; d) aftësi në kërkimin shkencor cilësor dhe sasior; (<i>Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL</i>);
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike jep njohuri të përparuar në fushën specifike të studimit ose punësimit, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së psikologjisë klinike. Sipas dokumentit “<i>Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik</i>”, çështja 3 “<i>Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme</i>”, deklarohet se programi i studimit ka si objektivi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Të ofrojë dije të integruara me qëllim që të aftësojë studentët të ofrojnë shërbime bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si intervistim, vlerësim, përshkrim klinik dhe diagnostikim, hartim i planeve të trajtimit dhe ofrimi i terapive, apo ndërhyrjeve specifike për problematika dhe grupmosha të ndryshme; b) Të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të punuar në ekipe multidisiplinare, apo për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të shëndetit mendor, duke koordinuar dijet dhe ekspertizën në funksion të adresimit profesional dhe efektiv të problemeve të shëndetit mendor;

	<p>c) Të zhvillojë aftësitë për të kuptuar dhe përdorur rezultatet e kërkimeve shkencore bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si dhe për të hartuar dhe udhëhequr studime në fushë; (fq. 3). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, çështja 7 “Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin”, deklarohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 6). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Nga kjo pikëpamje, programi i studimit i marrë në vlerësim parashikon të zhvillojë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën përkatëse të studimit ose në aspektin profesional, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e psikologjisë klinike/ profesionit të psikologut klinik.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Neni 71, “Për programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, përcakton se “Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.</p> <p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Pika 2 e tij, shprehet se: <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</i></p>

	<p>a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</p> <p>c) rezultatet e të nxënit (objektivat formuese) dhe kompetencat profesionale;</p> <p>ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</p> <p>d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</p> <p>dh) planin mësimor;</p> <p>e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</p> <p>ë) programin lëndor (Syllabus-et);</p> <p>f) profilin e programit;</p> <p>g) diplomën dhe suplementin</p> <p>Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, Pika 2.4/a “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, përcakton se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; ii. studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; iii. përgatitje për provime; iv. përgatitje e tezës së diplomës; v. veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private; <p>Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, çështja 4</p>

(fq.4-5) “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimit” shprehet se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit janë:

- mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime)
- studimi individual (hulumtimi, kërkimi, studimi individual, punim relacionesh, detyrat apo projektet, përgatitjet e provimeve, përgatitja e tezës së diplomës, etj.)
- veprimtari të tjera të lidhura ngushtësisht me aspekte profesionale, si praktika jashtë auditorit pranë institucioneve, sipërmarrjes private dhe organizatave të ndryshme joqeveritare.


Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite.

Të dhënat e paraqitura Planin Mësimor 2019-2021, janë analizuar, organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41/2018 (e ndryshuar), për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit të ciklit të dytë, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kateg.	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018	Të dhënat në PS	
			ETCS	%
A	Lëndë Bazë	15%-20%	24	20 %
B	Lëndë karakterizuese	50%-55%	42	35%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-15%	12	10%
D	Lëndë plotësuese	10%-15%	12	10%
E	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	30	25%

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të përshkruar në dokumentin “Planin Mësimor 2019-2021”, me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të dytë, nxjerr në pah se disa kategori të programit nuk përfaqësojnë, konkretisht:

	<ul style="list-style-type: none"> - Gjenden më shumë lëndë mësimore të kategorisë A (lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 20 % të krediteve, në raport me 5% - 10% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori; - Gjenden më pak lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese) në Planin Mësimor të shprehura në 35% të krediteve, në raport me 50% - 60% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori; - Sipas përcaktimeve të VKM, Nr. 41/2018, përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”. Në rastin e programit të marrë në vlerësim, përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B rezultojnë të jetë 55%; - Gjithashtu, gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore) në Planin Mësimor të shprehura në 10% të krediteve, në raport me 12% - 20% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori; - Përsa i përket proves finale, rezultojnë 25% kredite të akorduara, krahasuar me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM nr. 41/2018; <p><i>Për sa më sipër GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B, C, E, me qëllim që të përafrohen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar);</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil Psikologji Klinike, ka përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës, si dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj. Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 18, janë caktuar 30 kredite për të fituar diplomën (fq. 11). <i>(Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL)</i></p> <p>Duke përcaktuar 30 kredite për punimin e diplomës në programin e marrë në vlerësim, FSHS/DPP demonstroi se i jep peshë dhe rëndësi të posaçme aftësimit të studentëve në fushën e kërkimit të psikologjisë klinike.</p> <p>Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, në çështjen 8 (fq.6-7) “Kërkimi shkencor në veprimtarinë akademike”, përshtrohet se</p>




	<p><i>“Kërkimi shkencor si komponent i pandashëm nga procesi mësimor, është detyrim i stafit akademik dhe studentëve, i cili pasqyrohet në “Rregulloren e programit të studimit” dhe ato të lëndëve. Në terma më konkretë, secili student duhet të përgatisë të paktën një punim akademik me temë të përcaktuar nga pedagogu, ose me temë të lirë, individualisht ose në grup. Njohuritë dhe dijet për punën kërkimore, si dhe shprehitë apo elementet e parë të veprimtarisë studimore e hulumtuese, si objektivi i posaçëm i studimeve akademike, studentët do t'i përfitojnë nëpërmjet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>shpjegimeve teorike në auditor, diskutimeve kritike rreth projekteve të realizuara dhe përmes formve të tjera didaktike;</i> • <i>projekteve të vogla kërkimore e hulumtuesedhe detyrave praktike jashtë klasës;</i> • <i>diskutimit dhe analizës së rasteve të ndryshme klinike;</i> • <i>projekteve kërkimore, punimeve apo detyrave të kursit;</i> • <i>përfshirjes në grupet e punës së aktiviteteve shkencore të departamentit;</i> • <i>pjesëmarrjes në projekte studimore pranë institucionit;</i> • <i>realizimit të temës së diplomës;</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.2</p>	
<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Struktura akademike e Fakultetit ndahet në Departamente, me personel akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Fakulteti i Shkencave Sociale përbëhet nga 5 departamente. Programi i studimi Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike, ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë Psikologjisë. Referuar të dhënave në DVV, ky department</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	plotëson detyrimin ligjor duke patur numrin prej 22 pedagogësh me tituj dhe grada, në kuadër të vlerësimit dhe akreditimit.																					
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Bazuar në DVV dhe dokumentacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Sociale si njësi kryesore, dhe Departamenti i Pedagogjisë Psikologjisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Shkencave Sociale, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ka në përbërje 5 njësitë bazë:																					
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë; 2. Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale; 3. Departamenti i Filozofisë; 4. Departamenti i Sociologjisë; 5. Departamenti i Shkencave Politike. 																					
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Referuar dokumentit <i>(Te dhenat tabekore per personelin akademik te programit te studimit)</i>, Fakulteti i Shkencave Sociale në vitin akademik 2021-2022, ka 326 staf akademik gjithsej, ku 73 janë pedagogë efektiv, dhe 253 pedagogë me kontratë.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Shkencave Sociale</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>10</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>20</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>Dr. / PhD.</td> <td>42</td> <td>98</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>1</td> <td>134</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>73</td> <td>253</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td colspan="2">326</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Psikologji Pedagogjisë, në vitin aktual 2021-2022, ka 127 personel akademik gjithsej, 22 pedagogë me kohë të plotë dhe 105 pedagogë me kohë të pjesshme.</p> <p>Njësia bazë Departamenti i Psikologji Pedagogjisë, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin</p>	Fakulteti i Shkencave Sociale	PAE	PAK	Prof. Dr.	10	9	Prof. As. Dr.	20	12	Dr. / PhD.	42	98	MSc.	1	134	Në total	73	253	Totali	326	
Fakulteti i Shkencave Sociale	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	10	9																				
Prof. As. Dr.	20	12																				
Dr. / PhD.	42	98																				
MSc.	1	134																				
Në total	73	253																				
Totali	326																					

minimal të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	6	2	-	2	-
Prof. Asoc.	4	4	1	-	1	-
Dr./PhD.	12	43	6	3	6	3
Msc.	-	52	-	3		3
Totali	22	105	9	6	9	6

(Referenca nga Evidenca 81/4.6 Te dhenat tabelore per personelin akademik te programit te studimit.pdf).

Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHS) dhe njësia bazë (DPP) përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë;
- organizimin dhe strukturën akademike;

Përsa i përket shkallës së kualifikimit të personelit akademik me kohë të pjesshme të angazhuar për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, GVJ sugjeron që të respektohet neni 59, pika 6 e tij, e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e

Bazuar në dokumentin (Material 2/1, Seksioni “Vizita dy ditore në IAL, dhe domumentacioni shtesë, e-ASCAL), mësohet se aktualisht Departamenti i Psikologji Pedagogjisë ka në përbërje të tij 1 personel ndihmësakademik për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.

<p>klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në Rregulloren e Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë (2021), Neni 11 “Përgjegjësitë e koordinatorëve të programeve të studimit që mbulon DPP” përcaktohet se “Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin, për çdo program studimi cakton një person në rolin e Koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse”.</p> <p>Në zbatim të Rregullores, DPP ka marrë “Vendim për caktimin e Koordinatorit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike” (2020) (aktit administrativ i mungon data, shiko material, 65/3.11, e-ASCAL).</p> <p>Përgjegjësi i DPP ka hartuar një shkresë të posaçme “Për përshkrimin e veprimtarisë së koordinatorit të programit të studimit” (akti administrativ nuk mban datë/vit, shiko material, 66/3.12, e-ASCAL). Sipas këtij akti administrativ, koordinatori i programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike ka këto detyra dhe përgjegjësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - koordinon punën për hartimin dhe përmirësimin e rregullores së programit të studimit; për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit të programit; për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik: planit mësimor, paketës së praktikës dhe të paketës së punimit të diplomës; - mban dosjen e dokumentacionit bazë të programit të studimit, ...; - monitoron zbatimin e planit mësimor; - koordinon organizimin e praktikës profesionale të studentëve dhe praktikës së kërkimit; - ndihmon në ndërtimin e marrëdhënieve positive ndërmjet personelit akademik, studentëve dhe palëve të jashtme; - koordinon veprimtarinë ndërmjet bashkëpunëtorve për programin; - përgatit raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së kryer për përmbushjen e misionit dhe objektivave të programit, identifikon pikat e forta dhe të dobëta dhe paraqet

	<p>rekomandimet përkatëse për përmirësimin e programit të studimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - kujdeset që të publikojë informacionin e duhur për programin e studimit në faqen zyrtare të internetit; - ndërmjetëson për zgjidhjen e problemeve, dhënien e përgjigjeve për pyetjet dhe qëllimet e programit dhe interpretimin e politikave; - ndërvepron dhe mban lidhje me studentët, personelin akademik, ndihmësakademik dhe agjencitë e jashtme/komunitetin për të lehtësuar përmbushjen e objektivave të programit; - raporton drejtuesit të njësisë bazë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi; - Etj. <p>Gjatë vizitës në institucion (20-21, korrik, 2022), Koordinatorja e Programit <i>Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i>, tregoi se “<i>Koordinatori i programit të studimit mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikqyr veprimtarinë e programit të studimit që mbulon për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të programit</i>”.</p> <p>Studentët e programit të studimit konfirmuan ruajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me Koordinatorin e Programit përkatës. Ata u shprehën se “<i>Problemet e tyre kanë marrë zgjidhje të shpejtë, për raste të tilla si: mbingarkesa me detyra, orari, nevoja për konsultime shtesë, rishikim i vlerësimeve, etj.</i>”.</p>
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Relacion mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i>” (17.09.2021) (<i>materiali 72/3.18, e-ASCAL</i>), dëshmohet se Koordinator i Programit përpilon relacion vjetor për mbarëvajtjen e procesit mësimor të programit, përfshi edhe realizimin e praktikës profesionale.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Koordinatorja e Programit, shpjegoi se “<i>Caktimi i Koordinatorit të Programit ka për qëllim të lehtësojë punën e DPP dhe të sigurojë mbarëvajtjen e programit të studimit, ecurinë e mësimdhënies në program, si dhe të raportojë te Përgjegjësi i Departamentit mbi problematikat e ndeshura në procesin mësimor, për të marrë masa e nevojshme dhe siguruar zgjidhje në kohë sa të shpejtë</i>”.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.3	
Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputnje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu IV “<i>Organizimi i studimeve</i>”, në tërësinë e neneve të tij, përcaktohet baza rregullatore për organizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit të ofruara nga FSHS.</p> <p>Nëpërmjet “<i>Kornizës konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik</i>”, FSHS/DPP ofron informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë të marrë në vlerësim.</p> <p>Gjithashtu, Plani Mësimor i programit të studimit <i>Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i> (2019-2021), përmban informacionet e nevojshme për strukturën dhe përmbajtjen lëndore të programin e studimit të ciklit të dytë të marrë në vlerësim.</p> <p>FSHS/DPP ka publikuar dokumentin “<i>Rregullore e diplomimit</i>” (2020), ku përshkruhen procedurat e diplomimit të studentëve në programeve të studimit Bachelor, Master profesional, Master i Shkencave dhe përcaktohen përgjegjësitë e strukturave akademike, ndihmësakademike dhe administrative të përfshira në procesin e diplomimit...” (Materiali 31/2.11, e-ASCAL)</p> <p>DPP ka përgatitur dokumentin “<i>Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave</i>” (2019), (Materiali 80/4.5, Paketa e punimit të diplomes për programin e studimit; e-ASCAL). Bazuar në dokumentet e mësipërme, GVJ konstaton se FSHS/DPP përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë të marrë në vlerësim, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>

<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentit “Korniza konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, Pika 4 “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimit”, mes të tjerash, cilësohet se “Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite” (fq.4).</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), në Nenin 14 “Për strukturën e studimeve”, përcaktohet se “MSH-PK realizohet në katër semestra” (fq. 10).</p> <p>Sipas Planit Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (2019-2021), rezulton se programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, të ndara në vite dhe semestra.</p> <p>Megjithatë, sikurse është argumentuar edhe në Standardin II.1, kriteri 6, <i>GVJ sjell në vemendje të institucionit sugjerimin që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B, C, E, me qëllim që të përafrohen/pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Sipas Rregullores së FSHS (2018), Kreu IV, “Organizimi i studimeve”, Neni 21, Pika 3 shprehet se “FSHS ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)” (fq. 7).</p> <p>Neni 23, i kësaj Rregullore, pika 1, përkufizon se “Studimet në FSHS zhvillohen me bazë vitin akademik...” pika. 2, “Viti akademik organizohet në dy semestra” (fq. 7).</p> <p>Referuar dokumentit “Korniza konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, Pika 4 “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimit”, përshkruhet se “Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikolog Klinik është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS (fq.4). “Programi zhvillohet me kohë të plotë, me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” (fq. 5).</p> <p>Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, viti akademik 2019-2021,</p>

	<p>mësohet se përmban 15 lëndë / module, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale. Komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, me 4 semestra dhe realizohet në total me 120 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). (Dokumenti 77/4.2. Plani mësimor i programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Nga kjo pikëpamje, programi studimit i marrë në vlerësim rezulton në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, me Pikën 2.6 “Plani mësimor” ku theksohet se: Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen: i) lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra; ii) kreditet përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike, përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, tipin e veprimtarisë mësimore, dhe komponentët të tjerë informues. Plani Mësimor i programit të studimit, përmban 15 lëndë / module, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale. Komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet në total me 120 kredite. (Dokumenti 77/4.2. Plani mësimor i programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Nuk është e qartë shpërndarja e ngarkesës mësimore javore e praktikës profesionale sepse në Planin Mësimor mungojnë të dhënat përkatëse në kolonën “ngarkesa javore”.</p> <p><i>GVJ sugjeron të përfshihet në Planin Mësimor informacioni për ngarkesën mësimore javore të lëndës së praktikës, si dhe informacioni për formën e kontrollit të dijeve ose shlyerjes së lëndëve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike</p>	<p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, pika 2.1/dh “Kreditet sipas ECTS-së”, mes të tjerash specifikohet se “Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm)”.</p>

të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", pika 2.1 "Kreditet sipas ECTS-së", germat (e) dhe (ë), lidhur me kriterin 5, shprehen si më poshtë:

e) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.

ë) IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kriterëve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.

Këto përcaktime gjejnë pasqyrim në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu V "Ekuivalentimet, Transferimet dhe ndërrimi i sistemit të studimeve", Neni 49 "Ekuivalentimi", Neni 50 "Llojet e transferimeve", Neni 51 "Procedura e kërkesës për transferim", Neni 52 "Propozimi dhe miratimi i transferimit", ku janë përshkruar të gjitha modalitetet, rregullat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit që lidhen me procedurën e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Dokumenti "Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik", pika e 5 e tij, përfshin informacion të nevojshëm për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit të studentëve (fq.5).

Gjithashtu, në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), përcaktohen të gjitha modalitetet, rregullat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit. Këtu studenti mund të informohet për të gjitha të drejtat dhe detyrime e tij, si edhe për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.



	<p>Në RVB raportohet se në programin e studimit të marrë në vlerësim, pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kriteret e përcaktuara dispozitat normative dhe udhëzimet përkatëse të Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Numri i pranimeve bazohet në kuotat e përcaktuara me vendim DPP që merr në konsideratë nevojat e tregut, mundësitë reale që Njësia Kryesore ofron për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe rregulloren e UT-së. Departamenti mund të propozojë vendosjen e kriterëve shtesë të pranimit, të cilat miratohen në Senat Akademik dhe i njoftohen brenda afateve të përcaktuara ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në shkresën "Vendim për miratimin e kuotave të DPP", datë 30.03.2021 (<i>Materiali 3.13, Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit.pdf, fq 5, e-ASCAL</i>), janë paraqitur:</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe përzgjedhëse për ciklin e dytë Master i Shkencave</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Gjuha e huaj niveli B1 e certifikuar me teste ndërkombëtare; 2) Kanë prioritet studentet e FSHS dhe UT; 3) Të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë; 4) Studentët fitues do të renditen sipas rendit zbritës të notes mesatare të ciklit të parë të studimeve universitare; <p>Kritere specifike për Master i Shkencave në Psikologji Klinike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Notë mesatare mbi 6 (gjashtë) e studimeve universitare të ciklit të parë; 2) Të zotërojnë diploma BA dhe sistemit 4-vjeçar në Psikologji. <p>Për sa më sipër, programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike përmban dokumente rregullatore të cilat përfshijnë informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p>

<p>laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>” (Material 78/4.3; e-ASCAL), vërehet se të gjitha syllabuset përmbajnë informacion të detajuar, duke filluar me titullin e lëndës, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën mësimore dhe kreditet, tipologjinë, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, objektivat e përgjithshëm/ specifike të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e orëve të leksioneve dhe seminareve apo orët e laboratorit për secilën lëndë, përfshi edhe praktikën profesionale, formën e kontrollit të dijes, bibliografinë e detyruar dhe atë të rekomanduar, etj.</p> <p>Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e <i>syllabus</i>-eve, në programin e studimit përmban të gjitha elementet në përputhje me formatin e miratuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “<i>Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit</i>”, shtojca nr. 2 “<i>Programi i lëndës</i>”.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>FSHS i përmbahet bazës rregullatore dhe udhëzimeve të UT për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Në dokumentin “<i>Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të kurrikulave</i>”, Seksionin 3 “<i>Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit</i>”, përshkruhet tërësia e procedurave dhe hapave që ndiqen për hartimin, ristrukturimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në pikën 3.1.1 janë përshkruar kriteret dhe procedurat për përmirësimin e programeve të ofruara. Në këtë kuadër, janë specifikuar kategoritë e ndryshimeve. Ndryshimet në shkallë të madhe që përfshijnë ndryshime mbi masën 20 %, kanë të bëjnë me riorganizimin e programit të studimit dhe kërkojnë domosdoshmërisht miratim nga MASR. Ndryshimet në shkallë të vogël, përfshijnë ndryshime profilizuese, nën masën 20 %, miratimi i të cilave bëhet nga Senati Akademik mbi bazën e propozimit të paraqitur nga njësi kryesore dhe njoftohet MASR jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit të ri akademik. (fq. 5, 6, Materiali 36/2.16, e-ASCAL).</p> <p>DPP përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim ka publikuar gjithashtu dokumentin “<i>Politikat për përmirësimin e kurrikulës dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, viti akademik 2019-2020</i>”, ku mes të tjerash,</p>

përcaktohen objektivat dhe procedurat e përmirësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit.

Dy nga objektivat e DPP janë:

- Të rishikohen kurrikulat me qëllim përshtatjen e tyre për të pasqyruar zhvillimet në shkencën e pedagogjisë dhe psikologjie;
- Të rishikohet oferta e studimeve në mënyrë të vazhdueshme me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe European” (fq. 4).

Sipas këtij dokumenti, objektivat rishikohen çdo fillim viti akademik (fq. 4-5). Në funksion të arritjes së objektivave, DPP:

- Rishikon çdo fillim viti syllabuse duke reflektuar mbi të gjitha elementet për përmirësimin e programit të studimit;
- Monitorton të gjitha proceset e veprimtarive akademike (leksione, seminare dhe praktikë mësimore) duke filluar që nga momenti i regjistrimit të studentit deri në diplomimin e tij, duke përfshirë monitorimin e zhvillimit të të gjithë procesit mësimor dhe cilësinë e procesit të vlerësimit;
- Reflektton mbi të dhënat e mbledhura nga evidencat (pyetësorë, focus grupe të realizuara me studentë) për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e vazhdueshëm të zhvillimit profesional në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies (fq. 4-5, Materiali 3.15, e-ASCAL).

FSHS /DPP janë të vetëdijshëm për nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të programit të marrë në vlerësim. Sipas RVB, raportohet se “Ajo që mbetet për të ndryshuar është numri i lartë i krediteve që i është dhënë mikrotezës. Ky ndryshim (meqë e kalon 20% të lejuar) është në proces”.

Dokumentet e mësipërme dhe diskutimi gjatë vizitës në institucion, mbi praktikat konkrete që ndërmerr institucioni për përmirësimin e programit të studimit, dëshmojnë se përmbajtja e këtij programi është në proces përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm, dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit është e organizuar në 2 vite akademike, me 120 kredite në total dhe është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe publikohet në faqen web të IAL.</p> <p>Referuar Planit Mësimor të programit të studimit, viti akademik 2019-2021, përmban 15 lëndë / module, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale. (Dokumenti 77/4.2. Plani mësimor i programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Shqyrtimi i Planit Mësimor 2019-2021, lidhur me ngarkesën vjetore/javore të një studenti me orë mësimore brenda/jashtë auditorit për çdo vit akademik, tregoi si më poshtë:</p> <p>Viti I përmban 60 kredite = 1500 orë në vit, nga të cilat 600 orë në auditor dhe 900 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 20 orë mësimore në javë brenda auditorit dhe 30 orë në javë jashtë auditorit.</p> <p>Viti II, përmban 60 kredite = 1500 orë, nga të cilat 505 orë në auditor dhe 995 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 17 orë në javë brenda auditorit, duke përfshirë edhe praktikën profesionale, dhe 33 orë në javë jashtë auditorit.</p> <p>Në total ngarkesa mësimore brenda/jashtë auditorit, sipas Planit Mësimor, rezulton të ketë:</p> <p>390 orë leksione;</p> <p>390 orë seminare;</p>

	<p>325 orë praktikë;</p> <p>Totali 1105 orë në auditor dhe 1895 orë jashtë auditorit.</p> <p>Raporti në total midis orëve në auditor dhe jashtë auditorit është në favor të orëve jashtë auditorit me një diferencë 790 orë (31.6 kredite) më shumë punë e pavarur/individuale e studentit. Kjo situatë mund të perceptohet si mbingarkesë me punë të pavarur të studentit.</p> <p>Plani Mësimor 2019-2021, respekton përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", pikën 2.1/d ku shprehimisht thuhet se "Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe".</p> <p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu IV "Për organizimin e programeve", Nenin 21, pikën 2, specifikohet se "Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit, ku 10 deri 12 orë punë duhet të jenë në auditor".</p> <p>Për sa më sipër ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Sipas dokumentit "Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik", çështja 7 "Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin", deklarohet se "Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm" (fq. 6). Realizimi i programit të studimit bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përfëta plotësuere me ato</p>

	<p>të natyrës praktike Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi, shprehi dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike (fq. 3). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, viti akademik 2019-2021, vërehet se përmban 15 lëndë / module, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale. Lëndët/modulet janë të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese nga A në E referuar VKM nr. 41/2018, si dhe në vite e semestra dhe me kreditet përkatëse. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet me 120 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). (Dokumenti 77/4.2. Plani mësimor i programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Shpërndarja e lëndëve dhe praktikës në Planin Mësimor të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike ndjek një hierarki të caktuar që kulmon në semestrin e katërt me punimit e diplomës në kuadër të provës finale. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikës, mundëson studentët që të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për punësim, ose mundëson ata të vijojnë studimet në programe të ciklit të tretë.</p> <p>Megjithatë, <u>GVJ sugjeron</u> që të përshtatet emërtimi i syllabusit të lëndës të "Praktikë në institucion" me emërtimin e lëndës "Praktikë" të përcaktuar në Planin Mësimor (2019-2021) të programit të studimit të marrë në vlerësim.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lidhur me shpërndarjen e lëndëve/moduleve sipas kategorive nga A në E, për çdo vit akademik të Planit Mësimor, vërehet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Në vitin e I-rë akademik zhvillohen:</u> <ul style="list-style-type: none"> - 3 lëndë të kategorisë A (lëndë bazë/ 18 kredite); - 6 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/36 kredite); - 1 lëndë e kategorisë C (lëndë me zgjedhje/ 6 kredite); ▪ <u>Në vitin e II-të akademik zhvillohen:</u> <ul style="list-style-type: none"> - 1 lëndë e kategorisë A (lëndë bazë/ 6 kredite); - 1 lëndë e kategorisë B (lëndë karakterizuese/ 6 kredite); - 1 lëndë e kategorisë C (lëndë me zgjedhje/6 kredite);

- 1 lëndë e kategorisë D (praktika 12 kredite);
- 1 lëndë e kategorisë E (prova finale/ 30 kredite);

Praktika Profesionale (kategoria D/12 kredite/300 orë, nga të cilat 275 orë në auditor dhe 25 orë jashtë auditorit) zhvillohet në semestrin e parë të vitit të dytë. Llogariten rreth 18.3 orë/në javë në auditor dhe 1.7 orë /në javë jashtë auditorit, ose 3.6 orë /në ditë në auditor dhe 0.3 orë jashtë auditorit.

Nuk është e qartë shpërndarja e ngarkesës mësimore javore e praktikës profesionale, sepse në Planin Mësimor mungojnë të dhënat përkatëse në kolonën “ngarkesa javore”.

Dokumentet të tilla, si Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (2019) dhe Rregullore e Praktikës Profesionale (2018) nuk shprehen për ngarkesën javore të praktikës.

Në syllabusin e lëndës “Praktikë në institucion” (në planin mësimor emërtohet “Praktikë”) shpjegohet se “Praktika në institucion është e organizuar në mënyrë të tillë që të mbështesë zhvillimin e shprehive konkrete profesionale të studentëve, përmes përfshirjes në institucionet që ofrojnë shërbim psikologjik në vend. Gjatë këtij procesi, studentët prezantohen me mjediset, rregullat dhe marrëdhëniet e punës së psikologut klinik, si dhe kontekstin e gjërë të ofrimit të këshillimit në institucionet në vend. Lënda organizohet përmes ndarjes së studentëve në grupe sipas zgjedhjes së tyre dhe atashohen pranë një institucioni të propozuar nga pedagogu i lëndës. Pedagogu është përgjegjës për vendosjen e marrëdhënieve institucionale midis studentëve dhe institucionit përkatës, duke nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje përcakton detyrimet e institucionit për të monitoruar frekuentimin dhe progresin e studentëve, si dhe për të hartuar një raport vlerësues për studentët pjesëmarrës”.

GVJ sugjeron të plotësohen të dhënat në Kornizën konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik dhe Planin Mësimor të programit të marrë në vlerësim, lidhur me ngarkesën javore të lëndës së praktikës, si dhe të gjej pasqyrim elementi i praktikës në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (2019)

<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar “Master i shkencave” dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në Planin Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, viti akademik 2019-2021, janë pasqyruar 15 lëndë, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale, të cilat janë ndarë sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dhe me kreditet përkatëse.</p> <p>Çdo lëndë në Planin Mësimor e parashikuar për t’u zhvilluar në auditor, përbëhet nga komponentët mësimore si “leksione” dhe “seminare”. Nuk konstatohen lëndë të cilat përveç leksioneve dhe seminareve, të përfshijnë edhe komponentin mësimor “laborator”.</p> <p>Komponenti i praktikës përmban 12 kredite /300 orë dhe zhvillohet në semestrin e parë, të vitit të dytë.</p> <p>Nga kjo pikëpamje, raporti teori – praktikë në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike (12 kredite/300 orë) rezulton në favor të teorisë me 90% kredite teori dhe 10% kredite praktikë. Ky raport është në përputhje me natyrën e programit Master i Shkencave dhe me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit” (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e dytë).</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, u shpjegua se “Detyrat lëndore / studimore që u jepen studentëve për t’u punuar në auditor ose jashtë auditorit, si dhe teza e diplomimit synojnë që të lidhin ngushtësisht teorinë me praktikën”.</p> <p><i>GVJ sugjeron të merren në shqyrtim komponentët mësimorë të disa lëndëve profesionale në Planin Mësimor të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, të cilat janë parashikuar të zhvillohen vetëm me leksione dhe seminare, për të gjykuar mbi nevojën e përfshirjes edhe të komponentit “laborator”.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumentit “Korniza kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike”, çështja 3 “Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme”, përshkruhet se “Realizimi i programit të studimit bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përfëta plotësuese me ato të natyrës praktike Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët klinikë të zhvillojnë</p>

aftësi, shprehi dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike” (fq. 3).
(Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL)

Në Planin Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, viti akademik 2019-2021, janë pasqyruar 15 lëndë, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale, të cilat janë ndarë sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dhe me kreditet përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat lidhur me strukturën e programit të studimit referuar Planit Mësimor, krahasuar me përcaktimet në VKM Nr. 41/2018 “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit” (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e dytë)

KATEG.	Përshkrimi	Sipas VKM 41	Të dhënat në PS	
			ETCS	%
A	Lëndë Bazë	15%-20%	24	20 %
B	Lëndë karakterizuese	50%-55%	42	35%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-15%	12	10%
D	Lëndë plotësuese	10%-15%	12	10%
E	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	30	25%

Analiza e të dhënave tregon se ngarkesa në kredite për lëndët e kategorisë A, B, C dhe E, nuk janë në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41/2018 për programet e ciklit të dytë Master i Shkencave. Gjithashtu, lëndët e kategorive A dhe B, të marra së bashku, rezultojnë më pak se 60 kredite të përcaktuara në VKM Nr. 41/2018 (e ndryshuar me VKM Nr. 879/2019) për rastin e programeve “Master i shkencave”.

Komponenti i praktikës përmban 12 kredite /300 orë dhe zhvillohet në semestrin e parë, të vitit të dytë.

Nga kjo pikëpamje, raporti teori – praktikë në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike (12 kredite/300 orë)

	<p>rezulton në favor të teorisë me 90% kredite teori dhe 10% kredite praktikë. Ky raport është në përputhje me natyrën e programit Master i Shkencave dhe me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit” (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e dytë).</p> <p>Pavarësisht se ndarja sipas veprimtarive formuese të programit të studimit të marrë në vlerësim, nuk përputhet me përcaktimet e VKM NR. 41/2018, raportet midis formimit teorik (90% kredite) dhe praktik (10% kredite) mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Procedurat për transferimin e studentëve përshkruhen në Rregulloren e FSHS (2018), Kreu V “Ekuivalentimi, transferimet dhe ndërrimi i sistemit të studimeve”. FSHS dëshmon se gjatë viteve 2019-2021 është transferuar vetëm 1 (një) student nga programi Master i Shkencave në Psikologji Klinike. (Materiali 84/4.9 “Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit”, e-ASCAL).</p> <p>Gjithashtu, FSHS/DPP dëshmon për praktika të mira të përfshirjes së studentëve në projekte mobiliteti. Duke filluar nga viti 2020 deri në vitin 2022 rezultojnë 8 studentë të programeve që ofron DPP, të cilët kanë përfitur nga shkëmbimet në kuadër projekti. Nuk bëhet me dije se sa prej tyre i përkasin programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (Materiali 74/3.20 “Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve”, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Shqyrtimi i programeve lëndore (syllabuset) për dy vitet e studimit të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, tregoi se ato janë hartuar në përputhje me elementet e modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, Pika 2.8 “Programi lëndor (syllabus-et)”, (i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca 3 “Programi i lëndës”)</p> <p>Në Rregulloren e DPP (2018), Neni 11 “Përgjegjësitë e koordinatorëve të programeve të studimit që mbulohen nga DPP”,</p>

	<p>Pika 9 e tij, shprehimisht thuhet se <i>“Koordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me titullarët e lëndëve është përgjegjës për përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të programit të studimit, duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të pesë viteve të fundit”</i>.</p> <p>Lidhur me këtë element të programit lëndor janë evidentuar praktika të mira të përditësimit të literaturës. Gjenden disa syllabuse që kanë përfshirë botime të 5 viteve të fundit si: 2021; 2020, 2019, 2018, 2017 dhe 2016 (<i>Materiali 78/4.3, Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, fq. 27; 36; 51; 58; 78; e-ASCAL</i>)</p> <p>Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë që titullarët e tyre të vijojnë përpjekjen për të përditësuar literaturën bazë të detyruar dhe literaturën ndihmëse/ të rekomanduar me botime të 5 viteve të fundit. Gjithashtu, janë vërejtur raste kur literatura e rekomanduar dominohen kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze dhe ofrohet për studentët me një numër të jashtëzakonshëm titujsh për studim, p.sh, 57 tituj/ për lëndë ose 82 tituj/për lëndë, ku shumica është në gjuhë të huaj angleze. (<i>Materiali 78/4.3, Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, fq. 27-30; 42-45; e-ASCAL</i>).</p> <p>Për këto raste, gjatë takimit në institucion, stafi akademik arsyetoi se studentët zotërojnë gjuhën angleze dhe punojnë lehtësisht me literaturën. Titullarët e lëndëve kujdesen që literatura të jetë e aksesueshme, qoftë në librari, në bibliotekën universitare, apo bibliotekat digjitale, duke u ofruar studentëve literaturë në format e-book, kryesisht në gjuhën angleze. Përveç kësaj, titullarët e lëndëve kanë përgatitur cikle të leksioneve në gjuhën shqipe. Ndërkohë, studentët pohuan gjatë takimit në institucion se ata nuk ndihen të mbingarkuar me literaturën bazë dhe të rekomanduar në gjuhë angleze.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Referuar dokumentit <i>“Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”</i>, çështja 3 <i>“Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme”</i>, deklarohet se programi i studimit është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi, shprehi dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike të lidhura me:</p>

	<p>a) çrregullime të veçanta si trajtimi i traumës, trajtimi i sjelljes deviante dhe çrregullimeve të personalitetit, terapitë e individuale, familjare dhe grupi;</p> <p>b) forma të ndryshme trajtimi të tilla si terapia familjare, terapia e artit dhe e lojës;</p> <p>c) kompetenca të lidhura me rritjen e efijencës profesionale dhe bashkëveprimi me profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor, si p.sh., mjekë, psikiatër, neurologë, etj;</p> <p>d) aftësi në kërkimin shkencor cilësor dhe sasior;</p> <p>Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, çështja 7 “Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin”, deklarohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 6). Realizimi i programit të studimit bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përfëta plotësuese me ato të natyrës praktike Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi, shprehi dhe shkathësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike (fq. 3). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve</p> <p>Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit mundëson studentët për vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut</p>

e punës. Punësimi në profesionin e psikologut klinik është i rregulluar me Ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e psikologut në RSH”, i cili sipas Nenit 2, ka për qëllim përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e profesionit të psikologut, garantimin e standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të psikologut. Një nga kriteret kyç për punësim është që kandidati të ketë plotësuar 2 cikle të plota studimi Bachelor në Psikologji dhe Master në një degë të specialitetit në Psikologji, të ketë kryer praktikën e supervizuar njëvjeçare pas përfundimit të studimeve Master, dhe të ketë fituar licensën përmes Urdhrit të Psikologut për ushtrimin e profesionit.

Në studimin e DPP me temë “Alumni në Master Shkencor në Psikologji Klinike. Rezultate mbi punësimin” (2021), raportohet se studentët e diplomuar në MSH në PK, pjesëmarrës në studim, janë punësuar kryesisht në sektorin publik (41.4%), ndjekur nga ai jofitimprurës (28.6%) dhe privat (20%). Një pjesë e të diplomuarve raportojnë se janë të angazhuar në më shumë se një sektor punësimi. Të dhënat paraqesin disa lloje pozicionesh përtej aplikimit të profesionit si psikolog klinik, si në sektorin publik, por edhe në atë jofitimprurës e privat. (89/4.14. Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve të programit, e-ASCAL).

Bazuar në materialin “Gjurmë të njohjes së kurrikulës jashtë vendit”, mësohet se institucioni ruan komunikimin në distance me ish-studentë të diplomuar në programet e studimit të ofruara nga FSHS/ DPP, të cilët kanë vijuar ose përmbyllur studimet e tyre në fushën e psikologjisë në universitete të tjera jashtë vendit dhe aktualisht janë përfshirë në tregun e punës në vendet ku jetojnë. (Materiali 7/6, Seksioni: Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë; e-ASCAL)

Të dhënat e mësipërme dhe rezultatet e studimit për punësimin e ish-studentëve të diplomuar në FSHS/DPP, janë një tregues real se përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve ose punësimin në përshtatje me kërkesat e tregut e punës brenda dhe jashtë vendit.

Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të

FSHS/DPP ka përpunuar dokumentin “Politika për përmirësimin e kurrikulës dhe cilësisë së mësimdhënies, viti akademik 2019-

integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

2020”, ku përfshin “*parimet dhe procedurat e vlerësimit, me qëllim garantimin e cilësisë, efektshmërinë e kërkuar dhe përmbushjen e standardeve*” (fq. 3). Në këtë dokument, ndër objektivat strategjik të zhvillimit, DPP ka parashikuar se duhet:

- (6) Të rishikohet oferta e studimeve në mënyrë të vazhdueshme me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe European (fq. 4).

FSHS, si pjesë e UT, dëshmon se ka vendosur marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit. Format standard i aplikuar nga FSHS/DPP “*Marreveshje bashkëpunimi ndërmjet FSHS/DPP dhe institucionit për zhvillimin e praktikës në institucion*” (materiali 3.27, e-ASCAL), dokumenton bashkëpunimin ndërinstitucional mbi bazën e përgjegjësisë reciproke lidhur me kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale. Gjatë vizitës në institucion, drejtuesja dhe koordinatoresha e programit të studimit shpjegoi se rishikimi i programeve të studimit bëhet para fillimit të vitit të ri akademik. Ky proces synon korrigjimin e problemeve që janë ndeshur gjatë procesit mësimor dhe praktikave profesionale, si dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në përgjigje të kërkesave të tregut të punës. Vëmëndje e posaçme tregohet për përmirësimin e programeve lëndore, duke reflektuar prirjet teorike dhe praktike më të mira në fushat lëndore respektive, si dhe rifreskimin e burimeve të literaturës bazë të detyruar dhe të rekomanduar për studentët. Në lëndën e praktikës, diskutohet së bashku me studentët rreth sfidave që janë hasur gjatë periudhës së praktikimit dhe pasi analizohen me kujdes, kthehen në objektiva për vitin pasardhës. DPP planifikon takime pune, tryeza të rrumbullakta, si dhe vendos komunikim të drejtpërdrejtë me institucionet partnere, jo vetëm për realizimin e praktikës profesionale, por edhe për të përfituar nga konsultimi me ekspertë të ndryshëm nga këto institucione lidhur me sfidat për të përmirësuar programin e studimit MSH-PK, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës.

GVJ vlerëson si një praktikë të mirë që FSHS/DPP konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës për përmirësimin e përmbajtjes së programit të

	studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, si dhe përshtatjen sa më mirë të tij me kërkesat e tregut e punës.			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	<p>Referuar Planit Mësimor 2019-2021, programi i studimit përmban 90% kredite teori dhe 10% kredite praktikë. Ky raport është në përputhje me natyrën e programit Master i Shkencave dhe me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, i ndryshuar (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e dytë).</p> <p>Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, çështja 7 “Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin”, deklarohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 6). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor të ofruara në programin e studimit të ciklit të dytë MSH-PK, mundëson njohuri të avancuara për studentët për të kryer studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve sipas kriterëve të caktuara.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Referuar Dokumentit nr. 81/4.6 Te dhenat tabekore per personelin akademik te programit te studimit, në veçanti tabelave përmbledhëse të këtij dokumenti, si dhe Materialit nr. 11, ngarkesa mesj,ore 21-22 MSC Klinik.docx,, Seksioni "Vizita dy ditore në IAL, dhe domumentacioni shtesë, e-ASCAL, rezulton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike, është:

1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 6 PAK.
2. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 15 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 6 PAK.
3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 15 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 6 PAK.

Tituj/grada	2021 - 2022		2020- 2021		2019 - 2020	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	1	1	2	0	2	0
Prof.As.Dr	1	0	1	0	1	0
Dr/PhD	6	3	6	3	6	3
Msc (Dr në proces)	0	0	0	0	0	0
Msc	0	2	0	3	0	3
Në total	8	6	9	6	9	6

Personeli akademik me kohë të plotë (PAE) i angazhuar në realizimin e programit të studimit, rezulton 100% i kualifikuar me tituj dhe grada shkencore dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit.

Personeli akademik me kohë të pjesshme (PAK) i angazhuar në realizimin e programit të studimit për vitin 2019-2020 dhe 2020-2021, rezulton 50% i kualifikuar me gradë shkencore dhe 50% me nivelin MSc të kualifikimit. Për vitin akademik 2021-2022, rezulton 67% e PAK e kualifikuar me titull dhe gradë shkencore dhe 33% me nivelin MSc të kualifikimit.

Në këtë aspekt, GVJ sugjeron të respektohet Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59 i tij “Për kategoritë e personelit akademik”, Pika 6, ku specifikohet se: *Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.*

Sipas tabelës nr. 4 “Viti akademik aktual 2021-2022”, kolona “Ngarkesa mësimore (orë) në Msc 2020-2021”, konstatohet se: nga 1200 orë mësimore në total, **PAE mbulon 690 orë (57.5%) dhe PAK mbulon 510 orë (42.5%).**

Krahasimi i të dhënave të paraqitura në tabelën nr. 4 “Viti akademik aktual 2021-2022”, kolona “Ngarkesa mësimore (orë) në Msc 2020-2021”, me të dhënat në Planin Mësimor 2019-2021 për ngarkesën mësimore/ për orë në auditor, tregoi se gjenden disa gabime teknike/mospërputhje lidhur me shpërndarjen e lëndëve/orëve mësimore në ngarkim të PAE dhe PAK. (Për më tepër shiko tabelën e mëposhtme).

PAE/ PAK	Lëndë sipas Planit Mesimor 2019-2021	Orë mësimore në auditor sipas Planit Mësimor 2019-2021	Ngarkesa mësimore (orë) në Msc 2020-2021	Shënime
PAE/ PAK	Psikopatologjitë e fëmijëve dhe adoleshentëve	60 orë	60 orë	
PAE	Praktikum në vlerësimin e fëmijëve dhe adoleshentëve	60 orë	60 orë	
PAK	Metoda të avancuara kërkimi në psikologji	60 orë	60 orë	
PAE	Metodat e avancuara statistikore në psikologji	60 orë	60 orë	
?	Neuropsikologji klinike	60 orë	-	Lënda nuk është

					përfshire në tabelën për ngarkesën mësimore. Gjenden 60 orë më pak nga Plani Mësimor
PAE	Praktikum në këshillim individual	60 orë	60 orë		
PAE/PAK	Psikopatologjitë e moshës së rritur	60 orë	60 orë		
PAE/PAK	Terapia familjare: parimet dhe metodat klinike	60 orë	60 orë		
PAE	Formulim, konceptualizim dhe trajtim i rastit klinik	60 orë	60 orë		
PAK	Lende me zgjedhje sem. 1 1) Trajtimi me medikamente për çrregullimet klinike	60 orë	60 orë		
PAE	Trauma Psikologjike: kuptimi dhe trajtimi	60 orë	60 orë		
PAE	Vlerësimi dhe trajtimi i çrregullimeve të personalitetit	60 orë	60 orë		
PAE	Lëndë me zgjedhje sem 2 1) Praktikum në terapi arti dhe loje	60 orë	60 orë		

XB

PAK	2) Trajtimi psikologjik i sëmundjeve	60 orë	60 orë	
PAK	Praktikë	275 orë	150 orë	125 orë më pak nga Plani Mësimor
TOTALI		1115 orë	930 orë	185 orë më pak nga Plani Mësimor

Gjithashtu, në tabelën nr. 4, konstatohet se PAE dhe PAK kanë në ngarkim lëndë mësimore, emërtimi dhe ngarkesa mësimore e të cilave nuk ekziston në Planin Mësimor 2019-2021. Ngarkesa mësimore jashtë Planit Mësimor rezultojnë të jetë 270 orë (Për më tepër shiko tabelën e mëposhtme).

PAE	Praktikum në këshillim	30 orë	Nuk ekziston si lëndë në Planin Mësimor
PAE	Psikologji e konsumatorit	60 orë	Nuk ekziston si lëndë në Planin Mësimor
PAE	Kriza shkollore dhe ndërhyrjet	30 orë	Nuk ekziston si lëndë në Planin Mësimor
PAK	Metoda të avancuara kërkimi në psikologji	30 orë	30 orë më tepër nga Plani Mësimor
PAK	Metoda të avancuara kërkimi 1	60 orë	Nuk ekziston si lëndë në Planin Mësimor
PAE	Metodat e avancuara kërkimi 2 MSH-PSh	60 orë	Nuk ekziston si lëndë në Planin Mësimor
TOTALI		270 orë	Jashtë planit mësimor

Shqyrtimi i të dhënave në Planin Mësimor 2019-2021, për lëndët dhe ngarkesën mësimore në auditor dhe të dhënave të paraqitura në tabelën nr. 4, mbi ngarkesën mësimore të shpërndarë për PAE dhe PAK e cila zhvillon mësim në programin MSc (Psikologji Klinike), tregoi se 510 orë mësimore (55%) mbulohen nga PAE dhe 420 orë mësimore (45%) mbulohen nga PAK.

GVJ sugjeron të respektohen përcaktimet e VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të

	<p><i>arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, Pika 2 (b) e tij, “Standardet për personelin akademik të IAL-së”, ku specifikohet se: Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.</i></p> <p>Bazuar në CV-së personale të secilit prej PAE dhe PAK të angazhuar në realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, GVJ konstaton se PA ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit (<i>Dokumenti 92/4.16; CV e personelit akademik të programin e studimit; e-ASCAL</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Referuar CV-së personale të secilit nga personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit, vërehet se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e tyre, është në përputhje me drejtimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, si dhe me natyrën dhe specifikën e lëndëve/moduleve në përmbajtje të tij. (<i>Dokumenti 92/4.16; CV e personelit akademik të programin e studimit; e-ASCAL</i>).</p> <p>Gjithashtu, ngarkesa mësimore lëndore e personelit akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike është përcaktuar në përputhje me specializimin e personelit akademik dhe zhvillimin e tyre në fushën përkatëse të kërkimit shkencor (<i>Dokumenti 81/4.6 Të dhëna tabelore të kualifikimit të stafit të programit të studimit</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>FSHS/DPP, ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në nivel institucional për organizimin dhe përmbushjen e qëllimeve të praktikës profesionale, si dhe veprimtarive të tjera mësimore për realizimin e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike (<i>Dokumenti 71/3.17 Lista e marrëveshjeve Institucionale të DPP e FSHS, e-ASCAL</i>).</p> <p>DPP ka hartuar një Rregullore të Praktikës Profesionale (2018) ku janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e institucioneve të praktikës vëzhguese, informacion për zgjedhjen e agjencisë së praktikës psikologjike, procedurat e vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përmbajtja e saj, vlerësimi i praktikës, detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervisorit të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve, institucionet e mundshme për praktikën, si dhe</p>

literatura e nevojshme (*Dokumenti 79/4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL*).

DPP dëshmon se vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqytjen e studentëve për praktikën profesionale. Detyrimet e udhëheqësit të praktikës janë paraqitur në Rregulloren e Praktikës Profesionale (2018). (*Dokumenti 79/4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL*).

Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se “Në fillim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit, shpërndan ngarkesën mësimore të praktikës te stafi akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, i cili mbulon programin e studimit, si dhe cakton një udhëheqës/supervizor të praktikës për studentët. Supervizori i praktikës është staf akademik me kohë të plotë pranë DPP. Ai mbështet formalizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet FSHS/DPP dhe Institucionit ku studentët do të realizojnë praktikën profesionale. Marrëveshjet e bashkëpunimit institucional për zhvillimin e praktikës nga studentët, janë vjetore ose semestrale në varësi të nevojës dhe dëshirës së studentëve për të zhvilluar praktikën me rotacion ose në disa qendra praktike”. Në dokumentin “Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave (2019)”, janë përcaktuar standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Në Nenin 5 të Rregullores, “Për udhëheqjen shkencore” theksohet se “Çdo student/e ka të drejtë të ketë një udhëheqës shkencor. Udhëheqësi/ja që të drejtojë punën gjatë realizimit të temës së diplomës duhet të ketë të paktën gradën ose në raste të veçanta të jetë doktor në proces dhe të përvojë mësimdhënëse ose studimore në fushën në të cilën do të kryhet punimi i diplomës”. Në Nenin 6 të kësaj Rregullore, janë përfshirë përgjegjësitë dhe të drejtat e udhëheqësit (fq. 3-4). (*Dokumenti 80/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit; e-ASCAL*)

Lidhur me kriterin 4, GVJ vlerëson se FSHS/DPP, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,



	udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Referuar dokumentit të dhëna për personelin akademik të programit (<i>Tabela përmbledhëse, 2020-2021, Evidenca 81/4.6, Te dhenat tabelore per personelin akademik te programit te studimit; e-ASCAL</i>), rezulton se DPP ka në përbërje të tij edhe 3 Personel Ndihmësakademik (PN) me karakter mësimor që ndihmon në realizimin e programit të studimit, si dhe mbështet stafin mësimdhënës efektiv dhe me kontratë lidhur me organizimin të orareve të mësimin, sallave të mësimin, gjithë procesit të organizimit të provimeve, sekretimit të tyre, si dhe mbështetjen e sistemi online dhe platformës elektronike të vendosur për shërbimin e mësimdhënies në këtë program studimi. Detyrat dhe përgjegjësitë e PN janë përshkruar në Rregulloren e DPP (2021), Neni 12 (fq.9). Bazuar në CV e Personelit Ndihmësakademik, mësohet se një PN (laborant në DPP) është diplomuar për Agronomi të Përgjithshme, dhe dy PN të tjerë janë trajnuar/kualifikuar si specialist IT. FSHS/DPP angazhon Personel Ndihmësimor/ shkencor të me kualifikim kryesisht të përshtatshëm për të siguruar mbështetjen dhe mbarëvajtjen e gjithë procesin mësimor (<i>Dokument 92/ 4.16; CV e personelit ndihmësakademik për programin e studimit; e-ASCAL</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse	Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit, dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, DPP përgjegjëse për zbatimin e programit, konsultohet dhe mban parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

tregu i punës. Kjo praktikë bashkëpunimi dhe konsultimi me ekspertë nga tregu i punë, është konsoliduar ndër vite, më së shumti në kuadër të realizimit të praktikës profesionale në institucione me të cilat FSHS/DPP ka marrëveshje bashkëpunimi. Për të siguruar kontakte të drejtpërdrejta me agjensitë apo qendrat ku zhvillohet praktika, me qëllim mbarëvajtjen e praktikës profesionale të studentëve, FSHS/DPP ka caktuar një personel akademik si udhëheqës të praktikës. Sipas Rregullores së Praktikës Profesionale (2018), për detyrimet e udhëheqësit të praktikës, kërkohet që “(pika 2) *Udhëheqësi i praktikës të vendosë kontakte me agjensitë apo qendrat, në të cilat do të praktikohen studentët për të njohur me hollësi fushat, në të cilat studentët do të kenë mundësi të përfshihen (pika 3) Udhëheqësit e praktikës duhet të caktojnë një ditë në javë në dispozicion të studentëve praktikantë me qëllim që të diskutojnë për mbarëvajtjen e praktikës, problematikat e saj, si dhe të supervizohen studentët në vështirësitë personale të lidhura me praktikën*”. (Dokumenti 79/4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit (2018). fq. 4, e-ASCAL)

Gjithashtu, DPP ka caktuar me vendim departamenti një koordinator të programit të studimit, (Material 65/3.11; Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit, e-ASCAL), si dhe ka përshkruar detyrat dhe përgjegjësitë e tij (Material 66/3.12. Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit; e-ASCAL). Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 10.2.2 “Detyra dhe përgjegjësi të koordinatorit”, mes të tjerash, specifikohet se “Koordinatori bashkërendon veprimtarinë ndërmjet bashkëpunëtorëve për programin e studimit, si dhe në koordinim me drejtuesin e departamentit merr pjesë në organizimin e takimeve me palët e interesuara për të kryer studime të tregut të sotëm të punës në lidhje me kompetencat në dalje që duhet të fitojnë studentët” (fq.6-7).

Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se në përfundim të praktikës në institucione, organizohen takime ndërmjet studentëve dhe supervizorëve për të kuptuar sfidat dhe mundësitë për t'i kapërcyer ato në ardhmen. Gjithashtu, stafi akademik tregoi se disa bashkëpunime të FSHS/DPP-së me institucionet bashkëpunëtoresh dhe partnere për praktikën, kanë qënë



	<p>frytdhënëse në organizmin e tryezave të rrumbullakëta me tematika të lidhura me sfidat nga tregu i punës, workshope tematike, takime të hapura me studentë dhe pedagogë, pjesëmarrje në konferenca të përbashkëta, si dhe aktivitete të tjera në nivel institucional. Këto aktivitete kanë shërbyer për të analizuar dhe gjykuar mbi nsismat e DPP për të rishikuar, përmirësuar ose riorganizuar programet që ofron.</p> <p>FSHS përfiton të dhëna për nevojat, kërkesat dhe zhvillimet e pritshme në sektorin e shërbimeve psikologjike edhe nga diskutimet me kolegët e FSHS (pedagogë me kohë të plotë ose të pjesëshme) të cilët janë përfshirë aktivisht në tregun lokal të shërbimeve psikologjike dhe kontribuojnë në agjensi private/publike me ekspertizën e tyre në këtë fushë. Një bashkëpunim të vecantë, FSHS/DPP ka me Institucionin e Urdhrit të Psikologut, me të cilin kooperon për të këmbyer të dhëna studimore për numrin e të diplomuarve të licensuar dhe punësuar ndër vite, si dhe kontakton dhe mirëpret këshilla e propozime nga ekspertë dhe profesionistë të fushës së psikologjisë klinike, lidhur me zhvillimet e reja në tregun punës me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit të marrë në vlerësim.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>FSHS/DPP inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), në Nenin 10.2.2 "<i>Detyra dhe përgjegjësi të koordinatorit</i>", specifikohet se "<i>Koordinatori ndërvepron dhe mban lidhje me studentët, personelin akademik, ndihmësakademik dhe agjencitë e jashtme/komunitetin për të lehtësuar përmbushjen e objektivave të programit</i>" (fq. 7).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se koordinatorja e programit MSH-PK, në zbatim të Rregullores përkatëse, kryen takime periodike me studentët dhe pedagogët e përfshirë në këtë program, për të ndjekur nga afër dhe zgjidhur në kohë problematikat e mundshme. Këto takime synojnë që të inkurajojnë studentët të diskutojnë hapur rreth problemeve apo vështirësive të ndeshura, si dhe të përcjellin mendimet dhe</p>

	<p>propozimet e tyre për çështje të ndryshme, duke kontribuar në përmirësimin e procesit mësimor dhe arritjes së objektivave të programit të studimit. Në rastet kur studentët kanë vërejtur nevojën për të rishikuar orarin mësimor, apo aspekte të mbingarkesës me detyra, vecanërisht për studentët e punësuar, koordinatori ka diskutuar me pedagogë të caktuar për të përshtatur oraret ose rishikuar afatet e dorëzimit të detyrave, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>FSHS/DPP mban kontakte me studentët e diplomuar në mënyrë të vazhdueshme, konsultohet me ta dhe merr prej tyre propozime profesionale për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. DPP dëshmon se përfshin ish-studentët e diplomuar në MSH-PK, në studime me qëllim përmirësimin e treguesve të cilësisë së programit të studimit që ofron. Struktura përgjegjëse për programin, ka kryer studim me temë “<i>Alumni në Master Shkencor në Psikologji Klinike. Rezultate mbi punësimin</i>” (2021), ku informohet për numrin dhe sektorët e punësimit të studentëve të diplomuar në MSH në PK (<i>Matriali 4.14. Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve të programit; e-ASCAL</i>).</p> <p>Shqyrtimi i mesazheve të shkëmbyera në rrugë elektronike të përfshira në materialin “<i>Gjurmë të njohjes së kurrikulës jashtë vendit</i>”, tregon se institucioni ruan komunikimin në distance me ish-studentët të diplomuar në programet e studimit të ofruara nga FSHS/DPP, të cilët kanë vijuar ose përmbyllur studimet e tyre në fushën e psikologjisë në universitete të tjera jashtë vendit dhe aktualisht janë përfshirë në tregun e punës në vendet ku jetojnë. Përmes këtij komunikimi, institucioni jo vetëm mbledh informata për tregun ndërkombëtar të punës, por edhe mat, krahason dhe vlerëson nivelin cilësisë së programeve të studimit që ofron. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se një pjesë e ish-studentëve të diplomuar në MSH-PK, bashkëpunojnë me departamentin në kuadër të praktikave profesionale dhe luajnë rolin e supervisorëve në institucionet ku janë punësuar. Ata janë aktivë në bashkëpunimin me FSHS/DPP, duke diskutuar, informuar, zhvilluar ide jo vetëm për mbarëvajtjen e praktikave profesionale, por edhe për rishikimin dhe përmirësimin e programeve lëndore, apo kurrikulës së programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. DPP ka shpallur si një ndër objektivat e zhvillimit strategjik për programin e marrë në</p>



	<p>vlerësim, realizimin e takimeve periodike me studentet e diplomuar ndër vite për të identifikuar pikat e dobëta të programit të studimit me synim përmirësimi. <i>(Dokumenti 60/3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit e-ASCAL)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</p>	<p>FSHS si pjesë e UT, dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe dhe kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor, agjensi, qendra shërbimi dhe trajtimit psikologjik, etj., me të cilat bashkëpunon për realizimin të praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore, dhe që ndihmojnë institucionin të reflektojë dhe të punojë për mbarëvajtjen, përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi, sikurse programi MSH-PK. <i>(Materiali 71/3.17 Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit dhe partnereve për praktiken profesionale; e-ASCAL).</i></p> <p>Në dokumentit “<i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2018-2023)</i>” DPP ka shpallur si një prej drejtimeve prioritare të saj zhvillimin e kurrikulës. Institucioni është angazhuar për të përmbushur objektivat lidhur me rishikimin e përmbajtjes së kurrikulës së studimit për të reflektuar në kurset e ofruara, zhvillimet dhe debatet më të fundit në shkencën e psikologjisë. <i>(Dokumenti 60/3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit’ fq. 7, e-ASCAL).</i></p>
<p>Kriteri 5. në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme</p>	<p>FSHS si pjesë e UT, dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me rrjete profesionistësh nga fusha e shërbimeve dhe trajtimeve psiko-sociale, shërbimi social shtetëror, shërbimi i provës, shoqata të ndryshme si: kryqi i kuq, ndihmoni jetën, save the children, etj., qendra komunitare e shëndetit mendor, etj., me të cilat bashkëpunon për realizimin të praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore, dhe që ndihmojnë institucionin të reflektojë dhe të punojë për mbarëvajtjen, përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi, sikurse programi msh-pk. <i>(materiali 71/3.17 lista e marreveshjeve të bashkëpunimit dhe partnereve për praktiken profesionale; e-ASCAL).</i></p>

	Gjatë vizitës së institucion, GVJ mësoi se FSHS/DPP ka marrëdhënie bashkëpunimi edhe me Institucionin e Urdhrit të Psikologut, me të cilin kooperon për të këmbyer të dhëna studimore për numrin e të diplomuarve të licensuar dhe punësuar ndër vite, si dhe kontakton dhe mirëpret këshilla e propozime nga ekspertë dhe profesionistë të fushës së psikologjisë klinike, lidhur me zhvillimet e reja në tregun punës me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit të marrë në vlerësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi II.7

Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik”, në çështjen 7 “Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin”, përkufizohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 6). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Tërësia e njohurive dhe kompetencat që synon të arrijë programi i studimit, janë në përputhje me prioritetet madhore të shpallura</p>



	<p>në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të UT (2018-2023)”, ku mes të tjerash deklarohet se “UT synon që përmes programeve të studimit t’i orientojë studentët drejt të menduarit analitik dhe ndërdisilnor, dhe t’i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës. Studentëve, krahas njohurive në disiplinat përkatëse dhe disiplinave të përafërta, duhet t’u ofrohen edhe kompetenca të tjera të nevojshme për të përgatitur jo vetëm profesionistë të mirë, por edhe qytetarë të angazhuar në shoqëri (fq. 5). (Dokumenti 5/1.4; e-ASCAL).</p> <p>Në linjë me këtë dokument strategjik, FSHS/DPP ka përpunuar dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2020-2024)” të përqëndruar në shtyllat prioritare si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Zhvillimi i kurrikulës; 2) Përsosmëria në mësimdhënie dhe në të nxënë; 3) Kërkimi shkencor; 4) Zhvillimi i partneriteteve; 5) Ndërkombëtarizimi; 6) Sigurimi i cilësisë;
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>FSHS/DPP nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Për përmbushjen e këtij kriteri, FSHS/DPP udhëhiqet nga përcaktimet e “Kodit të Etikës së UT (2011)”, Neni 6 i tij, pika 1, që shprehet se “Personeli akademik gëzon liri akademike në kërkimet, punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performance të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentimit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikse, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq.4). (Dokument 6/1.5; e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Për përmbushjen e këtij kriteri, FSHS/DPP udhëhiqet nga “Kodi i Etikës së UT (2011)”,</p>

studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.

Neni 6 i tij "Përhapja e dijeve dhe liria akademike", pika 3, që përcakton se "Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lire dhe të pavarur, si dhe t'u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit" (fq.4). (Dokument 6/1.5; e-ASCAL).

Gjithashtu, FSHS/DPP bazohet edhe në "Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019)", Neni 7 i tij "Veprimtaria e MSH-PK", ku mes të tjerash përshkruhet se "Veprimtaria kërkimore realizohet nëpërmjet kërkesave specifike të lëndëve/moduleve të ndryshme, punimeve empirike të diplomës, konferencave, sesioneve shkencore, seminareve dhe veprimtarive të tjera me fokus kërkimin. Gjetjet e projekteve kërkimore do të diskutohen nëpërmjet konferencave, sesioneve shkencore, seminareve dhe veprimtarive të tjera studentore, me përfshirje edhe të stafit akademik" (fq. 4).

Në dokumentin "Raport periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikim dhe kërkim shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit (2016-2021)", DPP shpjegon se "Mësimdhënia është e lidhur ngushtë me kërkimin, e reflektuar kjo me realizimin e temave studimore apo nga përvoja e fituar nga pjesëmarrja në konferenca, seminare, leksione të hapura nga ana e stafit akademik. Rezultatet e këtyre bëhen objekt diskutimesh përgjatë orëve në auditor me studentët me qëllim motivimin e tyre për t'u afruar me kërkimin shkencor, si dhe zhvillimi i detyrave të kursit, dhe temave të diplomave, ku studentët zhvillojnë aftësitë e tyre mbi metodologjinë e punës në kuadër të kërkimit shkencor. Gjithashtu, përgjatë vitit akademik organizohen mësimet të hapura, ku studentët prezantojnë rezultatet e punëve shkencore apo studimore, të realizuara me mbështetjen e stafit akademik" (fq. 6) (Material 86/ 4.11, Te dhenat per aktivitetet per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te personelit akademik ne 5 vitet e fundit; e-ASCAL). Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se studentët e programit angazhohen nga pedagogët e tyre në detyra kursi me karakter studimor me qëllim zhvillimin e aftësive për të hulumtuar dhe shqyrtuar literaturën përkatëse. Gjithashtu, studentët angazhohen në realizimin e projektit kërkimor në kuadër të punimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. FSHS/DPP përfshin studentët në aktivitetet shkencore të

	<p>organizuara në nivel fakulteti, në projekte mobiliteti dhe veprimtari të ndryshme studimore, me përfshirje edhe të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike përfiton nga veprimtaritë e ndërmarra nga stafi akademik i DPP në kuadër projektesh, për hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p> <p>Në dokumentin “Raport periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikim dhe kërkim shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit (2016-2021)”, deklarohet se “DPP ka për mision zhvillimin e studimeve të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në disiplinat dhe nëndisiplinat përkthëse. Vizioni i DPP është të kthehet në një agjent zhvillimi dhe kërkimi duke ofruar ekspertizë dhe kontribut në nivel zbulimesh empirike, ngritje politikash në bazë të studimeve shkencore dhe duke formuar studiues të kualifikuar dhe me integritet që mund të kontribuojnë në përmirësimin e komunitetit dhe shoqërisë (fq. 2). (Material 86/ 4.11, Te dhenat per aktivitetet per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te personelit akademik ne 5 vitet e fundit; e-ASCAL)</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p> <p>Në dokumentin “Raport periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikim dhe kërkim shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit (2016-2021)”, DPP deklaroi se “FSHS ka vendosur një fond të caktuar për studime kombëtare (fq. 4).</p> <p>Sipas “Udhëzuesit për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor që financohen nga buxheti për kërkim shkencor në UT (17.06.2019)”, shpjegohet se “Projektet e kërkimit shkencor që financohen në çdo department, nga buxheti i njësisë kryesore për shkencën, mund të propozohen nga njësitë bazë, grupet kërkimore dhe kërkues të veçantë të tyre, vetëm apo në bashkëpunim. Projektet e propozuara duhet të mbështesin dhe të synojnë arritjen e objektivave shkencore në fushat e përcaktuara nga çdo department dhe mund të zgjasin për një periudhë deri në dy vite” (fq.1). (Material 17/1.16. Udhëzues për</p>

	<p><i>procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT, e-ASCAL).</i></p> <p>Aktualisht, DPP është e fokusuar në gjenerimin e fondeve për realizimin e projekteve kërkimore në nivel departamenti. Një pjesë të fondeve parashikon ta sigurojë nga programe të BE (si: Horizon2020; Ipa Cross Border Cooperation, etj.), pjesëmarrje në rrjete bashkëpunimi rajonale (si: Core Network, etj.), apo bashkëpunime me organizata të shoqërisë civile. Në vijim do të organizohen konferenca kombëtare dhe ndërkombëtar (fq. 3). (Materiali 82/4.7, Te dhena te plota per kerkimin shkencor ne kuader te programit te studimit, e-ASCAL)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>UT/FSHS mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Sipas RVB (2022) të DPP, “Përfshirja e stafit akademik në këto projekte ka një impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit të kompetencave profesionale, mësimdhënies dhe avancimit në kërkim shkencor”.</p> <p>Disa projekte dhe aktivitete ku DPP është përfshirë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Projekti “Learning Culture in Universities (LECU)”, i drejtuar nga Zurich University of Teacher Education (Pädagogische Hochschule Zürich), International Projects in Education (IPE); 2) Përmirësimi i programit dhe ndërtimi i laboratorit të parë për këshillim profesional pranë FShS; 3) “Faces from the Past: The Fight for Freedom and Democracy during the Regime of Hoxha” with reference no. 609250-CITIZ-1-2019-1-AL- CITIZ-REMEM, grant

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>agreement no. 2019-2111/001- 001, projekt i financuar nga programi - Europe for Citizens;</p> <p>4) Sexual harassment in academic area. Kërkim, i cili po zhvillohet në nëntë vende të Europës si: Suedi, Portugali, Kroaci, Angli, Maltë, etj;</p> <p>5) Interba – Internationalization at Home: Embedding Approaches and Structures to Foster Internationalization at Western Balkans;</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>DPP, njësia përgjegjëse për programin e studimit, angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe/ose studentët për realizimin e këtyre objektivave. Në RVB (2022), DPP argumenton se “Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve të DPP-së në një sërë projektsh e studimesh me karakter kërkimor shkencor zhvillon dijet dhe kompetencat profesionale të tyre”. Disa prej projekteve ku është angazhuar stafi akademik dhe/ose studentët e tyre janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shkolla e Drejtorëve (CSL); 2) AKKSHI; 3) Validimi i instrumentit të orientimit profesional VISA si pjesë e marrëveshjes me Risi Albania dhe Universitetin e Lozanës; 4) Sfida për përmirësimin e mësimin online – projekt kërkimor, mbështetur nga AMSHC - Forumi Shqiptar Social Ekonomik – Aset; 5) Projekti kombëtar i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve “Për trajnimin e mësuesve 2019-2021”, në bashkëpunim me Fondacionin “Joscelyn”; 6) Implementation of Articles 16 & 12 of the Istanbul Convention – country report – UN Women & WWP EN; 7) Project Evaluation: “Support for the network for the catholic education institutions in Albania.” Commissioned by Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar – KKEKSH; 8) Improving the Nutrition Status of school age children in Albania, ACER and UNICEF, Methodologist and coordinator for communication for behaviour change, 2020; 9) The causes of unethical behaviours and corruption in Albanian Education system, National Study in all Albanian

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>education levels, Methodologist and data analyst, conducted by ACER and supported by Mary World Loreto, 2020;</p> <p>10) National study for needs assessment targeting LGBTI in the project "Supporting LGBTI+ People in Albania through Empowerment Services, Standardization of Social Services and Changing of Negative Stereotypes" by "Streha" Center and German Embassy, 2020;</p> <p>11) Evaluation Report "My school is a safe place" UNICEF and YËCA: Methodologist and Report writer", 2020;</p> <p>12) Bashkëpunimi me rrjetin Rajonal Western Balkans European Social Survey për të promovuar Anketën Sociale Europiane;</p> <p>13) Bashkëpunimi me GIZ për hartimin e një kurrikule për praktikat e pastrimit të parave;</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>DPP, njësia përgjegjëse për programin e studimit organizon konferenca ose aktivitete të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Organizimi i konferencave shkencore vjetore, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushë të pedagogjisë dhe psikologjisë, është kthyer në një traditë akademike për DPP. Nga ana tjetër, stafi i DPP merr pjesë në veprimtari të ndryshme shkencore që organizojnë IAL e tjera në fusha të përafërta studimi. Referuar dokumentit "<i>Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit</i>", mësohet se produktet dhe veprimtaritë shkencore të personeli akademik i DPP, janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - artikuj shkencorë 74; - referime në konferenca 132; - monografi 7; - projekte shkencore 36; <p><i>(Materiali 4.11. Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit, e-ASCAL).</i></p> <p>Referuar të dhënave të paraqitura në RVB (2022), për veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të DPP, për vitin 2020-2021, mësohet se kanë botuar rreth 11 botime shkencore. Botimet shkencore kanë qenë kryesisht brenda vendit, por disa pedagogë kanë botuar edhe në vende të Bashkimit Europian si Poloni, Itali etj. Botimet shkencore kanë</p>

	qenë si në formën e artikujve të mirëfilltë shkencorë, ashtu edhe në formën e raporteve. Gjatë vitit akademik 2020-2021 pedagogët e DPP kanë zhvilluar 15 referime në konferenca shkencore të zhvilluara në Shqipëri, Zvicër, Gjermani, Bullgari, Azerbajxhan etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>UT/FSHS nuk ka hartuar një udhëzues të veçantë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, por i ka përfshirë këta tregues në rregulloret përkatëse të programeve të studimit (Material 30/ 2.10, Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet, e-ASCAL).</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 17 “Format e mësimi” përshkruhet se “Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, posterave, praktika.</p> <p>FSHS/DPP ka hartuar Rregulloren e Praktikës Profesionale (2018) ku janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e institucioneve</p>

të praktikës vëzhguese, informacion për zgjedhjen e agjencisë së praktikës psikologjike, procedurat e vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përmbajtja e saj, vlerësimi i praktikës, detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervizorit të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve, institucionet e mundshme për praktikën, si dhe literatura e nevojshme (Dokumenti 79/4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL).

DPP ka hartuar një udhëzues të dedikuar “Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave” (2018), ku përshkruhen standardet lidhur me metodologjinë e punimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike dhe etikën e kërkimit. Gjithashtu, në këtë dokument janë pasqyruar përgjegjësitë e studentit dhe udhëheqësit të tij, si dhe tërësia e procedurave të propozimit, paraqitjes dhe mbrojtjes së provës finale (Dokumenti 80/ 4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit; e-ASCAL).

Për të siguruar vijueshmërinë e mësimit në kushtet e pandemisë COVID-19, UT ka hartuar një udhëzues të posaçëm për realizimin e mësimit online përmes platformës elektronike Microsoft Teams. Dokumenti përmban udhëzime metodologjike mbi mënyrën se si të kryhet mësimi në distance, si të përditësohen programet e lëndëve, si të vlerësohen studentët, etj. (Dokumenti 16/1.15 Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë, e-ASCAL; Material 18/1.17, Vendim për disa shtesa në Udhëzuesin e UT-së “Për zhvillimin e mësimit në distance, e-ASCAL). Kjo platformë vazhdon të përdoret gjerësisht nga stafi akademik për nevoja të procesit mësimor. Aktualisht ajo shërben si bazë dokumentacioni e vënë në dispozicion të studentëve për të aksesuar shpejt dhe në kohë reale materialet mësimore, literaturën online, apo ciklet e leksioneve, artikujt e ndryshëm shkencorë, detyrat e kursit, për të shkëmbyer njoftime të ndryshme, etj. Pavarësisht zotërimit të rregulloreve dhe udhëzuesve të ndryshëm për aspekte dhe situata të caktuara të mësimdhënies, FSHS/DPP i ka të gjitha kapacitetet njerëzore me ekspertizën e nevojshme në fushën e pedagogjisë bashkëkohore të cilët mund të angazhohen për të hartuar në të ardhmen një udhëzues në nivel institucional,



	dedikuar zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në AL.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>FSHS/DPP, si pjesë e UT ka ngritur struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>UT ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, Ekipin e Vlerësimit të Brendshëm të UT. UT ka hartuar “<i>Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT</i>” (2021), ku përcaktohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të personelit akademik të UT të të gjitha kategorive, duke filluar nga personeli me i ri e deri tek profesorët (fq. 6). Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësimor, si dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë. Niveli i arritjes që rezulton nga vlerësimi synon të reflektohet në përfitime, korrigjime ose rekomandime për të ardhmen ndaj anëtarëve të personelit akademik (fq.7).</p> <p>UT ka zhvilluar “<i>Paketën e instrumenteve të cilësisë</i>” (2020), ku janë pasqyruar pyetësorë, anketa, etj. që aplikohen në procesin e vlerësimit dhe monitorimit të punës së personelit akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor (Materiali 15/1.14 Paketa e instrumenteve të cilësisë, e-ASCAL).</p> <p>Gjithashtu, UT ka miratuar në parim “<i>Rregulloren mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ të UT</i>” (2022) 8/1.7 Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, e-ASCAL).</p> <p>FSHS ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisioni/Komiteti i Sigurimit të Cilësisë (KSC) dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel fakulteti, e cila e bazon punën e saj në Rregulloren e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të</p>



	<p>UT, Rregulloren e NJSC (2020), dhe udhëzimet përkatëse të ASCAL. Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë së FSHS përgjigjet për politikën e vlerësimit dhe zbatimin të procedurave të menaxhimit të cilësisë, si dhe këshillon dekanatin e FSHS për çeshtje të cilësisë (Urdhër i Brendshëm nr. 14/2, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit te Cilesise; e-ASCAL).</p> <p>NJSC është një strukturë ndihmësakadematike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FSHS. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit (Urdhër i Brendshëm nr. 14/1 Prot, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit te Cilesise; e-ASCAL).</p> <p>Në Rregulloren e DPP (2021), Neni 8, “Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP”, pika 8.3, gërma “m”, “Për kompetencat administrative të drejtuesit të departamentit”, përshkruhet se “bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit, bazuar në “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (në proces hartimi).</p> <p>Referuar dokumentit “Format për raportin vjetor për veprimtarinë kryerë”, pika 2 e saj, informohet se “Përgjegjësi i departamentit përmes koordinatoreve të programeve dhe studentëve monitoron dhe vlerëson vazhdimisht mësimdhënien, ku çdo semester zhvillon pyetësorin e studentëve, si dhe harton raporte mbi pyetësorin e studentëve dhe të pedagogëve” (fq. 2). (144/ 4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e NJSC (2020), Neni 6 “Veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi”, pika 4 shprehet se “Monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi bëhet në mënyrë periodike dhe për raste të vecanta” (fq. 3). Në Nenin 7 të kësaj Rregullore “Për Komitetin e sigurimit të cilësisë së FSHS”, pika 2, shprehimisht thuhet se “KSC-ja ka pesë anëtarë, një përfaqësues të dekanatit, dy përfaqësues të të personelit akademik, një personel</p>



ndihmësakademik dhe një përfaqësues të studentëve” (fq. 4). (Materiali 34/ 2.14 Rregullore e NJSC (2020) e-ASCAL).

Referuar dokumentit “Përshkrim i veprimtarisë së NJSC së FSHS”, lidhur me detyrat e NJSC, gërma “h”, specifikohet se “Në fund të çdo semestri apo përpara sezonit të provimeve, sipas kalendarit përkatës, (njësia e sigurimit të cilësisë) organizon vlerësimin studentor për cilësinë e mësimdhënies” (fq. 2). (Materiali 33/2.13, e-ASCAL)

Sipas dokumentit “Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021), “Vlerësimi i personelit akademik në njësitë përbërëse të Universitetit bëhet nga grupe të ndryshëm vlerësuesish...” (fq.9). Në Tabelën nr. 1 “Subjektet që bëjnë vlerësimin e personelit akademik” (fq. 10), vërehet se pjesë e grupeve të vlerësimit janë edhe studentët me të cilët pedagogët zhvillojnë mësim. Në Aneksin nr. 3 të këtij Manuali, është pasqyruar “Formati vlerësimit nga studentët” (fq. 29), e cila tregon se UT/FSHS garanton të drejtën e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021). Aneksi nr. 3, Formatit vlerësimit nga studentët (fq. 29); e-ASCAL)

Dokumenti “Urdhër i KSC, nr. 7, datë 14.02.2021, “Për informimin e pedagogëve dhe drejtuesve të departamenteve për rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët për vitin akademik 2021-2022”, bashkangjitur një kopje e Formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, Formularit të vlerësimit për pedagogun dhe Tabela me rezultatet të organizuara në kategori dhe të paraqitura në %, janë dëshmi se FSHS angazhohet për përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. (Dokumenti nr. 8/7. Kopje të formulareve të vlerësimit, e-ASCAL, Kategoria: Vizita dy ditore dhe dokumentacioni shtesë).

Referuar RVB (2022) lidhur me kriterin 3, si dhe deklarimeve të autoriteve drejtuese të FSHS/DPP, stafit akademik dhe studentëve të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në



	<p>Psikologji Klinike, mësohet se: Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimev, kryhet në dy nivele. Niveli i parë organizohet nga DPP në mënyrë semestrale përmes një formati të unifikuar me qëllim mbledhjen e qëndrimeve dhe verësimeve të studentëve në lidhje me lëndët dhe pedagogët përkatës.</p> <p>Përveç pyetësorit, realizohen edhe fokus-grupe me studentë. Pyetësorët realizohen në mënyrë vjetore dhe garantohet anonimati i studentëve me qëllim sigurimin e përgjigjeve objektive. Gjetjet përpunohen dhe analizohen dhe komunikohen në mbledhjet e fakultetit dhe të njësisë bazë. Ky proces garanton se mendimi i studentëve mbi programin e studimit, lëndët dhe pedagogët, jo vetëm që merret në konsideratë, por edhe u komunikohet aktorëve përkatës. Niveli i dytë garantohet përmes vlerësimit individual që kryen secili pedagog për lëndën e vet, duke u siguruar që rekomandimet dhe vërejtjet të merren në konsideratë për përmirësimin e lëndës në vijim. Gjithashtu, koordinatori i programit, siguron takime periodike me studentët me qëllim vlerësimin e vazhdueshëm të ecurisë së procesit dhe refektimin e vërejtjeve dhe rekomandimeve në përirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe dinamikave akademike që përshkojnë programin. Gjithashtu studentët marrin pjesë në Sondazhin Kombëtar të Studentëve, i cili zhvillohet nga ASCAL.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSC e FSHS është një strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FSHS. Kjo njësi ka si <i>mission</i> të planifikojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit (Urdhër i Brendshëm nr. 14/1, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12, Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit të Cilesise; e-ASCAL).</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Përshkrim i veprimtarisë së NJSC së FSHS</i>”, mësohet se “<i>Në fillim të çdo viti akademik, njësia e sigurimit të cilësisë harton planin e veprimtarisë monitoruese dhe vlerësuese dhe ia paraqet dekanit të FSHS për miratim. Për çdo veprimtari monitoruese dhe vlerësuese përgatit paketën me</i></p>




instrumentet dhe metodologjinë e përpunimit të të dhënave dhe informacionit. Në përfundim të çdo viti akademik përgatit raportin e veprimtarisë vjetore të NJSC për sigurimin e cilësisë dhe ia paraqet dekanatit të FSHS dhe KSC të FSHS. Komunikimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe vlerësimit kryhen në përputhje me Politikën e sigurimit të cilësisë së UT dhe FSHS (fq.3). (Materiali 33/2.13, e-ASCAL).

Dokumenti “Urdhër i KSC, nr. 7, datë 14.02.2021, “Për informimin e pedagogëve dhe drejtuesve të departamenteve për rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët për vitin akademik 2021-2022”, bashkangjitur një kopje e Formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, Formularit të vlerësimit për pedagogun dhe Tabela me rezultatet të organizuara në kategori dhe të paraqitura në %, janë dëshmi se FSHS angazhohet në përputhje me politikën e sigurimit të cilësisë së UT dhe FSHS.

Sipas Rregullores së Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Neni 22 “Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit”, pika 4, theksohet se “Komunikimi dhe publikimi kryhet në këto mënyra: a) Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të FSHS; b) Raportet e vlerësimit të brendshëm bëhen publike; c) Raportet e vlerësimit të jashtëm bëhen publike; d) Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike; e) Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndëve dhe mësimdhënies publikohen në mënyrë të përmbledhur; f) Raportet e vlerësimeve individuale u komunikohen individualisht individëve; g) Rezultatet e vlerësimit të arritjeve u komunikohen individualisht studentëve”.

Referuar dokumentit të DPP-së mbi “Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera”, pika 2 e saj, mësohet se “Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit bëhen të njohura nga strukturat përgjegjëse dhe diskutohen në tërësi pikat e forta dhe të dobta të nxjerra nga vlerësimet në mbledhjet e departamentit” (fq. 2). (Materiali 4.11, e-ASCAL).

	<p>Referuar RVB (2022) lidhur me kriterin 4, si dhe deklarimeve të autoriteve drejtuese të FSHS/DPP, stafit akademik dhe studentëve të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike, mësohet se:</p> <p>NJSC informon në mënyrë periodike, dekanin/përgjegjës të departamentit rreth rezultateve të vlerësimit me qëllim marrjen e masave në të ardhmen, për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive bazë dhe stafit akademik. Në përfundim të këtij procesi, hartohet një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të programit të studimit, përkundëjt standardeve shtetërore të cilësisë. Çdo pedagog informohet në mënyrë individuale për rezultatet e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Neni 13 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësive bazë” lidhur me sigurimin e cilësisë, pika g, përshkruan se “Drejtuesi i departamentit përdor informacionin e vlerësimit për qëllime të përmirësimit të veprimtarisë së njësive që drejton, të përmirësimit të programeve të studimit dhe të promovimit të personelit akademik”.</p> <p>Në Nenin 23 të kësaj Rregullore, “Për përdorimin e të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit”, specifikohet se:</p> <p><i>Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të parashikuara në këtë rregullore, përdoren për:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> a) përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm; b) akreditim; c) përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit; d) planifikimin vjetor dhe strategjik të FSHS; e) përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmëskademi dhe administrativ <p>Referuar RVB (2022) lidhur me kriterin 5, konfirmuar gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se:</p> <p>Nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, FSHS/DPP evidenton jo vetëm pikat e dobëta, por edhe praktikave të mira. Një shembull i mirë vjen nga mësimdhënia në</p>

	<p>programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, ku studentët kanë vlerësuar si të suksesshëm modelin e punës me raste studimore dhe praktikimin e aftësive teknike me anë të lojës me role. Ky model është promovuar nga DPP dhe përshtatur në një pjesë të lëndëve me karakter teknik. Për të nxitur dhe inkurajuar personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, në varësi të çështjeve të evidentuara nga rezultatet e vlerësimit periodik, FSHS/DPP angazhohet në planifikimin dhe organizimin e trajnimeve tematike lidhur me metodat e mësimdhënies, dhe aspekte të tjera të sigurimit të cilësisë, sipas një kalendari që hartohet në fillim të vitit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (2019), Neni 17 “<i>Format e mësimi</i>”, pika 1, përshkruhet se “<i>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, posterave, praktikës</i>”.</p> <p>Referuar programeve lëndore të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike veçanërisht rubrikës “<i>Format e kontrollit të dijeve</i>”, vërehet se përveç testimit/provimit si një formë e vlerësimit të rezultateve të nxënies, theksi vihet në përfshirjen e metodave që sigurojnë aktivizimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në diskutime, ushtrime praktike, detyra kurse individuale, esse, punë në grupe, angazhim në punë të pavarura kërkimore, prezantim të detyrave studimore, etj. (Materiali 78/4.3. Programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor në Psikologji; e-ASCAL)</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucionm në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, në programin e studimit, bazohen kryesisht në leksionet, seminarët, detyrat studimore/hulumtuese dhe praktika profesionale. Mësimdhënia organizohet në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme si: lojë me role, brainstorming, diskutim në grup, raste studimore, vëzhgime në situata praktike, praktika klinike, hartimi raporteve të vlerësimit klinik, veteksplorim, refleksione, analiza e çështjeve në artikuj shkencorë, nxitje e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore, prezantime në Power Point, etj, duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën. Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në projekte kërkimi/mobilitetit, në konferenca kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FSHS/DPP, si dhe në workshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni. Sipas RVB (2022), DPP raporton se një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe organizimi i leksioneve të hapura me tematika të caktuara, ku ftohen lektorë, studiues apo profesionistë të ndryshëm, vendas apo të huaj. Një shëmbull i mirë është leksioni i hapur me temë mbi psikodramën dhe vlerësimin e pacientit përmes metodave të sociometrisë, organizuar në 2019, me lektorë të psikoterapisë nga Shoqata Shqiptare e Psikoterapisë dhe Instituti i Beogradit për Psikodramën.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve</p>	<p>Personeli akademik i FSHS/DPP ka përfituar ndër vite nga projekte të mobilitetit dhe trajnimet në fushën e mësimdhënies në AL, duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies në përgjigje të diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në AL, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe dëshmon se është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p> <p>Referuar dokumentit “<i>Relacion mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i>” (2020-</p>

<p>dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>2021), mësohet se stafi akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, ka marrë trajnim në fushën e TIK për realizimin e mësimdhënies online nëpërmjet platformes elektronike TEAMS, e cila vijon të shfrytëzohet nga stafi për komunikim me studentët, për detyrat me shkrim, shpërndarjen e literaturës online, konsultime me grupe të vogla studentësh, etj., si një mundësi alternative e mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, që i përgjigjet diversitetit të nevojave të studentëve për të nxënë. (Materiali 72/3.18 Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, e-ASCAL)</p> <p>Sipas RVB (2022), DPP deklaron se: Nisur nga natyra dhe kërkesat e lëndës, stafi akademik përkatës zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies, të cilat i përgjigjen objektivat dhe natyrës specifike të lëndës, si dhe diversitetit të nevojave dhe sfidave personale të studentëve. Shembulli më tipik i referohet lëndëve me karakter teknik, të cilat realizohen përmes detyrave me fokus zhvillimin e aftësive praktike, lojë me role, improvizim, vlerësim klinik, hartim raporti bazuar në vlerësim, vetëeksplorim, studim rasti, realizim projektesh kërkimore, etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësi të bashkëbisedojë edhe me një studente me AK që ndiqte studimet në programin e marrë në vlerësim, e cila shpjegoi se institucioni mbështet përpjekjet e saj për të përfituar arsimim të barabartë, si dhe pedagogët lehtësojnë procesin e të nxënies duke përdorur forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies në përgjigje të studentëve me nevojave të veçanta.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>FSHS/DPP si pjesë e UT-së, mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Sipas dokumentit “Format për raportin vjetor për veprimtarinë e kryera”, pika 3.2 e saj, DPP sqaron se “Meqënëse UT ka një zyrë koordinimi për projektet Erasmus+ pranë rektoratit, të gjitha trajnimet në lidhje me këtë program janë zhvilluar në nivel universiteti dhe jo njësie bazë” (fq. 6).</p> <p>Në pikën 3.3 të këtij raporti, DPP informon se “Ka pasur disa shkëmbime përvojash në fushën e mësimdhënies midis stafit të DPP dhe profesoriatit të huaj... të mbuluara nga projektet</p>

	<p><i>Erasmus+</i>". Në pikën 3.4 DPP shpjegon se "<i>Departamenti ka zhvilluar konferenca në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë të mbështetura nga buxheti i fakultetit</i>". (Materiali 144/ 4.11, <i>Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL</i>)</p> <p>Referuar dokumentit "<i>Relacion mbi zhvillimin e mësimdhënies në programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike</i>" (2020-2021), mësohet se stafi akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, ka marrë trajnime të mbështetura institucionalisht për të përmirësuar kompetencat e tij në fushën e teknologjisë informatike me synim realizimin e mësimdhënies online nëpërmjet platformës elektronike TEAMS, të cilën shumica e tyre vijnë ta shfrytëzojnë për komunikim me studentët, për detyrat me shkrim, shpërndarjen e literaturës online, konsultime, njoftime, etj. (Materiali 72/3.18 <i>Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf e-ASCAL</i>)</p> <p>Bazuar në RVB (2022), DPP raporton se: UT dhe FSHS mbështesin personelin akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit në procesin mësimor. Auditorët janë të pajisura me mjete teknologjike të përshtatshme për të realizuar një mësimdhënie bashkëkohore. Zyra e IT është në gatishmëri dhe u përgjigjet në kohë reale kërkesave/nevojave/interesave të stafit akademik në lidhje me realizimin e procesit mësimor. DPP ka një marrëveshje për përdorimin e programit teknologjik "Clean Score" që realizon me objektivitet dhe shpejtësi vlerësimin e studentëve. UT/FSHS në bashkëpunim me NJSC, ka ofruar trajnime me tematikë specifike për përmirësimin e aftësive teknologjike të stafit akademik në fuksion të mësimdhënies efektive. Në këtë rast, mund të përmenden trajnimet e realizuara me personelin akademik gjatë periudhës së pandemisë, për t'iu përgjigjur transferimit të menjëhershëm të mësimin nga auditori në platformën online.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të</p>	<p>Referuar tabelës mbi "<i>Të dhënat e stafit të Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit për vitin akademik 2021-2022</i>" (Material nr. 1/2, Seksioni "<i>Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL</i>), mësohet se</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.

aktualisht “Departamenti i Psikologji Pedagogjisë ka në përbërje të tij 23 Personel Akademik Efektiv (PAE), nga të cilët 6 mbajnë titullin Prof.Dr., 4 janë Prof.Asoc.Dr., 12 kanë gradën Dr. , si dhe 105 Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga të cilët 6 mbajnë titullin Prof/Dr., 4 Prof.Asoc. Dr., 43 kanë grade Dr., 3 Proc. Dr., dhe 49 MSc”.

Bazuar në CV-në e personelit akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, mund të vërehet se secili prej tyre spikat për nga niveli i kualifikimit në fushat e specialitetit. Gjenden 100% e PAE dhe 50% e PAK të cilët mbajnë grada e tituj shkencorë, dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre, demonstroi një prodhimtari të admirueshme në fushën e publikimeve shkencore. (*Materiali 92/ 4.16 CV e personelit akademik dhe ndimesakademik per programin e studimit, e-ASCAL; Materiali 86/4.11, Te dhenat per aktivitetet per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te personelit akademik ne 5 v.pdf, e-ASCAL*).

Nga krahasimi i të dhënave të CV-së së PA dhe syllabuseve të lëndëve që ata zhvillojnë, vërehet një përputhje midis fushës akademike dhe kërkimore të titullarit të lëndës/modulit dhe profilit të programit lëndor dhe studimor që ai zhvillon.

FSHS/DPP respekton procedura dhe kriteret (të përgjithshme, të veçanta dhe preferenciale) të parashikuara në dokumentin “Manualin për punësimin e personelit në UT” (2022), për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për t’i angazhuar si staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në realizimin e programit të studimit Bachelor në Psikologji (*Materiali 13/1.12, Manuali për punësimin e personelit në UT, e-ASCAL*)

Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike.

Në dokumentin RVB (2022), DPP sqaron se: Stafi akademik i DPP që angazhohet në programin e studimit MSH-PK, përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, të cilët janë specialistë në fushën e vlerësimit klinik, trajtimit të traumës, terapisë individuale, terapisë familjare, modaliteteve specifike të terapisë për të rritur dhe fëmijë, specialistë të kërkimit shkencor, psikologjisë anormale,

	<p>psijiarisë dhe neuroshkencës. Në të gjitha rastet, stafi akademik zotëron kompetenca dhe kualifikime në përputhje me lëndën përkatëse. Gjatë vizitës në institucin, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. DPP krenohet me profesoratin e saj, një pjesë e të cilëve janë personalitete me emër në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë, të njohur kombëtarisht për kontributin e dhënë ndër vite në AL, në drejtim të ndërtimit dhe përmirësimit të kurrikulave, përgatitjes së teksteve universitare, një pjesë e të cilave përdoren jo vetëm nga stafi akademik i DPP, por edhe nga pedagogë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në vend.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas dokumentit <i>“Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021), “Vlerësimi i personelit akademik në njësitë përbërëse të Universitetit bëhet nga grupe të ndryshëm vlerësuesish...”</i> (fq.9). Në pikën 4 të këtij dokumenti <i>“Për parimet e vlerësimit”</i> specifikohet se <i>“Përgjithësisht vlerësimi bëhet nga disa aktorë, që janë drejtuesi i njësisë bazë, vetë personi (anëtar i personelit akademik), studentët dhe grupi i vlerësimit të njësisë bazë...(fq. 8).</i> Në vijim të dokumentit, në Tabelën nr. 1 janë pasqyruar subjektet që bëjnë vlerësimin e personelit akademik, duke përfshirë vetëvlerësimin dhe vlerësimin nga studentët (fq. 10). Në Aneksin nr. 1, është paraqitur <i>“Formulari i planifikimit të objektivave të performancës, sipas veprimtarive për personelin akademik/drejtues”</i> që materializon procesin e vetëvlerësimit nga ana e personelit akademik. Mbi bazën e objektivave të parashikuara, personeli angazhohet për realizimin e tyre në kohë dhe me cilësi. Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson pasqyrën e realizimit të objektivave të parashikuara, të cilat duhet të jenë të dokumentuara në dosje të veçantë pranë njësisë bazë. Kjo tabelë analizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe grupi i vlerësimit/përgjegjës i lëndës, të cilën e gjejnë atë korrekte ose jo, dhe firmosin nëse është e saktë (fq.19) <i>(Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021)</i></p>

	<p>Në Aneksin nr. 3 të Manualit, është pasqyruar “<i>Formati vlerësimit nga studentët</i>” (fq. 29), ku tregohet se UT/FSHS garanton të drejtën e studenëve për t’u përfshirë në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve (<i>Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021). Aneksi nr. 3, Format i vlerësimit nga studentët (fq. 29); e-ASCAL</i>).</p> <p>Dokumenti “Urdhër i KSC, nr. 7, datë 14.02.2021, “Për informimin e pedagogëve dhe drejtuesve të departamenteve për rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët për vitin akademik 2021-2022”, bashkëlidhur me një kopje të Formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, Formularit të vlerësimit për pedagogun dhe Tabeles me rezultatet të organizuara në kategori dhe të paraqitura në %, dëshmon një praktikë të mirë institucionale ku Personeli Akademik i FSHS vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. (<i>Dokumenti 11/7. Kopje të formulareve te vleresimit, e-ASCAL, Kategoria: Vizita dy ditore dhe dokumentacioni shtesë</i>)</p> <p>Tërësia e procedurave të vlerësimit dhe vetëvlerësimit e ndihmojnë personelin akademik të reflektojë mbi objektivat e parashikuar dhe realizimin e tyre, si nga ana sasiore ashtu edhe nga ana cilësore, si dhe të fuqizojë kulturën e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Referuar dokumentit RVB (2022), lidhur me kriterin 5, DPP arsyeton se: Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së UT. Mendimi dhe vlerësimi i studentëve bëhet pjesë e përmirësimit të cilësisë përmes përfaqësimit të tyre në organet dhe strukturat përkatëse të UT-së dhe FSHS. Po ashtu, gjykimi i studentëve merr zë përmes të dhënave e mbledhura nga pyetsori me studentët, fokus-grupet dhe komunikimi me koordinatoren e programit. FSHS dhe DPP vlerëson dhe përpiqet të adresojë kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “<i>Përhapja e dijeve dhe liria akademike</i>”, në pikën 1, përcaktohet se</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p><i>“Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimit dhe në pedagogji. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të ndërgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësues miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë kërkimin, mësimit dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efektive, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët”</i> (fq. 4). (Materiali 6/ 1.5 Kodi i Etikës UT (2011), e-ASCAL)</p> <p>Refruar programeve lëndore të përgatitura nga titullarët e lëndëve përkatëse, vërehet se theksi është vënë në përdorimin e metodave interaktive dhe diskutimit, duke synuar që orët e mësimit të jenë tërheqëse dhe gjithëpërfshirëse. Ndeshet një larmishmëri e formave të përdorura në mësimit, si: lojë me role, studim rasti, fokus-grupe, brainstorming, diskutim mbi detyrat studimore, refleksione dhe analiza, etj., që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit (Dokumenti 78/4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit, e-ASCAL)</p> <p>Në dokumentin RVB (2022), DPP shpjegon se: Ndërveprimi dhe zhvillimi i mendimit kritik, përfaqësojnë jo vetëm standardin e mësimit, por edhe objektivat e formimit. Studentët e MSH-PK nevojiten të zhvillojnë aftësinë për të komunikuar nevojat, kërkesat, pikëpamjet dhe gjykimet e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë si një nga aftësitë themelore të të qenit Psikolog Klinik. Në këtë kontekst, orët mësimore bëhen funksionale vetëm nëse garantojnë mundësinë e studentëve për të përbushur këto nevoja dhe zhvilluar këto aftësi. Studentët e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike kanë adresuar komente pozitive për pedagogët e tyre, gjatë takimit/vizitës në institucion, lidhur me metodat interaktive të përdorura gjatë leksioneve, seminareve dhe veprimtarive të tjera mësimore.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 3, kërkohet se “Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë</p>

udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t'u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit" (fq. 4). (Materiali 6/ 1.5 Kodi i Etikes UT (2011), e-ASCAL)

Sipas "Manualit të vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021), lidhur me elementet që përmirësojnë cilësinë e veprimtarisë mësimore, institucioni inkurajon personelin akademik që të angazhohet në "mbështetjen e studentëve nëpërmjet këshillimit dhe orientimit mbikqyrjes së detyrave individuale, punës kërkimore, etj." (fq. 6) (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021)

Bazuar në syllabuset lëndore të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, vërehet se titullarët e lëndëve/moduleve kanë përfshirë forma dhe metoda të mësimdhënies, të tilla si: diskutim, punim i detyrave individuale, ese reflektuese, studime rasti, etj., që inkurajojnë sensin e autonomisë së studentëve. Referuar dokumentit RVB (2022), DPP shpjegon se: Në programin e studimit MSH-PK, personeli akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore, në varësi edhe të natyrës dhe specifikave të lëndës. Në procesin e formimit të psikologëve klinikë, rritja personale shkon parallel me rritjen profesionale. Aftësimi i studentëve për të menduar në mënyrë kritike, kreative dhe të lirë, si dhe qëndrimi i hapur dhe etik ndaj pikëpamjeve personale dhe të tjerëve, përbëjnë objektiva të formimi bazë të një psikologu klinik të ri. Në këtë kontekst, studentët nxiten që të japin mendimin dhe qëndrimin e tyre kritik për çështje të caktuara që dikutohen në auditor, për raste klinike, ide dhe qasje ndryshe. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se procesi i mësimdhënies dhe të nxënimit në FSHS realizohet në një klimë pozitive. Pedagogët respektojnë lirinë e mendimit të studentëve, duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë dhe të menduarit kritik e krijues të tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit

Përmbushet pjesërisht

Përmbushet kryesisht

Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Prej vitit 2014, FSHS është vendosur dhe kryen veprimtarine e saj mesimore shkencore në një godinë të re dhe të rikonstruktuar plotësisht në funksion të një procesi bashkëkohor të ndërveprimit akademik. <i>(Materiali 54/2.33 - Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrojtja nga zjarri, higjiena, sugurimi i godinës, e-ASCAL)</i></p> <p>Sipas dokumentit “Të dhëna për infrastrukturën FSHS”, Fakulteti i Shkencave Sociale zhvillon aktivitetin e tij në një godinë me katër kate. Godina ka në dispozicion një sipërfaqje prej 7977 m² në total, ku 7154 m² shrytëzohen për mjedise për zhvillimin e mësimin të programve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë, dhe 823 m² janë zyra për stafin. Gjenden 6 salla leksionesh, 16 klasa për seminarët, 2 salla për aktivitete promovuese, 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale, 1 sallë interneti, 2 salla për bibliotekën, 1 mjedis për fotokopjime e librari, 1 zyrë informacioni për studentët, 4 koridore, 4 mjedise mbështetëse, 1 mjedis për aktivitete të qeverisë studentore, 14 nyje hidrosnitare për studentët. Këto mjedise përdoren nga 2690 studentë. Hapësira për një student rezulton afërsisht 2.7 m²/për student. Në dokumentin “Të dhëna për infrastrukturën FSHS” shënohet gjithashtu, se në këtë fakultet mësimi zhvillohet me dy turne <i>(Materiali 53/2.32 Të dhëna për infrastrukturën FSHS, e-ASCAL)</i></p> <p>Fakti që në godinën e FSHS, mësimi zhvillohet me dy turne, tregon se numri i sallave për leksione, seminarë dhe veprimtari të tjera mësimore nuk është plotësisht i mjaftueshëm. Nga kqyrja e mjediseve mësimore, gjatë vizitës në institucion, u vërejt se sallat e leksioneve dhe seminarëve në dispozicion të procesit mësimor, janë të pajisura me videoprojektor dhe</p>

	internet. Mjediset janë të ajrosura, të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i kontraktuar për këtë shërbim.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Nga kqyrja e mjediseve mësimore, gjatë vizitës në institucion, u vërejt se ambientet në mbështetje të procesit mësimor janë arraduar sipas standardeve të kërkuara dhe funksionale. Ato janë të ndriçuara dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si: videoprojektorë, ekran projektimi, tabelë. Sallat e leksioneve janë të pajisura me internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një sallë informatike të vendosur në ambientet e bibliotekës, si dhe një mjedis për fotokopjime e librari për studentët. Ambientet e FSHS janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët dhe pedagogët të aksesojnë lirisht në web. Në dokumentin RVB (2022), lidhur me kriterin 2, theksohet se: Stafi akademik është i pajisur me laptopë dhe secili pedagog i vendos në funksion të procesit mësimor. Gjithashtu, personeli ndihmës i IT qëndron në dispozicion të mbarëvajtjes së të procesit mësimor.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	<p>Universiteti i Tiranës ofron për personelin akademik dhe studentët platformën online “Microsoft Teams” (<i>Dokumenti 16/1.15 Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë</i>). Personeli akademik sqaron se kjo platformë ka nisur të përdoret fillimisht në përgjigje të kushteve të izolimit nga pandemia Covid19, por gradualisht kjo infrastrukturë është konsoliduar dhe vijon të përdoret nga pedagogët dhe studentët për nevoja mësimore, si: leksione, literaturë online, materiale shtesë audio-vizive, njoftime, konsultime, etj.</p> <p>UT/FSHS është abonuar në platforma online dhe shfrytëzon bibliotekat online për nevoja mësimore dhe kërkimore, si EuroPS – Services; Publications UNRISD; Springer; Journals.Sage Pub; Wiley dhe U-library-COBISS (<i>Dokumenti 2. 29; 2.30 dhe 2.31 Relacioni mbi Fondin e Biblotekës së FSHS; Buxhetimi për Bibliotekën për vitin e fundit</i>)</p> <p>Ambjentet e FSHS janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët dhe pedagogët të aksesojnë lirisht në web.</p> <p><i>GVJ sugjeron se, do të ishte e dobishme për programet e studimit që ofron FSHS, ngritja e një laboratorit të IT në</i></p>

<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p><i>mbështetje të procesit mësimor, si dhe të zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentëve në fushën e TIK.</i></p>
	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike ofrohet në gjuhën shqipe. Nga shqyrtimi i programeve lëndore të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (<i>Materiali 99/5.3 Programet mesimore të lëndëve, e-ASCAL</i>), rezulton se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve, në gjuhën shqipe dhe angleze (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p>Lidhur me këtë element të programit lëndor janë evidentuar praktika të mira të përditësimit të literaturës. Gjenden syllabuse që kanë përfshirë botime të 5 viteve të fundit si: 2021; 2020, 2019, 2018, 2017 dhe 2016 (<i>Materiali 78/4.3, Programet mesimore të lëndëve të programit të studimit, fq. 27; 36; 51; 58; 78; e-ASCAL</i>)</p> <p><i>Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë që titullarët e tyre të vijojnë përpjekjen për të përditësuar literaturën bazë të detyruar dhe literaturën ndihmëse/ të rekomanduar me botime të 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Gjithashtu, janë vërejtur raste kur literatura e rekomanduar dominohen kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze dhe ofrohet për studentët me një numër të jashtëzakonshëm titujsh për studim, p.sh, 57 tituj/ për lëndë ose 82 tituj/për lëndë, ku shumica është në gjuhë të huaj angleze. (<i>Materiali 78/4.3, Programet mesimore të lëndëve të programit të studimit, fq. 27-30; 42-45; e-ASCAL</i>).</p> <p>Për këto raste, gjatë takimit në institucion, stafi akademik arsyetoi se studentët zotërojnë gjuhën angleze dhe punojnë lehtësisht me literaturën. Titullarët e lëndëve kujdesen që literatura të jetë e aksesueshme, qoftë fizikisht në librari apo bibliotekën universitare, apo në bibliotekat digjitale, duke u ofruar studentëve literaturë në format e-book, kryesisht në gjuhën angleze. Përveç kësaj, titullarët e lëndëve kanë përgatitur cikle të leksioneve në gjuhën shqipe.</p>

	<p>Ndërkohë, studentët pohuan gjatë takimit në institucion se ata nuk ndihen të mbingarkuar me literaturën bazë dhe të rekomanduar në gjuhë angleze.</p> <p><i>Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë fondin e librave (fizik dhe elektronik) që numëron aktualisht biblioteka e institucionit, <u>GVJ sugjeron</u> që të rritet përpjekja e përbashkët e stafit akademik për të siguruar përditësimin në vazhdimësi të literaturës bazë dhe ndihmëse në syllabuset lëndore, si dhe t'ju vihet në dispozicion studentëve në gjuhën e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>FSHS ka dy salla biblioteke me një sipërfaqe 189.5 m2. Kapaciteti i bibliotekës plotëson nevojat për lexim/studim të studentëve dhe personelit akademik. Biblioteka është e pajisur me tetë kompjutera dhe internet. Në fondin e bibliotekës janë rreth 7343 tituj fizik gjithsej, dhe 3906 libra fizik gjithsej, si dhe 154 periodike revista/buletine shkencore në shqipe dhe në gjuhë të huaj. Fondi i librave gjendet në format hardcopy dhe elektronik dhe duket se plotëson nevojat e të gjithë përdoruesve. Tituj në gjuhë shqipe janë gjithsej 2573, ndërsa në gjuhë të huaj, kryesisht, anglisht, fengjisht, italisht, janë gjithsej 1333 tituj. Rreth 869 tituj fizik janë vetëm për fushën e Psikologjisë. Literatura e përditësuar e viteve të fundit përmbledh një fond prej 496 titujsh (<i>Materiali 50/2.29 Informacion për bibliotekën, e-ASCAL</i>).</p> <p>Publikime të stafit akademik të Departamentit të Psikologji-Pedagogjisë të viteve të fundit, ku përfshihen libra mësimor, manual të ndryshme për fushën akademike dhe të shërbimeve psiko-sociale, monografi etj, janë aktualisht 47 tituj (<i>Dokumenti 81/ 3.26 Botime te stafit te brendeshem departamenti i psikologji-pedagogji</i>).</p> <p>Studimet kërkimore të realizuara nga studentët e doktoraturës në bashkëpunim me stafin akademik përbëjnë një fond të pasur prej 157 titujsh. Gjithashtu, në bibliotekë ka tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse për studentët, përkthime të ndryshme, fjalorë, online. Biblioteka është pasuruar edhe me revista shkencore në fushën e shkencave sociale, por edhe në fusha të tjera të studimit e kërkimit shkencor. Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulat mësimore është process i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve,</p>

	<p>artikujve shkencore, tezave të diplomave, si dhe nëpërmjet pasurimit periodik me kolanën e botimeve me revista shkencore (2.31 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës FSHS).</p> <p>Në dokumentin RVJ (2022) përshkruhet se: Në fondin e bibliotekës janë rreth 7343 libra fizik gjithsej, nga të cilët 560 tituj fizik për fushën e psikologjisë, si dhe një numër i lartë periodikësh, revista/buletine shkencore në gjuhë shqipe dhe të huaj, në format hardcopy dhe elektronik. Biblioteka zotëron një numër të madh punimesh masteri dhe doktoraturash të mbrojtura në FSHS dhe që janë në përdorim të studenëtëve dhe stafit akademik. Gjithashtu, në bibliotekë gjenden tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse për studentët, përkthime të ndryshme, fjalorë, CD-ROM. Biblioteka është pasuruar edhe me revista shkencore jo vetëm në fushën e psikologjisë, por edhe në fusha të tjera të studimit e kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale ka në dispozicion një sërë platformash e bibliotekash online që u japin mundësi studentëve dhe stafit akademik ta shfrytëzojnë në kohë reale, duke mundësuar akses në libra, revista e artikuj shkencore të viteve më të fundit. Në këtë kuadër mund të përmenden abonimet me akses të financuar nga FSHS, të tilla: EuroPS-Services; Publications UNRISD; Springer; Journals Sage Pub; Wiley. Sipas bisedës me punonjësen e bibliotekës, procedura e aksesimit të këtyre adresave elektronike kërkon që përdoruesi (studenti/pedagogu) të pajiset me një username dhe një fjalëkalim. Gjithashtu, për pedagogët dhe studentët është mundësuar akses i lirë në: Libraria digitale JSTOR; UNRISD website publications; Katalogu online në platformën Cobiss.net Albania (akronim UTFSHS).</p> <p>Për pedagogët është mundësuar akses në revistat (online) si: History and Theory; International Journal of Human Rights; Social and legal Studies; European Journal on Criminal Policy and Research crime, laë and social change. Me ndihmën e Ambasades Franceze në Tiranë, është mundësuar akses në: http://www.cairn.info/; http://www.persee.fr/; https://www.erudit.org/; http://www.revues.org/; Açeuil - Archive ouverte HAL (Materiali 50/2.29 Informacion për bibliotekën, e-ASCAL).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Libraritë elektronike janë të pasura e të përditësuara në fondin e librave, ku studentët mund të lexojnë dhe shkarkojnë libra, revista, raste studimore dhe publikime të ndryshme të autorëve më të njohur, duke mundësuar të lexuarin, studimin dhe të eksploruarit online, sipas interesave të tyre mësimore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në shfrytëzimin online të faqeve elektronike. Link-et janë instaluar tek kompjuterat e sallës së leximit në bibliotekë dhe ato mundësohen jo vetëm në bibliotekë, por edhe nga distanca përmes, website Fakultetit të Shkencave Sociale. Në dokumentin RVB (2022), informohet se: Në funksion të procesit akademik janë edhe bibliotekat digjitale, ku mund të përmendet JSTOR si pjesë e marrëveshjes që ka UT me AADF, COBISS+, etj.. Biblioteka digjitale JSTOR ofron një gamë të gjerë publikimesh, me mbi 12 milionë artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milionë dokumenta në 75 disiplina. Aksesimi online në këtë bibliotekë mund të bëhet edhe me anë të e-mailit personal zyrtar. Ky fond është i aksesueshëm edhe për studentët e programit të studimit MSH-PK në linkun https://unitir.edu.al/biblioteka-online/. Për lehtësimin e përdorimit të librarisë digjitale, RASH ka hartuar edhe një manual për përdorimin si dhe linkun për aksesimin e saj, https://ulibrary.rash.al/</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Referuar të dhënave për infrastrukturën e FSHS, vërehet se mungojnë laboratorët lëndore (<i>Materiali 53/2.33 Të dhëna për infrastrukturën FSHS, e-ASCAL</i>).</p> <p>Për realizimin e detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike të studentëve, institucioni ka vënë në dispozicion sallën e kompjuterave (8 vende) në mjediset fizike dhe virtuale të bibliotekës, dhe salla të tjera mësimore të cilat janë komode dhe të pajisura me internet (<i>Informacion i siguruar gjatë vizitës në institucion, korrik 2022</i>).</p> <p>FSHS/DPP është e vetëdijshme për rëndësinë e infrastrukturës laboratorike për realizimin e lëndëve specifike, detyrave studimore dhe për t'u përdorur në mënyrë të vazhdueshme nga studentët dhe stafi akademik. Në RVJ është identifikuar si një pikë e dobët mungesa e një laboratorit klinik për shërbime psikologjike. Pavarësisht nga përvoja klinike që ofrojnë pedagogët në auditore dhe ndërthurja e saj me praktikën</p>

	<p>profesionale që zhvillojnë studentët në institucione të ndryshme, GVB ka arsyetuar si të përshtatshme ngritjen e një klinike, në të cilën studentët të përfshiheshin në ofrimin e shërbimeve klinike të supervizuara nga pedagogët përkatës. <i>GJV sugjeron që në ardhmen të konsiderohet mundësia për të krijuar jo vetëm një laborator klinik, por edhe laboratore të dedikuara lëndëve me natyrë teknike/praktike në fushën e psikologjisë klinike. P.sh, mund të konsiderohet ngritja e një laboratorit për lëndën "Terapi arti dhe loje".</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platformën online "Microsoft Teams". Kjo platformë ka filluar të përdoret për mësimdhënien në distancë gjatë situatës së pandemisë Covid-19. Stafi ka marrë trajnime në këtë fushë dhe vijon ta përdorë platformën online "Microsoft Teams", duke inkurajuar studentet që të eksplorojnë hapësirën e-learning, të shkarkojnë materialet mësimore të hedhura nga pedagogët, si: leksione, materiale shtesë audio-vizive, botime online, etj., si dhe të ruajnë komunikimin e vazhdueshëm me stafin akademik për njoftime, informime dhe konsultime.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik, administrativ dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. Ky proces realizohet nëpërmjet domain-it zyrtar të UT-së (outlook), E-student, emer.mbiemer@unitir.edu.al. Ky sistem kërkon që fillimisht përdoruesit të regjistrohen dhe në vijim mund të aksesojnë sistemin në çdo kohë dhe vend, duke shkëmbyer dhe marrë informacion në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme, detyrat, vlerësimet, njoftimet, komunikimi online me sekretarinë, etj. Sipas RVB (2022), përmes këtij sistemi dhe adresave të tyre, studentët e UT-së kanë mundësi të aksesojnë edhe në forumet e faqes zyrtare të internetit të UT-së. Përmes këtyre forumeve online, studentët mund të marrin informacion në lidhje me jetën studentore, oraret e kurseve, pedagogët, leksionet/materiale mësimore, administratën, etj. Në të njëjtën kohë, komunikimi elektronik nëpërmjet platformën Microsoft Teams, e përdorur fillimisht për zhvillimin e mësimin online, vijon të jetë e aksesueshme dhe</p>

<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>shfrytëzohet nga stafi akademik dhe studentët për qëllime mësimore (detyra, literature, konsulta, njoftime, etj.).</p>
	<p>Në dokumentin “Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave (2019)” (<i>Dokumenti 80/4.5, e-ASCAL</i>), janë përcaktuar standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Në Nenin 5 të Rregullores, “Për udhëheqjen shkencore” theksohet se “Çdo student/e ka të drejtë të ketë një udhëheqës shkencor. Udhëheqësi/ja që të drejtojë punën gjatë realizimit të temës së diplomës duhet të ketë të paktën gradën ose në raste të veçanta të jetë doktor në proces dhe të përvojë mësimdhënëse ose studimore në fushën në të cilën do të kryhet punimi i diplomës”. Në Nenin 6 të kësaj Rregullore, “Përgjegjësitë e udhëhesëqit”, përcaktohet se udhëheqësi duhet:</p> <p>(c) Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t’i mundësojë studentit të arrijë standard të larta të hulumtimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë së studimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit.</p> <p>(d) Të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe plagjiaturës.</p> <p>(e) Të mbajë takime të rregullta me studentin mbi ecurinë e punimit.</p> <p>(f) Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar dhe të ndër marrë veprimet e duhura mbështetëse. Etj.</p> <p>Sipas dokumentit të RVB (2022), raportohet se: Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Tema e diplomës ka karakter teoriko-aplikativ dhe studentit udhëhiqet nga një pedagog i departamentit i cili ka dhënë miratimin e tij. Gjatë takimit në institucion, studentët dhe stafi akademik pohuan se personeli akademik orienton studentët</p>

	në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), si dhe asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UT ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat/njësitë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, Ekipin e Vlerësimit të Brendshëm të UT, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>UT ka hartuar “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (2021), ku përcaktohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të personelit akademik të UT të të gjitha kategorive, duke filluar nga personeli me i ri e deri tek profesorët (fq. 6). Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësimor, si dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë. Niveli i arritjes që rezulton nga vlerësimi synon të reflektohet në përfitime, korrigjime ose rekomandime për të ardhmen ndaj anëtarëve të personelit akademik (fq.7).</p> <p>UT ka zhvilluar “Paketën e instrumenteve të cilësisë” (2020), ku janë pasqyruar pyetësorë, anketa, etj. që aplikohen në procesin e vlerësimit dhe monitorimit të punës së personelit akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe</p>



	<p>kërkimit shkencor (<i>Materiali 15/1.14 Paketa e instrumenteve të cilësisë, e-ASCAL</i>).</p> <p>Gjithashtu, UT ka miratuar në parim “Rregulloren mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ të UT” (2022) (<i>Materiali 8/ 1.7 Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, e-ASCAL</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>FSHS/DPP, si pjesë e UT ka ngritur struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. FSHS ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisioni/Komiteti i Sigurimit të Cilësisë (KSC) dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel fakulteti, e cila e bazon punën e saj në Rregulloren e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UT, Rregulloren e NJSC (2020), dhe udhëzimet përkatëse të ASCAL. Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë së FSHS përgjigjet për politikën e vlerësimit dhe zbatimin të procedurave të menaxhimit të cilësisë, si dhe këshillon dekanatin e FSHS për çështje të cilësisë (<i>Urdhër i Brendshëm nr. 14/2, datë 15.07.2021, Materiali 32/ 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit te Cilesise; e-ASCAL</i>).</p> <p>NJSC është një strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FSHS. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit (<i>Urdhër i Brendshëm nr. 14/1, datë 15.07.2021, Materiali 32/2.12 ose 182/2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesise se Sigurimit te Cilesise; e-ASCAL</i>).</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Neni 13 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë bazë” lidhur me sigurimin e cilësisë, pika c, përshkruan se “Drejtuesi i departamentit i propozon dekanit anëtarin e Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të FSHS-së dhe përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të Njësive Bazë, (GVB/NJB).</p>



	<p>Në Regulloren e DPP (2021), Neni 8, “Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP”, pika 8.3, gërma “m”, “Për kompetencat administrative të drejtuesit të departamentit”, përshkruhet se “bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit, bazuar në “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (në proces hartimi). Referuar dokumentit “Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera”, pika 2 e saj, informohet se “Përgjegjësi i departamentit përmes koordinatorëve të programeve dhe studentëve monitoron dhe vlerëson vazhdimisht mësimdhënien, ku çdo semester zhvillon pyetësin e studentëve, si dhe harton raporte mbi pyetësin e studentëve dhe të pedagogëve” (fq. 2). (144/ 4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</p> <p>Njësia bazë dëshmon se ka përgjegjësi për cilësinë e mësimdhënies së programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. DPP ka ngritur Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti i cili vlerëson dhe harton raportin vjetor të vetëvlerësimit të programit të studimit, sipas modelit të miratuar për këtë qëllim. Ky raport, kopje e të cilit i jepet edhe departamentit, shërben për të analizuar praktikën e mira dhe pikat e dobëta të cilat diskutohen, adresohen për të ndërmarrë hapa konkrete në përmirësimin e cilësisë së programit, të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit. FSHS/DPP dëshmon se është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët, për cilësinë në programet e studimit që ofron. (Dokument 72/ 3.18 - Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 1, përcaktohet se “Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të ndërgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq. 4). (Materiali 6/ 1.5 Kodi i Etikes UT (2011), e-ASCAL).</p> <p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse në FSHS/DPP mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies përmes krijimit të hapësirave për organizimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj, trajnimeve, simpoziumeve e konferencave, projekteve të mobilitetit, projekteve ndërkombëtare që kanë në fokus eksperimentimin me metoda të reja në AL. Një projekt i tillë është projekti LECU për “Competency-oriented Methodology”, realizuar në bashkëpunim me Zurich University of Teacher Education, Switzerland, etj. (Materiali 2.18 Analize vjetore e punes se FSHS, 2019-2020; 2020-2021, e-ASCAL). Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik që mbulon MSH-PK u shpreh se përdor metoda mësimdhënie interaktive me studentët që synojnë zhvillimin e aftësive praktike dhe rritjen personale e profesionale të tyre. Ata sigurojnë një mësimdhënie atraktive duke përfshirë prezantimin e materialeve audiovizive, video, etj. Ndërkohë, me mbështetjen edhe të specialistëve të IT-së, stafi deklaroi se është bërë e mundur që në disa aspekte të mësimdhënies të shfrytëzohen metodat inovative që ofron mësimdhënia online.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar dokumentit “Politika të Zhvillimit Profesional të Personelit Akademik të FSHS” (2020), çështja III “Parimet e politikës”, mes të tjerash theksohet se “Strategjia e zhvillimit profesional të FSHS do të jetë proaktive dhe e përgjegjshme ndaj nevojave të fakultetit, dhe do të kërkojë të sigurojë personel që të ketë interes për zhvillim të vazhdueshëm profesional që të zotërojë aftësi për t’u përditësuar me të rejat e fushës dhe ato të pedagogjisë së arsimit të lartë, për të ofruar një mësimdhënie dhe kërkim cilësor në një mjedis me kërkesa që ndryshojnë vazhdimisht” (fq. 4). (Dokumenti 42/2.21 Politika të Zhvillimit Profesional të Personelit Akademik të FSHS (2020), e-ASCAL)</p> <p>FSHS/DPP zbaton politikën e saj të zhvillimit profesional, duke krijuar mundësi të ndryshme për stafin akademik e</p>

	<p>ndihmësakademik, si dhe për studentët që të përfshihen në programe mobiliteti ERASMUS+ në fushën e mësimdhënies, në projekte kërkimore e shkencore të përbashkëta, workshope, konferenca, tryeza të rrumbullakta, simpoziume, leksione të hapura me lektorë të ftuar, trajnime me temë kërkimin në fushën e mësimdhënies në AL, etj. Sipas tabelës përmbledhëse me të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve të FSHS/DPP në kuadër të programit ERASMUS+, mësohet se gjatë 2 viteve të fundit kanë përfituar 8 pedagogë nga programet e mobilitetit dhe 8 studentë. (<i>Material 74/3.20 Të dhëna për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve 2020-2021; 2021-2022, e-ASCAL</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik deklaroi se institucioni krijon mundësi që stafi akademik dhe ndihmësakademik të marrë pjesë pa pagesë në konferencat e përvitëshme që organizon UT dhe FSHS. Gjithashtu, ata u shprehen se institucioni financon pedagogët një herë në dy vjet për një pjesëmarrje në një konferencë jashtë vendit, duke përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe fee të konferencës. Në FSHS/DPP, personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse në FSHS/DPP trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Në dokumentin "<i>Politika të Zhvillimit Profesional të Personelit Akademik të FSHS</i>" (2020), janë pasqyruar llojet e veprimtarive që përmban programi i zhvillimit profesional në FSHS (fq. 8), të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kurs trajnimi për certifikatë për mësimdhënie në arsimin e lartë; 2. Kurse të shkurtra sipas nevojave të identifikuara në mbështetje të zbatimit të risive pedagogjike; 3. Konferenca, seminare, shkollë verore, telekonferenca webinar, etj., për të mbështetur zhvillimin e përmbajtjes së lëndës, ekspertizën pedagogjike, zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit;



	<p>4. Ditët e zhvillimit profesional të organizuara me bazë fakulteti ose departamenti, sipas nevojave të identifikuara paraprakisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dita e zhvillimit profesional për nismat e fakultetit që synojnë të njohin PA me nismat e reja, programe shkëmbimi dhe projekte studimore; - Dita e zhvillimit profesional për mësimdhënien, të nxëniet dhe kërkimin, organizuar me bazë departamenti dhe që synojnë t'i japin mundësi PA që të shkëmbejnë përvojën dhe praktikat më të mira; - Dita e zhvillimit profesional për shërbimet digjitale, organizuar me bazë fakulteti dhe përfshin personelin ndihmësakademik me karakter administrativ; <p>5. Vizita studimore në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit;</p> <p>6. Pjesëmarrje individuale ose në grup, në rrjete dhe shoqata profesionale.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se UT/FSHS motivon dhe mbështet trajnimin e stafit në universitete perëndimore në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UT ka me universitete ndërkombëtare dhe projekte, të tilla si: Erasmus+ KA1, etj. Stafi akademik vlerësoi si një përvojë të dobishme trajnimin e organizuar institucionalisht për përdorimin e platformës Micosoft Teams për mësimdhënien online. Gjithashtu, ata veçuan si të rëndësishme për rritjen e tyre profesionale edhe trajnimet me profesorë të huaj në kuadër të shkëmbimit të experiencave.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik dëshmon se është përgjegjës për zbatimin e programit të studimeve Master i Shkencave në Psikologji Klinike dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Këto detyrime rrjedhin edhe nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik me UT/FSHS, të përcaktuara qartë në dispozitat ligjore të AL, Kodin e Punës, Statutin e UT, Kodin Etik dhe rregulloret e tjera të veçanta. Referuar CV të stafit që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, konstatohet një përpjekje dhe angazhim i vazhdueshëm i personelit akademik dhe ndihmësakademik, për të marrë pjesë në konferenca kombëtare ose ndërkombëtare,</p>



	<p>programe trajnimi/kualifikimi, programe shkëmbimi, projekte kërkimi, etj., që synojnë rritjen e ekspertizës së tyre mësimdhënëse dhe kërkimore në fushën/profilin përkatës. (Dokumenti 92/4.16 për CV të Personelit Akademik Bch në Psikologji, e-ASCAL).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se çdo pedagog është përgjegjës për rritjen e tij profesionale, rishikimin e programeve lëndore, përditësimin e literaturës, përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, ekperimentimin me metoda të reja, cilësinë e kërkimit shkencor, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 1, përcaktohet se “Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. ... Ata duhet të realizojnë me performance të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq. 4). (Materiali 6/ 1.5 Kodi i Etikes UT (2011), e-ASCAL).</p> <p>Në dokumentin “Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021), Aneksi nr. 1, është paraqitur “Formulari i planifikimit të objektivave të performancës, sipas veprimtarive për personelin akademik/drejtues” që materializon procesin e vetëraportimit nga ana e personelit akademik. Objektivat e performancës përfshijnë edhe elemente të procesit mësimor. Mbi bazën e objektivave të parashikuara, personeli angazhohet për realizimin e tyre në kohë dhe me cilësi. Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson pasqyrën e realizimit të objektivave të parashikuara, të cilat duhet të jenë të dokumentuara në dosje të veçantë pranë njësisë bazë. Kjo tabelë analizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe grupi i vlerësimit/përgjegjës i lëndës, të cilën e gjejnë atë korrekte ose jo, dhe firmosin nëse është e saktë” (fq.19) (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021))</p>



	<p>Kjo praktikë pune synon nxitjen e kërkesave personale të stafit akademik dhe ndihmësakademik në drejtim të planifikimit/parashikimit të rritjes profesionale dhe të vetëraportimit të rezultateve të arritura në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë të të nxënit përmes një ndërveprimi të vazhdueshëm me studentët dhe nevojat e tregut të punës. Stafi akademik aplikon metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë e informacionit që mundësohet edhe nga institucioni (Platforma Microsoft Teams dhe logjistika mbështetëse). Kjo lehtëson mësimdhënien në lëndë të caktuara dhe sipas specifikave të temave, e bën mësimin më interaktiv dhe interesant për studentët. (Material 38/ 2.18 Analiza vjetore e punës e FSHS, e-ASCAL).</p> <p>Nismat për aplikimin e formave dhe metodave të reja të mësimdhënies, bëhen pjesë e diskutimit në nivel departamenti, dokumentohen dhe përfshihen në raportet e analizës vjetore.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>FSHS/DPP përfshin në faza të ndryshme të programit të studimit, lektorë të ftuar, profesionistë të fushës, apo kërkues shkencorë, të cilët sjellin perspektiva bashkëkohore mbi çështje të ndryshme të lidhura me profesionin të psikologut klinik, si dhe promovojnë përvoja inovative në fushën e kërkimit dhe trajtimeve psikologjike, duke mundur pasurimin e përvojës së studentëve dhe përafrimin me tregut të punës. Një praktikë të mire në këtë drejtim shënon organizimi i një leksioni të hapur për psikodramën dhe vlerësimin e pacientit përmes metodave të sociometrisë, realizuar me studentët e MSH-PK, në 2019, në bashkëpunim me ekspertë psikoterapistë të Shoqatës Shqiptare për Psikoterapi dhe Institutit të Beogradit për Psikodramën.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në FSHS, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019) është një dokument i posaçëm i hartuar nga FSHS/DPP, që në kreun V “Vlerësimi i studentit”, Neni 19, përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve (<i>Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL</i>).</p> <p>Rregullore për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019), është një dokument i posaçëm që përshkruan standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikolog Klinik. (<i>Dokumenti 31/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL</i>).</p> <p>Rregullore e Praktikës Profesionale (2018) është një dokument rregullator që përfshin kriteret, udhëzimet, procedurat e sistemin e vlerësimit të rezultateve të praktikës profesionale për studentët e programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Këto dokumente janë publike dhe të njohura nga të gjithë studentët, stafi akademik dhe ndihmësakademik. (<i>Dokumenti 79/4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit, e-ASCAL</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Si pjesë e UT, personeli akademik i FSHS zbaton “Kodin e Etikës” (2021), Nenin 6 “Për përhapjen e dijës dhe lirisë akademike”, pika 4 që përcakton se “Çdo pedagog duhet t’u shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit, duke e realizuar këtë nëpërmjet leksioneve, demonstrimit, praktikës e provimit”.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Nenin 19 “Procedura dhe kritere të vlerësimit”, përcaktohet se (1), “Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve”. (<i>Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL</i>).</p>

	<p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike, në kategorinë “<i>Forma e kontrollit të dijeve</i>”, është përshkruar metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. (Dokumenti 78/4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Institucioni raporton në RVJ (2022) se në fillim të semestrit, studentëve u vihen në dispozicion syllabuset për çdo lëndë që ndjekin. Çdo pedagog në fillim të lëndës i njeh studentët me përmbajtjen e syllabusit, me informacionin e nevojshëm që përmban syllabusi: emërtimi dhe kreditet e lëndës, pedagogun/pedagogët e lëndës, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar. Koordinator i programit, ndër të tjera, ka detyrë të mbajë të përditësuar studentët në lidhje me rregulloren e programit, kërkesat, vendimet e departamentit dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, si dhe të verifikojë çështjet që mund të hasin studentët apo pedagogët në lidhje me vlerësimin dhe mbarëvajtjen e procesit. Rregullorja e programit që ndjekin studentët parashikon informacionin e duhur për vlerësimin në lëndë dhe format e kontrollit të dijeve.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 19 “Procedura dhe kriteret e vlerësimit”, përcakton se (2) “<i>Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim; me gojë ose i kombinuar duke u specifikuar më parë në programin e lëndës; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi</i>” (fq. 11). Programi i studimit përmbyllet me mbrojtjen e tezës së diplomimit. (Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).</p>

	<p>Referuar programeve lëndore (syllabuset) të cilat zhvillohen në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, kategorisë “<i>Forma e kontrollit të dijeve</i>”, vërehet se i gjithë procesi përfshin <i>kontrollin e vazhdueshëm</i> të njohurive, <i>kontrollin e ndërmjetëm</i> dhe <i>kontrollin përfundimtar</i>, ku studenti vlerësohet sipas këtyre komponentëve: frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive, detyra e kursit, testi i pjesëshëm dhe provimi përfundimtar. (<i>Materiali 4.3 - Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, e-ASCAL</i>).</p> <p>Diversiteti i formave dhe mënyrave të vlerësimit, i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë gjatë gjithë semestrit/vitit, të ndihmojë hap pas hapi studentin që të përmirësohet dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv. Në syllabusin e çdo lënde që zhvillohet në programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike, në kategorinë “ <i>Forma e kontrollit të dijeve</i> ”, është përcaktuar qartazi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentit përfshin forma dhe mënyra të ndryshme, me raporte të caktuara, që realizohet gjatë gjithë vitit, si: kontrolli i vazhdueshëm (paraqitja e punimit studimor, frekuentimi dhe aktivizimi), kontrolli i ndërmjetëm (testimi në mes të semestrit) dhe provimi/kontrolli përfundimtar (me shkrim/gojë ose i kombinuar). (<i>4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, e-ASCAL</i>). Rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të

	<p>lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda, dhe duke respektuar një rreze të paracaktuar pikëzimi, sipas të cilës provimi final përlogaritet nga 40% – 50% të vlerësimit total. Rezultati përfundimtar konvertohet në note. (Materiali 4.3 - Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, e-ASCAL)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi përmes platformës elektronike “Microsoft Teams” është aplikuar vetëm në kushtet e pandemisë globale. Stafi akademik dhe studentët pohojnë se aktualisht sistemi përdoret për të marrë përgjigjet e vlerësimeve në një lëndë të caktuar, por jo për testim. Institucioni deklaron në RVB (2022) se “DPP ka një marëveshje me projektin Clean Score dhe pedagogët e programit të studimit MSH-PK mundën të përdorin këtë sistem”. Përdorimi i këtij sistemi në korrigjimin e testeve, synon të rrisë objektivitetin, shpejtësinë e komunikimit të rezultateve dhe transparencën me vlerësimet. Por, nuk është e qartë se në çfarë mase përdoret ky mekanizëm për korrigjimin e testeve nga stafi akademik i FSHS/ DPP.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 34 “Mënyra e zhvillimit të provimit”, pika 2 përcakton se “Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga të cilët njëri duhet të jetë i brendshëm” (fq. 10). (Dokumenti 24/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL). Rregullore së programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 21 “Zhvillimi i provimeve”, nuk shprehet për kriter. (fq. 12). (Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL). Institucioni deklaron në RVB (2022) se “Titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentit. Kur lënda ka edhe asistent, vlerësimi bëhet nga të dy pedagogët që angazhohen për zhvillimin e lëndës. Teza hartohet nga titullari i lëndës sipas formatit të miratuar për këtë qëllim”.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të</p>	<p>Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 34 “Mënyra e zhvillimit të provimit”, pika 4, përcaktohet se “Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara” (fq. 10), dhe Neni 35 “Procedurat e verifikimit dhe sekretimit”, gërma “c” përcakton se “Vendosja e studentëve në sallë bëhet mbi bazën e listës emërore të</p>

<p>monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p><i>kandidatëve të renditur sipas rendit alafabetik dhe në mënyrë progressive</i>". Pika 2 e Nenit 35 specifikon se <i>"Për provimet që zhvillohen me shkrim: provime të lëndës dhe provime të diplomës ndiqet e njëjta procedure sekretimi. (a) Sekretimi bëhet nëpërmjet sekretimit të thjeshtë ose me sistemin BarCode, sipas modelit të përcaktuar nga FSHS (fq.11). (Dokumenti 24/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik dhe studentët treguan se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi. Zhvillimi i provimeve në auditor monitorohet nga pedagogët e lëndës.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se "Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale mund të shoqërohet me komente nga pedagogu përkatës (nëse është e nevojshme), për të sqaruar studentin dhe ndihmuar atë që të përmirësohet në të ardhmen. Kjo procedurë realizohet në kuadër të konsultave të cilat janë të detyruara për pedagogun dhe realizohen menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve. Gjithashtu, pedagogu i lëndës, pas provimit dorëzon në departament tezën orgjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet për përgjigjet dhe vlerësimin e marrë. Në RVB (2022), theksohet se "Notat u komunikohen studentëve në mënyrë individuale duke respektuar të drejtën për konfidencialitet sipas udhëzimeve të Avokatit të Popullit. Notat dotëzohen në sekretarinë mësimore brenda 5 ditëve nga data e afishimit".</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik në FSHS/DPP janë shprehur në dokumentin "Rregullore për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave" (2019), për evitim të plagjiaturës dhe kopjimit. Në seksionin "Kritere dhe kërkesa kryesore mbi etikën e kërkimit", dokumeti thekson se (a) <i>Punimi i temës për diplomimin në Master i Shkencave duhet të jetë punë origjinale e kandidatit; (d) Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por për kundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme. Pandershmëria akademike e cila përfshin deklarime false, të</i></p>

dhëna të rreme, prezantimi i punës së grupit si punë individuale dhe plagjiatura i duhen shpjeguar studentit (fq. 9). (Materiali 80/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL)

Në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 59 “Kuptimi i shkeljeve disiplinore”, specifikohet se “Shkelje të rregullave konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e të tjerëve, rregullat dhe normat etiko-morale të shoqërisë si: kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme ...” (Materiali 24/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL)

Gjatë vizitës në institucion, nga takim me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se “Plagjiatura apo kopjimi në provime mund të shmanget në FSHS, sepse stafi respekton dhe zbaton me korrektesë rregullat lidhur me:

- kushtet e sekretimit të tezës së provimit nga sekretaria mësimore,
- monitorimin e procesit të provimit nga komisioni i përbërë nga dy pedagogë të lëndës,
- moslejimin e përdorimit të së njëjtës tezë provimi me grupe që zhvillojnë provim në orarë të ndryshme,
- mospërsëritjen e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë edhe sezonin e riprovimit), etj.,

Përsa i përket shmangjes së plagjiaturës dhe kopjimit në detyrat lëndore të punuara individualisht ose në grup nga studentët, stafi akademik shprehet se ata bashkëpunojnë ngushtësisht me studentët nga fillimi deri në përfundim të detyrës, monitorojnë, mbështesin dhe vlerësojnë hap pas hapi punën e tyre me qëllim përmirësimi. Gjatë këtij procesi ekziston mundësia për të parandaluar ose evidentur në kohë rastet e këtij fenomeni.

Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.

FSHS/DPP bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë. Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 19 “Procedura dhe kriteret e vlerësimit”, përcakton se (1) Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentit; (3) Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas



	<p>përfundimit të saj; (4) Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem prej 10 notash. Notat nga 5 e lartë janë kaluese. (Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Në programin lëndor (syllabusin), në seksionin “Forma e kontrollit të dijeve”, është përfshirë një tabelë e detajuar pikëzimi për vlerësimin e studentëve, të ndarë në kategori: shkalla e pikëve, nota numerike, përshkrimi i notës, nota me shkronja sipas ECTS. Zbatimi i një sistemi të detajuar pikëzimi tregon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe afëtësive të studentëve janë të bazuara në meritë.</p> <p>Lidhur me afatet dhe mënyrën e komunikimit të rezultateve të provimit, Rregullorja e UT (2015), Neni 49 shprehet se “Rezultatet e provimit u bëhen të njohur studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. *Në këtë rast rezultatet e provimit afishohen për çdo grup (!).</p> <p>Rregullorja e FSHS 2018, Neni 36, pika 3 shprehet se “Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë, dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. *Rezultatet komunikohen individualisht” (fq. 12). (Dokumenti 24/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p> <p>Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 22 “Komunikimi i vlerësimeve”, shprehet se “Vlerësimet duhet të komunikohen nga pedagogu i lëndës brenda 10 ditëve” (fq. 12) (Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p><u>GVJ sugjeron</u> se nevojitet të rakordohen përcaktimet në dokumentet rregullatore në nivel universiteti, fakulteti, departmenti dhe programe studimi lidhur me afatet dhe mënyrën e komunikimit të rezultateve të provimit.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në</p>	<p>UT/FSHS garanton bazuar në dokumentet e saj rregullatore, të drejtën e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës.</p> <p>Rregullorja e UT (2015), Neni 49 shprehet se “Rezultatet e provimit u bëhen të njohur studentëve nga komisioni në</p>



përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.

përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. *Në këtë rast rezultatet e provimit afishohen për çdo grup (!). Ndërsa, Neni 54 "Rishikimi i notës" shprehet se "Studenti ka të drejtën e rishikimit të notës në çdo vit akademik deri në tre lëndë nga detyrimet e atij viti. Për rishikim note, studenti provohet vetëm njëherë dhe vetëm në sezonin e riprovimeve duke mbetur në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Kërkesa për rishikim note i paraqitet dekanatit/ drejtorisë para sezonit të riprovimeve. Studenti i vitit të fundit ka të drejtë të rishikojë deri në 4 lëndë përfshirë këtu edhe lëndë nga vitet paraardhëse" (fq.30-31) (Dokumenti 4/1.3, e-ASCAL).

Rregullorja e FSHS (2018), Neni 36 "Sistemi i vlerësimit", pika 3, shprehet se "Rezultatet e provimit u bëhen të qarta studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Rezultatet komunikohen individualisht". Në Nenin 40 "Përmirësimi i notës", përcaktohet se "Studenti ka të drejtën e përmirësimit të notës nëpërmjet rihyrjes në provim në çdo vit akademik, deri në tre lëndë nga detyrimet e atij viti. Për përmirësimin e notës studenti provohet vetëm njëherë dhe vetëm në sezonin e riprovimeve duke mbetur në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Studenti i vitit të fundit ka të drejtë të rishikojë deri në 4 lëndë përfshi këtu edhe lëndë nga vitet paraardhëse". (24/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).

Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 22 "Komunikimi i vlerësimeve", shprehet se "Vlerësimet duhet të komunikohen nga pedagogu i lëndës brenda 10 ditëve" (fq. 12) (Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).

Në rast se një notë është raportuar gabim, institucioni respekton përcaktimet e Rregullores së studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik (2019), Neni 23 "Dokumentimi i vlerësimeve", Pikën 4 që shprehet se "Një notë e raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezulton se është bërë një gabim gjatë regjistrimit. Pedagogu duhet të dorëzojë një vërtetim me shkrim ku pranohet gabimi. Ndryshimi pranohet brenda një periudhe kohore prej

	<p>tre ditësh nga data e dhënies së vlerësimit. (Dokumenti 61/3.6 Rregullore e programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Megjithatë, Neni 23, i Rregullores së programit të studimit, lë të paqartë se ku drejtohet pedagogu për të dorëzuar vërtetimin me shkrim pasi pranon gabimin, dhe kush e miraton ndryshimin.</p> <p>GVJ vëren se nevojitet të plotësohet Neni 23 i Rregullores së programit të studimit, lidhur me përcaktimet e nevojshme në pikën 4. Institucioni raporton në RVJ (2022) se bazë për rregullimin e këtyre procedurave shërben Rregullorja e UT, 2015 (neni 49 dhe 50).</p> <p><i>GVJ rekomandon të rakordohen/harmonizohen përcaktimet në dokumentet rregullatore në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe programe studimi lidhur me afatet dhe mënyrën e komunikimit të rezultateve të provimit.</i></p> <p>(Rregullore e UT (2015), Neni 49, shprehet: <i>Rezultatet e provimit afishohen për çdo grup</i>; Rregullore e FSHS (2018), Neni 36 shprehet: <i>Rezultatet komunikohen individualisht</i>).</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Çdo kërkesë, ankimim i studentit, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm sipas përcaktimeve në “Rregulloren e FSHS (2018), Neni 37 “Ankimimi”, Pika 4 ku thuhet se “Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa paraqitet me shkrim te përgjegjësi i departamentit ose sekretaria e departamentit, brenda 48 orësh nga marrja dijani e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i departamentit pasi bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin”. Sipas pikes 5 të Nenit 37 të Rregullores “Dekani brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit”. (Dokumenti 24/ 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL). Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informuar nga studentët se institucioni trajton me seriozitet kërkesat dhe rastet e ankimit të tyre lidhur me rezultatin e vlerësimit apo çështje të tjera që shqetësojnë studentët. Stafi akademik tregoi gjithashtu, se institucioni zbaton përcaktimet sipas Rregulloreve përkatëse lidhur me kërkesat apo ankimitet e studentëve.</p>

	Autoritetet drejtuese të FSHS/DPP dëshmuar se çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.7

Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. Sipas dokumentit “<i>Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikolog Klinik</i>”, çështja 7 “<i>Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin</i>”, deklarohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 6).</p> <p>Realizimi i programit të studimit bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përafërta plotësuese me ato të natyrës praktike. Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi, shprehi dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>klinike” (fq. 3). (Dokumenti 76/4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit, e-ASCAL)</p> <p>Programi i studimit synon që studenti të marrë njohuri të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e Psikologjisë Klinike që të jetë konkurrent i denjë në tregun e punës. Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe mënyra se si ky program zhvillohet/ofrohet nga FSHS/DPP, garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>UT/FSHS dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes trajnimit jashtë orëve mësimore për të përdorur sistemin “Microsoft Teams” me qëllim realizimin e procesit të mësimdhënies / mësimnxënies online dhe komunikimit elektronik. Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike nuk ka një lëndë/modul të dedikuar zhvillimit të aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. (Materiali 77/4.2 Plani mësimor i programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>Por, programi mundëson studentët të përdorin teknologjinë bashkëkohore dhe të zhvillojnë aftësitë për të komunikuar e ndërvepruar në funksion të arritjes së objektivave mësimorë teoriko- praktikë dhe kërkimor shkencor. Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me teknologjinë informatike ndërkohë që realizojnë detyra mësimore, aftësohen për të kryer punë praktike klinike, vlerësim, formulim, konceptualizim dhe trajtim të problematikave të ndryshme në grupmosha të ndryshme dhe modalitete e forma të ndryshme trajtimi, si dhe zhvillojnë aftësitë e tyre hulumtuese/ kërkimore në fushën e psikologjisë klinike.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>DPP, njësi bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, realizon në mënyrë periodike analizën e punës. Në fund të semestrit, DPP kërkon nga pedagogu i çdo lënde apo moduli të raportojë në lidhje me arritjen e objektivave të lëndës, si dhe të paraqesë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen. Të dhënat e grumbulluara dhe rekomandimet e mundëshme përfshihen në raportin e analizës vjetore të DPP (Materiali 188/</p>

	<p>2.18 Analizë vjetore e punës së FSHS 2019-2020, 2020-2021, e-ASCAL)</p> <p>Kjo praktikë vlerësohet nga GVJ si një tregues pozitiv i angazhimit institucional për të inkurajuar personelin akademik të analizojë, shqyrtojë dhe reflektojë mbi objektivat përkatëse, të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen lëndore dhe metodologjinë e mësimdhënies, si dhe të hartojë programe lëndore që thelbësisht synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik në institucion, GVJ mësoi se pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar. Gjithashtu, në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/ në grup) të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe orientojnë studentët drejt diskutimit për të gjetur mundësi për implementimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentit “Raporti vjetor për punët e kryera” (2019-2020; 2020-2021), vërehet se stafi akademik ka përfutur dhe është angazhuar në ngjarje të ndryshme shkencore, të cilat janë realizuar në UT/FSHS përgjatë dy viteve akademike, të tilla si: konferenca, simpoziume, workshope, seminare shkencore, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, tavolina të rrubullakëta, veprimtari promovuese, etj. Një pjesë e veprimtarive të organizuara jashtë programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, kanë bërë bashkë studentët dhe pedagogët e tyre. Shëmbull është tryeza e rrumbullakët mbi organizimin orëve të hapura me lektor të ftuar në platformën elektronike “Microsoft Teams” për mësimin në distancë që iu përgjigj jo vetëm nevojave imendiate të insitucionit në kushtet e pandemisë globale, por edhe nevojave në vazhdimësi për të përdorur teknologjinë e informacionit në funksion të qëllimeve të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies. (Materiali 39/2.18-1/2 Analizë vjetore e punës së FSHS, 2019-2020; 2020-2021; e-ASCAL).</p> <p>FSHS/DPP disponon të dhëna të detajuara për tematikat e trajtuara me studentët në kuadër të veprimtarive</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafra», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>ekstrakurrikulare, me qëllim formimin profesional të tyre dhe përafrimin me zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë. Këto veprimtari organizohen jashtë strukturës së programit të studimit me ekspertë të fushës së psikologjisë klinike apo lektorë të ftuar nga institucione homologe. <i>(Materiali 7/3. Dokument që vërteton trajnimin profesional të studentëve, e-ASCAL).</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Stafi akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, është i kualifikuar dhe i prirur për të realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikat e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e rezultateve të pritëshme të të nxënit që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit lëndor. Gjenden shëmbuj të mirë të formulimit të rezultateve të pritëshme të të nxënit, ku përdoren folje të matëshme, të tilla si: Në përfundim të programit lëndor, studenti do të jetë në gjendje - të identifikojë, të dallojë, të krahasojë, të diskutojë, të demonstrojë, të përdorë, të shkruajë, të hartojë, të interpretojë, të realizojë, të planifikojë, të analizojë, të argumentojë, të vlerësojë, të aplikojë, etj., duke vënë theksin tek demonstrimi/përdorimi/aplikimi i aftësive dhe kompetencave në situata praktike. <i>(Materiali 78/4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit; fq. 36, 51, 54, 76, etj; e-ASCAL)</i></p> <p>Rrallë ndeshen raste të programeve lëndore që përdorin formulime të përgjithëshme, të tilla si: të njohë, të kuptojë, të dijë, të zotërojë, etj, të cilat duket se orientojnë më tepër studentët te përfitimi i njohurive, sesa demonstrimi i aftësive dhe kompetencave të tyre në situata praktike. Në këtë aspekt, sugjerohet të rishikohet formulimi i rezultateve të pritëshme të të nxënit duke specifikuar aftësitë dhe kompetencat që duhet të demonstrojnë / përdorin / aplikojnë studentët në situata praktike në përfundim të programit lëndor. Lidhur me aspektin metodologjik të mësimdhënies, studentët dhe pedagogët shpjeguan gjatë vizitës në institucion se leksionet, seminarët dhe veprimtaritë e tjera mësimore, realizohen mbi bazë kompetencash, duke ju dhënë mundësi studentëve që të</p>

	<p>zhvillojnë njohuritë dhe shprehitë e nevojshme profesionale në situata praktike. Stafii akademik dhe studentët treguan se në shumicën e lëndëve mësimore, veçanërisht të lëndëve karakterizuese, mësimdhënia realizohet duke përdorur metoda interaktive, si: lojë me role, punë në grupe, analiza, reflektim dhe diskutim mbi raste klinike/raste studimore, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. Në programet lëndore/syllabuset, në kategorinë kategorinë “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, vërehet se shumica e titullarëve të lëndëve kanë projektuar mësimdhënien e tyre dhe të nxënit e studentëve të bazuar në diskutimet, studimet e rastit, punën në grup dhe nxitjen e mendimit kritik dhe kreativ në përvetësimin e dijeve, interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara të lidhura me lëndën. <i>(Materiali 78/4.3, Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit; e-ASCAL).</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Si pjesë e UT, personeli akademik i FSHS zbaton “Kodin e Etikës” (2021), Nenin 6 “Për përhapjen e dijes dhe lirisë akademike”, Pika 2 që përcakton se “Çdo pedagog duhet të njohë dhe respektojë kontributet shkencore të kolegëve dhe studentëve” dhe Pika 3 që shprehet se “Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t’u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit”.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, jo vetëm përmes inkurajimit të diskutimit të lirë në auditor dhe veprimtarive zhvilluese jashtë programit të studimit, por edhe nëpërmjet mbështetjes me literature dhe udhëzime për realizimin e detyrave me natyrë studimore të cilat punohen individualisht ose në grup. Gjithashtu, studentët pohuan gjatë takimit me GVJ se institucioni organizon veprimtari jashtë programit mësimor me karakter kulturor, shkencor, e zbavitës, si: Vizitë në shtëpinë e Kadares dhe diskutimi i librit Kukulla, në prizmin e proceseve psikologjike</p>

	<p>të pavetëdijshme; Shfaqja e filmit “Broer” – Vëllai, në bashkëpunim me Ambasadën Hollandeze dhe House of Europe; Fushata e ndergjegjësimit për shëndetin mendor në bashkëpunim me Fondacionin “Together Albania”, etj.)</p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe nismat studentore. FSHS inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore apo botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. GVJ evidentoi se institucioni mbështet bashkëpunimin me studentën në kuadër të konferencave dhe ngjarjeve të tjera shkencore në nivel kombëtar/ndërkombëtar, organizuara nga FSHS, duke mirëpritur pjesëmarrjen dhe prezantimet e ideve të tyre në bashkëpunim me pedagogët.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve të fakultetit në këto aktivitete realizohet pa asnjë pagesë nga ana e tyre. Në RVB (2022) delarohet se “UT/FSHS mbështet financiarisht Këshillat e Studentëve. Në financimin për kërkimin shkencor në nivel fakuteti, zënë vend edhe financimet për studentët, në lidhje me veprimtarinë kërkimore dhe krijuese që mund të zhvillojnë. Të ardhurat nga kjo veprimtari janë zë i veçantë edhe në buxhetin e departamentit. Në menaxhimin e këtyre të ardhurave studentët mbështeten nga administratori i fakultetit”.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Sipas tabelës përmbledhëse me të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve të FSHS/DPP në kuadër të programit ERASMUS+, mësohet se gjatë dy viteve të fundit kanë përfituar 8 pedagogë nga programet e mobilitetit dhe 8 studentë. (Material 74/3.20 Të dhëna për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve 2020-2021; 2021-2022, e-ASCAL). Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se FSHS është pjesë e projektit Erasmus+ KA107 që mundëson mobilitetin e stafit dhe studentëve të UT-së. Thirrjet për aplikim të stafit dhe studentëve në programe shkëmbimi publikohen herë pas here në faqen zyrtare të UT https://unitir.edu.al/ dhe FSHS https://fshs-ut.edu.al/.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="730 1809 938 1910">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="938 1809 1145 1910">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1145 1809 1353 1910">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimi Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike mbyllet me mbrojtjen e temës së diplomës para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim. FSHS/DPP ka hartuar procedura të posaçme për mbrojtjen e diplomës të cilat bëhen publike për studentët para diplomimit. Rregullorja për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019) është një dokument rregullator i posaçëm që përcakton standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së dilomës për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike. <i>(Dokumenti 80/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL)</i></p> <p>Kriteret për fitimin e diplomës dhe diplomimin janë përcaktuar në Rregulloren e UT-së (2015), Rregulloren e FSHS (2018) dhe në Rregulloret e programit të studimit (2019).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>FSHS/DPP, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>FSHS ka publikuar Rregulloren për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019) që përbën një dokument rregullator të posaçëm i cili përcakton standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së dilomës për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike. <i>(Dokumenti 80/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL)</i></p> <p>FSHS/DPP ka caktuar një Koordinator të programit të studimit i cili është përgjegjës për të monitoruar ecurinë e ndërveprimit të studentëve me pëdagogët udhëheqës përkatës, si dhe sigurimin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	që studentët disponojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin ndihmues përkatës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Të gjithë studentët përfundojnë studime të tyre me një punim shkencor autentik.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave bazuar në Rregulloren për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019), Nenin 2 “Për zgjedhjen, përcaktimin dhe miratimin e temës së diplomës” (fq. 3). <i>(Dokumenti 80/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL)</i>.</p> <p>FSHS/DPP shpjegon në RVB (2022) se përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Udhëheqja e studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim në manualin për përgatitjen e temës së diplomës. Pedagogu udhëheqës e orienton dhe e ndihmon studentin jo vetëm në fillim për përcaktimin e temës së diplomës, por edhe gjatë punës në vazhdimësi, duke zhvilluar seanca metodologjike orientuese me grupin e studentëve që ai udhëheq përmes orëve të tutorimit.</p>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>FSHS/DPP asiston studentët brenda dhe jashtë institucionit për kryerjen e punimeve të tyre studimore. FSHS si pjesë e UT, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, të cilat krijojnë mundësi jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale, por edhe për realizimin e punimeve studimore nga ana e studentëve. Në këtë kuadër mund të përmendet rasti i bashkëpunimit me IEVP Penale për qëllime studimore <i>(Autorizim për hyrje me Nr. prot.7930 datë 23/07/2021)</i>.</p> <p>FSHS/DPP asiston studentët brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar seanca metodologjike,</p>

	konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në biblioteke, mjedis të mbuluar me WiFi.
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Përsa i përket përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës, personeli akademik i FSHS/DPP i cili udhëheq studentin njëh dhe zbaton përcaktimet e “Rregullores së Diplomimit në FSHE, 2020”, Neni 7 “Për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës” (<i>Dokumenti 31/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL</i>), si dhe udhëzimet dhe përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në këtë veprimtari, të parashikuara në Rregulloren për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019). (<i>Dokumenti 80/4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL</i>)</p> <p>Sipas “Rregullores për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019), (fq.3-4), pedagogut udhëheqës i kërkohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që të mundësojë kandidatin të arrijë standarde të larta të hulumtimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë së studimit, rekomandimin e literaturës dhe dhe burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit; - Të mbajë takime të rregullta me studentit mbi ecurinë e punimit; - Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt stadadit të kërkuar. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndër marrë veprimet e duhura mbështetëse; - Të kontrollojë dhe garantojë se studenti i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e reflektuara gjatë procesit të konsultimeve. - Të japë ose mos të japë deklaratën për depozitim të punimit për mbrojtje. Kjo delaratë do të jetë pjesë e integruar në punimin e diplomës së studentit.
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë</p>	<p>Sipas Rregullores së Diplomimit në FSHS (2020), Neni 7 “Për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës”, pika 10 shprehet se “<i>Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe kryhet para një komisioni të miratuar nga drejtuesi i</i></p>



	<p>deparatimentit dhe zëvendësdekani që mbulon programin. Komisioni përbëhet nga 3-5 anëtarë. Komisioni funksionon kur janë prezentë 2/3 e anëtarëve të tij. Prezantimi zgjat 10-15 minuta. Komisioni i bën pyetje studentit dhe më pas vlerëson cilësinë e punimit. Vlerësimet kryhen me pike sipas skedës së vlerësimit që përfshihet në Paketën e punimit të diplomës. Pikët konvertohen në note. Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Vlerësimi i komunikohet çdo studenti diplomant individualisht”. (Dokumenti 31/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL)</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Klinike, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Kjo procedure është e përcaktuar në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 42 “Diploma”, që shprehet se “FSHS pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën përkatëse, e cila është një dokument zyrtar. Diplomat për ciklin e parë dhe të dytë shoqërohen me Suplementin e Diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. Përmbajtja dhe forma e diplomës është përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përmbajtja dhe forma e diplomës së Suplementit të Diplomës është përcaktuar në Statutin e UT, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit... Diploma plotësohet me shkrim të qartë dhe me bojë teknike. Ajo nënshkruhet nga Dekani dhe Rektori i UT. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e UT”. (Dokumenti 24/2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p> <p>UT/FSHS shprehet në RVB (2022) se “Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet Çertifikata “Medalje e Artë” dhe për studentët që gjatë studimeve, kanë marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet Çertifikata “Student i Shkëlqyer” (Dokumenti 1.2 - Statuti i UT, 2018, Neni 113, e-ASCAL)</p>



	<p>Përmbushja e kriteri 8, dëshmohej edhe nga dokumentet që institucioni ka depozituar në e-ASCAL (1) <i>dokumentin nr. 3.8 - Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit. Modeli i diplomës të programit të studimit.</i> (2) <i>Evidenca nr.3.10 – Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike).</i></p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji-Klinike, studentit i vihet në dispozicion kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ mësoi se “Kopja zyrtare e programit të studimit, përfshin syllabuset e këtij programi. Ajo vihet në dispozicion të studentëve në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të studimit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen</p>	<p>UT/FSHS ruan për një periudhë të pacaktuar/pa afat kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se FSHS disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me Udhëzuesin mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë të të dhënave personale. (<i>Dokumenti 10/1.9 Privatësia UT, e-ASCAL</i>). Në RVB (2022) DPP shpjegon se “Departamenti ruan kopjet e dorëzuara të diplomave që studentët mbrojnë para komisionit në department në hard copy dhe elektronikisht (CD). Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore”.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me përfaqësues të Degës së Burimeve Njerëzore pranë FSHS, GVJ konstatoi se kjo strukturë disponon, ruan dhe përditëson dosjet e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Të dhënat ruhen në formë të printuar dhe një pjesë e tyre dhe në formë elektronike. GVJ kqyri disa prej dosjeve të personelit akademik të vëna në dispizicion nga struktura dhe vuri re se dosjet përfshinin dokumentet e kërkuara sipas formateve, standardeve dhe rregulloreve përkatëse të Zyrës së Burimeve Njerëzore të UT. (Materiali nr. 2.20 - Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit).
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe	Sipas autoriteve drejtuese të FSHS/DPP, dhe Degës së Burimeve Njerëzore mësohet se institucioni zbaton procedura rekrutimi bazuar në Statutit të UT me të gjitha procedurat e kërkuara

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	përfshirë ankimimin (Dokumenti 1.2, Statuti i UT, 2018, Nenet 68-70).			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Në bazë të diskutimeve me GVB dhe personelin akademik dhe përfaqësuesen e zyrës së burimeve njerëzore konstatohet se institucioni disponon procedura e kritere të specifikuar për rekrutimin e personelit (me orar të plotë dhe atë të pjesshme). Kërkesa fillestare për shtimin e stafit akademik vjen nga përgjegjësi i njësisë bazë, në lidhje me nevojat për mbulimin e të gjithë aktivitetit didaktik të parashikuar për programet e studimit të mbuluara nga njësia bazë. Është njësia bazë që harton edhe kriteret specifike që duhet të përmbush stafi akademik. Zyra e burimeve njerëzora ndjek procedurat administrative të aplikimeve dhe vlerëson paraprakisht përputhshmërinë e aplikimeve me kriteret. (Dokumenti 1.12)			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Referuar (Dokumentit 1.12. Manuali për punesimin e personelit në UT, seksionin i 1), Departamenti për të përzgjedhur personelin akademik me kualifikimin e duhur, krijon komision ad-hoc, për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, dhe i përkasin kategorisë “Profesor”. Komisioni bën verifikimin e kritereve të përgjithshme dhe të vecanta dhe përgatit relacionin përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e	Bazuar në vizitën në IAL, GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>infrastrukturore si salla leksionesh, seminaresh, laborator me pajisjet dhe instrumentet e nevojshme në fushat e programit të studimit të cilat në kohën e pandemisë janë realizuar përgjithsisht nëpërmjet demonstrimit live dhe të regjistruar nga pedagogu i lëndës. Edhe për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, institucioni garanton ambiente të bollshme, dhe me të gjithë infrastrukturën IT të nevojshme për kryerjen e të gjithë aktiviteteve të parashikuara brenda institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik krijohet një përshtypje që stafi akademik më shumë zhvillohet profesionalisht si rezultat i përpjekjeve të tyre personale se sa të jenë si rezultat i angazhimit të institucionit përkatës, qoftë fakulteti apo universitetit. <i>(Materiali 2.22)</i> nuk dëshmon kualifikim të vazhdueshëm apo zhvillim të mëtutjeshëm profesional, por vetëm përcakton politikat në këtë drejtim.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se FSHS ka hartuar një rregullore mbi “Politikat e zhvillimit Profesional të personelit akademik”, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjisë. Sipas këtij dokumenti FSHS është i përkushtuar të ofrojë dhe të sigurojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mundësi trajnimi dhe zhvillimi për personelin e të gjitha kategorive dhe në të gjitha rolet; - Mundësi për të zhvilluar aftësi që kontribuojnë në realizimin e misionit të Fakultetit; - Mundësi për të zhvilluar një plan karriere dhe për të marrë pjesë në aktivitete të zhvillimit të karrierës; - Barazi në mundësitë e zhvillimit profesional; <p><i>(Dokumenti i dorëzuar 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik 2020))</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve</p>	<p>Institucioni dëshmon për përpjekje serioze për përmbushjen e objektivave në mbulimin e programit me staf akademik me tituj dhe grada shkencore. Përgjatë vitit 2020-2021 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 2 Prof. Dr, 1 Prof.Assoc dhe 6 Dr, ndërsa si lektor me kontrate ka rekrutuar 3 me gradën Dr.dhe 3 me Msc. Formimi profesional i personelit</p>



	akademik është në përputhje me përmbushjen e objektivave të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ duke u bazuar nga vizita në objekt dhe faktet e ofruara në raportin e GVB konstaton se institucioni ka mjediset dhe infrastrukturën e duhur për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies në të gjitha format (teorike dhe praktike). Më saktësisht fakulteti disponon me 4400 m ² . Ndërtesa ka salla të përshtatshme të mësimin për modulet përkatëse të programit në shqyrtim. <i>Dokumenti i dorëzuar 4.13</i>) specifikon se hapësira e dedikuar për programet e studimit është 3577 m ² më një mesatare për 1.33m ² për student.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ përsëri duke u bazuar në vizitat në objekt ka konstatuar se sallat janë të pajisura me teknologjinë, mjetet elektronike dhe mjetet e duhura që janë të nevojshme për zbatimin e objektivave të programit. (<i>Materiali 4.13</i>). Të gjitha sallat e FSHS janë të pajisura me videoprojektorë dhe lidhje me internetin /WiFi që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>FSHS/DPP është e vetëdijshme për rëndësinë e infrastrukturës laboratorike për realizimin e lëndëve specifike, detyrave studimore dhe për t'u përdorur në mënyrë të vazhdueshme nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Në RVB është identifikuar si një pikë e dobët mungesa e një laboratorit klinik për shërbime psikologjike. Pavarësisht nga përvoja klinike që ofrojnë pedagogët në auditore dhe ndërthurja e saj me praktikën profesionale që zhvillojnë studentët në institucione të ndryshme, GVB ka arsyetuar si të përshtatshme ngritjen e një klinike, në të cilën studentët të përfshiheshin në ofrimin e shërbimeve klinike të supervizuara nga pedagogët përkatës (Materiali 4.13).</p> <p>Në këtë linjë, <u>GVJ sugjeron</u> që në ardhmen të konsiderohet mundësia për të krijuar jo vetëm një laborator klinik, por edhe laboratore të dedikuara lëndëve me natyrë teknike/praktike në fushën e psikologjisë klinike. P.sh. mund të konsiderohet ngritja e një laboratorit për lëndën "Terapi arti dhe loje".</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>FSHS, Nuk ka laborator të TIK (Materiali 4.13)</p> <p>Në këtë linjë, <u>GVJ sugjeron</u> në të ardhmen të konsiderohet mundësia e krijimit të një laboratorit të TIK e cila do ofronte mundësi shtesë nga ajo që kanë më specifikiisht 8 kompjutera në sallën e studimit tek Biblioteka e FSHS.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Duke u bazuar në shqyrtimin e evidencës së dorëzuar (Materiali 3.17) Lista e Institucioneve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale, janë 37 organizata dhe institucione të ndryshme me të cilat janë nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit për pune praktike.</p> <p>(Materiali 4.4) dëshmon rregullimin e praktikës profesionale specifikiisht të dizajnuar për formësimin e psikologëve klinik. Në këtë dokument janë të specifikuar qëllimet e praktikës, kriteret për zgjedhjen e institucioneve të praktikës dhe detyrimet e studentëve në kryerjen e praktikës. GVJ konstaton se IAL mundëson kryerjen e praktikave profesionale për studentët në programin përkatës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Duke u bazuar në vizitën në objektin e IAL GVJ konstaton se institucioni ka bibliotekë të përshtatshme për përdorim të studentëve. <i>(Materiali 4.10)</i> biblioteka e FSHS ka 200 m ² . Ajo ka katër mjedise: sallën multimediale me 8 kompjuter, sallën e leximit me libra me fond të hapur, sallën e fondit të mbyllur dhe zyrën e përpunimit të koleksioneve. Ofron shërbime prej orës 8.00 deri 18.00 për të gjithë studentët e FSHS.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në vizitën në bibliotekë u analizuan lista e kopjeve fizike të librave në fushën e psikologjisë në gjuhën shqipe dhe ato të huaja. Konstatohet se biblioteka ka libra që përkojnë me modulet apo lëndët përkatëse. <i>(Materiali 4.10)</i> Biblioteka ka qasje në 9 platforma online për qasje në literaturë prej të cilave ka qasje në literaturë relevante në psikologjinë klinike apo të ndërlidhur me modulet e programit aktual. Përpos kësaj biblioteka ka 7343 tituj.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Përpos bibliotekës me libra fizik studentët kanë qasje në disa platforma online të përmendura në <i>(Materiali 4.10)</i> . Nga analiza e platformave në të cilat kanë qasje studentët dhe stafi akademik mund të konstatohet se ato janë relevante me fushën e studimit të ofruar nga IAL. Më saktësisht studentët kanë qasje në këto platforma online në: UNRISD; Persee.fr,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

XB 

	<p>Cultivate your knowledge Erudit; Accueil; EuropPS; Springer.com; Sagepub.com; Wiley.com;</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Aktualisht biblioteka ka 8 kompjutera të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe programeve të tjera relevante për obligimet që mund t'i kenë studentët në raport me modulet përkatëse (<i>Materiali 4.10</i>). Studentët mund t'i përdorin platformat e përmendura edhe nga shtëpitë e tyre dhe nuk janë të kufizuar t'i qasen atyre vetëm nga biblioteka.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV mund të konstatohet se institucioni është i angazhuar për shtimin e fondit të librave në bibliotekë. Ka prodedura të qarta të planifikimit të buxhetit për fakultetin ku stafi akademik propozon blerje të titujve të nevojshëm për realizimin e moduleve përkatëse. Më saktësisht sipas (<i>Materiali 2.30</i>) specifikohet se për vitin 2021 janë dedikuar 2161 + 2040 + 2000 Lekë për shtimin e fondit të librave. Bazuar në dokumentin (<i>Evidenca për blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS</i>) mësohet se janë shpenzuar 11.546.105.12 lekë.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Orari i bibliotekës është nga 8.00 deri në 18.00 (<i>Materiali 2.29 dhe 4.10</i>) nga e hëna deri të premten. Nga diskutimet me studentët, GVJ konstatoi se ata kanë komente pozitive në raport me bibliotekën, shërbimet apo infrastrukturën aktuale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Duke u bazuar në vlerësimin e DVV, vizitës në IAL, konstatohet se është Sekretaria mësimore ajo që administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët. Ky dokumentim bëhet në formë digjitale dhe “hard-copy”. Të gjitha këto janë të përcaktuara në kuadër të <i>(Materiali 2.9. Rregulloret e Sekretarisë Mësimore)</i> ku specifikisht përcaktohen obligimet e administratës në nenin 4 specifikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - administrojnë të dhënat akademike dhe personale të studentëve; - administrojnë, mirëmban dhe ruan regjistrin themeltar regjistrin e artitjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, procesverbalet e provimeve, dosjet me dokumentacionin e regjistrimit dhe të çregjistrimit të studentëve dhe dokumentacionin statistikor përkatës; <p>Neni 5 i po të njëjtit dokument specifikon edhe funksionet e sekretarisë mësimore në kuadër të administrimit të shënimeve për student në sistemin elektronik. Neni 12 përcakton se si duhet të organizohet dosja e studentit përfshirë të atyre që janë në nivelin master.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar RVB, Zyra e Burimeve Njerëzore është zyra që administrojnë të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, dhe ndihmësakademik. Sipas <i>Rregullores së FSHS (2018)</i>, Neni 4 “Për rregulloret e brendshme”, deklarohet si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. FSHS përdor rregulloret të brendshme për aspekte të ndryshme të veprimtarisë dhe për struktura të caktuara të cilat miratohen nga organet dhe autoritetet drejtuese përkatëse të FSHS; 2. Rregulloret e njëjësive bazë dhe të strukturave ndihmësakademike dhe administrative shtrijnë efektin në njësitë dhe strukturat përkatëse, mbi personelin, studentët dhe bashkëpunëtorët e tyre; <p>Në Rregulloren e DPP (2021), Neni 5 “Organizimi i DPP”, përcaktohet se “DPP është njësi bazë që përgjigjet për cilësinë e</p>

	<p>programeve të studimit që mbulon, për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës dhe shkencor, si edhe për shërbimet administrative që mbulon”, dhe në Nenin 6, “Funksionet e DPP”, pika 1 e tij, përkufizohet se “ DPP nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore-shkencore, si edhe veprimtarine administrative”, dhe në Nenin 8 “Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP”, Pika 8.1 “Kompetencat e Drejtuesit të Departamentit në drejtim të mësimdhënies”, përshkruhet si vijon:</p> <p><i>a. Kujdeset për mbarëvajtjen e programeve të studimit të tre cikleve të studimit, si dhe programeve të lëndëve që menaxhon, duke bashkëpunuar me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Institucionit.</i></p> <p>Poashtu duke u bazuar Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikogji Klinike (2019) në nenin 10.2.2 përcaktohet se koordinatori i programit mban lidhje me studentët dhe stafin akdaemik dhe ndihmësakademik të për lehtësuar mbarëvajtjen e objektivave të programit.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, aksesit në informacion dhe dokumentacion për personelin dhe studentët bëhet në përputhje me ligjin e ruajtjes së privatësisë, ligjit 80/2015 të AL, Statutit të UT, dhe rregulloreve përkatëse. Studentët dhe stafi akademik akseson portalin e studentit nëpërmjet një username dhe fjalëkalimi që vihet në dispozicion nga sekretaria. <i>(Evidenca nr. 2.16 - Politika e FSHS e publikimit të informacionit të sigurimit të cilësisë, informacioneve për programet e studimit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>IAL ka në dispozicion platformën Microsoft Teams përmes të cilës komunikojnë në lidhje me lëndët apo modulet përkatëse. Po ashtu komunikimi emailave zyrtar. Kjo është konfirmuar edhe në bisedën më studentët e programit në vlerësim. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. Ky proces realizohet nëpërmjet domain-it zyrtar të UT-së (outlook), përmes email adreave të dedikuar për stafin dhe studentët. Sipas RVB (2022), përmes këtij sistemi dhe adresave të tyre, studentët e UT-së kanë mundësi të aksesojnë edhe në forumet e faqes zyrtare të internetit të UT-së. Përmes këtyre forumeve online, studentët mund të marrin informacion në lidhje me jetën</p>



	studentore, oraret e kurseve, pedagogët, leksionet/materiale mësimore, administratën, etj. Në të njëjtën kohë, komunikimi elektronik nëpërmjet platformën Microsoft Teams, e përdorur fillimisht për zhvillimin e mësimi online, vijon të jetë e aksesueshme dhe shfrytëzohet nga stafi akademik dhe studentët për qëllime mësimore (detyra, literature, konsulta, njoftime, etj.).								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në bazë të politikave ekzistuese të burimeve njerëzore kjo zyrë ka në jurisdikcion monitorimin e procesit akademik dhe raporton për mbarëvajtjen e procesit mësimor tek menaxhmenti i fakultetit. (Materiali 2.20 Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit). Të dhënat ruhen në formë të printuar dhe një pjesë e tyre dhe në formë elektronike. GVJ kqyri disa prej dosjeve të personelit akademik të vëna në dispizicion nga struktura dhe vuri re se dosjet përfshinin dokumentet e kërkuara sipas formateve, standardeve dhe rregulloreve përkatëse të Zyrës së Burimeve Njerëzore të UT.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacionet në lidhje me programin në faqen e web-it, të përmendur në RVB, janë në gjuhën shqipe. Përpos faqes së web-it, IAL përdor edhe rrjetet sociale për informimin e studentëve dhe opinionin publik për aktivitetet e IAL. http://fshs-ut.edu.al https://ëëë.instagram.com/info.fshs/ https://ëëë.facebook.com/fshsut/								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe	Duke u bazuar në takimet me administratorin e IAL dhe përgjegjësve për financat, mund të konstatohet se institucioni përkatës harton raporte financiare në lidhje me të ardhurat dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>shpenzimet që ndërlidhen me IAL në përgjithësi dhe jo programeve në veçanti. Në <i>(Evidencën 2.34) Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit të FSHS, janë të detajizura projektimet dhe shpenzimet që ndërlidhen me stafin dhe kosto të tjera që ndërlidhen me funksionimin e fakultetit dhe programit në vlerësim.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas RVB dhe diskutimeve në IAL plani financiar bëhet për të gjitha programet pasi edhe stafi është i angazhuar në disa programe njëkohësisht. GVJ nuk ka gjetur dëshmi për plane të financimit që bëhet në formë të veçantë për çdo program studimi. Analiza e <i>(Evidencës 2.34) Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit të FSHS, rezulton me projeksione dhe raport në pasqyra financiare që përshijnë kostot e burimeve njerëzore, kosto të tjera që ndërlidhen me shpenzimet e tjera operative dhe me mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse dhe shpenzimeve për biblioteka (Materiali për blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifata e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose</p>	<p>Sipas RVB dhe diskutimeve në IAL, pasqyrat financiare i nënshtrohen kontrollit nga dega për tatim dhe taksa dhe auditimit financiar nga rektorati i Universitetit të Tiranës. Sipas Statutit të UT nenit 53 dhe nenit 55, Njësia e Auditimit të Brendshëm “<i>Monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet auditimit të brendshëm.</i>”; “<i>Siguron që administratori të informohet me raportet vjetore të auditimit të brendshëm të njësisë për mënyrën e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e tij dhe hartimit të deklaratës vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm</i>”. Në <i>(Materialin 2.34) Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit të FSHS janë të</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

ndarjen e burimeve financiare.	raportuara të ardhurat financiare përfshirë edhe hyrjet financiare nga tarifat e shkollimit.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Referuar (Materiali 2.34) Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit të FSHS, janë dorëzuar raportet financiare për nga viti 2019-2021. Raportet financiare janë të përpiluara për fakultetin në përgjithësi dhe jo për programin e psikologjisë klinike. Ato përfshijnë informata mbi shpenzimet e përgjithshme të burimeve njerëzore dhe kostove të tjera të ndërlidhura me objektin dhe mbarëatjen e proceseve mësimore.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Institucioni ka financim publik të qëndrueshëm dhe garanton qëndrueshmëri financiare për programet që janë në implementim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	0 Përmbushet	1 Përmbushet pjesërisht	2 Përmbushet kryesisht	3 Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	0 Përmbushet	1 Përmbushet pjesërisht	2 Përmbushet kryesisht	3 Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

XB

[Signature]

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UT ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, rregulloren e programit të studimit të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht referuar neneve 25 dhe 26 të rregullores së programit të studimit, në këtë program studimi, pranohen student nga Republika e Shqipërisë si dhe shqipëtarë të trojeve nga Kosova, Republika e Maqedonisë Veriore Mali i Zi, nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe. Kriteret përzgjedhëse janë, dëshmi e zotërimit të gjuhës angleze, dhe të ketë përfunduar studimet universitare të Ciklit të parë në fushat e studimit në Psikologji dhe Psikologji – Sociologji brenda dhe jashtë vendit. Kanë prioritet studentët e FSHS të UT.</p> <p><i>Dokumenti 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit</i> <i>Dokumenti 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit</i> <i>Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit</i></p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UT nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Specifikisht të drejtat e studentëve paraqiten në kreun IX të Statutit, dhe neneve 25 dhe 26 të rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Dokumenti 3.6 Rregullore e programit të studimit ku përcaktohen</i></p>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit,	<p>Programi i ka të definuara kriteret e pranimit <i>Materiali 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit. Po ashtu Materiali 3.6 Rregullore e programit të studimit në nenin 27 përcakton kriteret e pranimit:</i></p>

<p>njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dëshmi e zotërimit të gjuhës angleze e noteruar e shoqëruar me origjinalen. (Dëshmi e provimit të lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të UT, TOEFL ose Cambridge IELTS, CPE, CAE). 2. Të kenë përfunduar studimet universitare të Ciklit të parë në fushat e studimit në Psikologji dhe Psikologj-Sociologji, brenda dhe jashtë vendit. <p>Neni 27 parashikon gjithashtu se në këtë proces kanë përparësi studentët e diplomuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Dokumenti i njëjtë përcakton kriteret për diplomim dhe se cilat janë kushtet minimale për diplomim në kreun VI Diplomimi. Dokumenti i njëjtë përcakton qartësisht në Kreun V vlerësimin e studentit ku përcakton: procedurat dhe kriteret e vlerësimit, të drejtën për të hyrë në provim, zhvillimin e provimeve, komunikimin e vlerësimeve dhe dokumentimin e vlerësimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e ciklit të dytë të studimit</p>	<p>Referuar RVB përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar sipas kritereve të vendosura në përputhje me aktet e nxjerra nga MASR. Referuar neneve 25 dhe 26 të rregullores së programit të studimit, në këtë program studimi, pranohen student nga Republika e Shqipërisë si dhe shqipëtarë të trojeve nga Kosova, Republika e Maqedonisë Veriore Mali i Zi, nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe. Kriteret përzgjedhëse janë, dëshmi e zotërimit të gjuhës angleze, dhe të ketë përfunduar studimet universitare të Ciklit të parë në fushat e studimit në Psikologji dhe Psikologji – Sociologji brenda dhe jashtë vendit. Kanë prioritet studentët e FSHS të UT.</p> <p><i>Materiali 3.14 ku përcaktohen kriteret specifike për pranimin në programin master shkencor psikologji klinike.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Ashtu si u cek në kriterin 4 të këtij standardi, kriteret e pranimit bëhen publike në disa forma në fakultet, në faqen e web-it dhe duke përdorur kanalet e rrjeteve sociale të fakultetit http://fshs-ut.edu.al https://ëëë.instagram.com/info.fshs/ https://ëëë.facebook.com/fshsut/ https://fshs-ut.edu.al/?page_id=131</p> <p>Përveç këtyre metodave, IAL promovon programin përmes ditëve të hapura kur kandidatët potencialë mund të vizitojnë objektin dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	të informohen për programin. Në kuadër të dokumenteve të dorëzuara është dorëzuar edhe <i>Dokumenti 3.16 Politika e marketingut të programeve dhe transparenca - Departamenti i pedagogjisë dhe psikologjisë</i> , në këtë dokument përcaktohen strategjitë e reklamimit të programeve dhe promovimit të rolit të psikologut. Dokumenti përcakton edhe audiencat e synuara për programet përkatëse.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në bazë të RVB, diskutimit me studentët dhe pedagogët të programit në fjalë, mësohet se FSHS/DPP informon studentët në lidhje me vlerësimet përmes komunikimit të drejtëpërdrejtë, por edhe përdorimit të platformave online. Studentët kanë raportuar se janë të kënaqur me cilësinë e komunikimit me stafin pedagogjik të programit. Po ashtu, lëndët kanë syllabuse që përcaktojnë pritshmëritë, obligimet e studentëve për module apo lëndë të caktuara. Po ashtu për studentët e vitit të parë organizohen “Java e orientimit” ku me sesione informuese dhe orientuese për studentët ata njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Për më shumë <i>Dokumenti 3.6 për rregulloren e programit</i> në kreun 6 janë të detajuara organizimi i studimeve ku në nene të veçantë definojnë afatet dhe drejta e studimeve, ndërprerja e studimeve, plani mësimor, format e mësimi, vlerësimi etj.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sipas RVB kriteret e njohjes eventuale të kualifikimeve të mëparshme të studimeve, menaxhohen duke krijuar komisione ad hoc në koordinim me drejtuesin e DPP. Në këto komisione shqyrtohen kërkesat që mund të bëjnë me njohjen e kualifikimeve, studimeve të mëparshme, etj. <i>Dokumenti 3.6 rregullorja e programit.</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve apo moduleve përkatëse janë pasqyruar kriteret e vlerësimit dhe detyrimet e studentëve. Këto janë të reflektuara në syllabuse që studentët i kanë edhe online në Microsoft Teams. Poashtu sipas <i>Dokumenti 3.6 rregullorja e programit</i>, kreu V vlerësimi i studentit specifikohet në nenin 19 procedurat dhe kriteret të vlerësimit më specifiku aty vendosen parimet të cilat janë të reflektuara në sillabuset e lëndëve:</p> <p><i>“Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programmin e lëndës dhe i b ëhen të ditura studentëve.”</i></p> <p><i>“Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:</i></p> <p><i>a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar;</i></p> <p><i>b) me detyra kursi, projektke, postera;</i></p> <p><i>c) i bazuar në shumëllojshmëri formash vlerësimi;</i></p> <p><i>“Vlerësimi për secilën lëndë mësimorë kryhet pas pëfundimit të saj.”</i></p> <p><i>“Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Notat nga 5 e më lart janë kaluese.”</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB departamenti përmes strukturave të tij informon studentët përgjatë semestrit të parë në lidhje me temën e diplomës dhe procedurat. Sipas (<i>Dokumenti 4.5 paketa e punimit të diplomës për programin e studimit, e-ASCAL</i>) përcaktohen standartet dhe rregullat e punimit të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temës së diplomës. Studentët në fillim të vitit akademik njoftohen për datat e dorëzimit të punimeve dhe sigurojnë mbikëqyrje nga pedagogët e programit. Po ashtu sipas <i>Dokumenti 3.6 rregullorja e programit</i>, neni 18 përcaktohen parimet e punës së temës së diplomës:</p> <p><i>“Punimi i diplomës është punimi shkencor që studentit duhet të mbrojë për të fituar diplomën Master i Shkencave në “Psikolog Klinik.”</i></p> <p><i>“Për punimin e diplomës janë caktuar 30 kredi.”</i></p> <p><i>“Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së punimit të diplomës studenti duhet të: a) të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore; b) të zbatojë me përpikmëri standartet dhe kriteret e rregullores së punimit të diplomës për Master i shkencave në</i></p>

	<i>"Psikolog Klinik" që ju prezantohet nga koorindatori i programit të studimit ose nga përgjegjësi i departamentit.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Sipas RVB dhe takimit me stafin, institucioni organizon aktivitetin "Java e orientimit" ku studentët njoftohen më gjerësisht për programin e studimit si dhe kërkesat e programit. Përpos këtij aktiviteti, të dhënat për programin, përmbajtjen, profilin, informatat mbi karrierat potenciale pas mbarimit të studimit janë të disponueshme në faqen e web-it të fakultetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët mund të informohen edhe para fillimit të studimeve mbi strukturën, organizimin, kreditë dhe kohëzgjatjen e studimeve përmes faqes së web-it të fakultetit, ku gjenden informata për programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike https://fshs-ut.edu.al/?page_id=237 . E njëjta informatë u mundësohet studentëve edhe kur fillojnë studimet përmes syllabusëve për modulet përkatëse dhe obligimet e studentëve në çdo modul.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët kanë në dispozicion Planin Mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullore të programit të studimit, dhe informata për detyrimet dhe obligimet e tyre në raport me programin. Programet lëndore/syllabuset përmbajnë informacion për rezultatet e pritshme të të nxënit, përmbajtjen, literaturën dhe veprimtaritë mësimore në kuadër të moduleve përkatëse të programit.

XB

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, institucioni dhe fakulteti kanë një bord të punës i cili në bashkëpunim me alumni, organizojnë panairë të punës dhe ligjërata me aktorë nga tregu i punës. Qendra për karrierë sipas intervistave informon po ashtu, në rast të mundësisë për punë në nivel të fakultetit. Sipas https://fshs-ut.edu.al/?page_id=9206, zyra për karrierë ofron këto lloje të shërbimeve.</p> <p>Shërbimi i karrierës i FSHS-së ofron shërbime të shumëllojta informimi, orientimi, këshillimi, trajnimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. informim për karrierën; 2. orientim për karrierën; 3. këshillim për karrierën; 4. trajnim për zhvillimin në karrierë; 5. informim dhe asistencë për aplikim për programet e studimit; 6. asistencë për praktikën profesionale; 7. informim për mundësinë e arsimimit të mëtejshëm dhe zhvillimin profesional; 8. asistencë për veprimtaritë e studentëve dhe të diplomuarve; 9. informim dhe orientim për tregun e punës; <p>Programi ka të rregulluar <i>organizimin e praktikës së punës Dokumenti 4.4</i>, që mund të konsiderohet si orientim i studentëve për zhvillimin e shkathtësive për orientimin e mëtejshëm të tyre drejt tregu të punës.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët marrin informatat e para përmes “Javës së orientimit”, më pas studentët mund të informohen për lëndët dhe procesin mësimor përmes platformave online (E-studenti dhe Microsoft Teams) ku gjejnë qasje në oraret dhe materialet për lëndët përkatëse. <i>Materiali 4.2. Plani mësimor i studimit</i> përmban të gjitha informatat për lëndët dhe kreditet. Po ashtu, edhe nga biseda me studentët nuk është shënuar asnjë vërejtje në raport me informimin për procesin mësimor apo për ndonjë lëndë/modul specifik. Ambientet e fakultetit janë të pajisur me wi-fi që mundëson qasjen në platformat e përmendura.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet</p>	<p>Sikurse u cek në kriterin e mëparshëm të gjithë studentët dhe stafi janë të pajisur me qasje në sisteme online që mundësojnë sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Këto sisteme mundësojnë lehtësisht shkëmbimin e informatave, ky fakt u konfirmua edhe në intervista që GVJ i zhvilloi me stafin akademik,</p>

të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	administrativ dhe me studentë. Ky sistem po ashtu mundëson edhe dokumentimin e aktivitetit mësimor të studentëve. E-studenti përdoret për regjistrim, menaxhimin e studentëve, qasje në module, materialet, sillabuse dhe në vlerësimet nga modelet e caktuara. Përpos kësaj studentët kanë qasje edhe në Microsoft Teams që më shumë përdoret për mësimdhënie.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Referuar vizitës në institucion dhe <i>Evidencën 4.8 të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studenteve sipas viteve akademike</i> , konstatohet se numri i studentëve për katër vite akademike ishte: 2018-2019 33 studentë; 2019-2020 36 studentë; 2020-2021 35 studentë; 2021-2022 39 studentë; Nga e njëjta evidencë dokumentohet se gjatë vitit 2019-2020 janë diplomuar 34 studentë, 19 janë që të punësuar në përputhje me profilin profesional dhe 8 kanë qenë të punësuar jo në përputhje me diplomën.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para	Institucioni disponon statistika për numrin e të rregjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve etj. Numri i studentëve të regjistruar në program për 4 vitet e fundit akademike është 143. Po ashtu institucioni ka shënime për numrin e transferimeve (<i>Materiali 4.9 Te dhëna tabelore për transferimin e studenteve të</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>programit), ku në vitin 2019-2020 nga programi në vlerësim është çregjistruar 1 (një) student.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Klinike posedon dokumentacionin fizik dhe elektronik për vlerësimin e studentëve në lëndë të caktuara prej hyrjes deri në diplomim. Të dhënat janë në zyrën e regjistrimit të studentëve dhe sekretaria mësimore. Gjatë vizitës në institucion, GVJ ka ekzaminuar këto të dhëna. Poashtu në RVB ceket se nota mesatare në hyrje të studentëve ka qenë 9.0 ndërsa në dalje është rritur në 9.2. Për më shumë platforma E-studenti që rregullohet me rregulloren për funksionimin e sistemit informatik të UT përcakton (https://unitir.edu.al/rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik-ne-universitetin-e-tiranes/) citon se kjo platforme mundëson: regjistrimin e studentëve me gjeneralitete në sistem, regjistrimin e studentëve në grupe mësimore, kalimi i studentëve në vite pasardhëse sipas numrit të kredive që përcaktohen në rregulloren e UT, regjistrimin e studentëve të transferuar, printimi i procesverbaleve paraprake të studentëve të regjistruar në provime, printimi i procesverbaleve përfundimtare të provimeve, arshivimi i provimeve, hedhja e notave të studentëve, printimi i listës së notave për studentët që janë në vazhdimësi të studimeve të tyre, printimi i certifikatave të notave.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>E-studenti ka dosjen personale të studentit me të gjitha të dhënat për studentin që nga regjistrimi e gjer në diplomim. Këto të dhëna janë në dispozicion të studentit. Pedagogët e lëndës kanë qasje në lëndët apo modulet përkatëse dhe regjistrojnë notat, dhe mund të kenë qasje në statistikën për lëndët apo modulet që zhvillojnë. Në rregulloren për funksionimin e sistemit informatik të UT (https://unitir.edu.al/rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik-ne-universitetin-e-tiranes/) përcakton në mënyrë të qartë në nenin 7 nivelin e përdoruesve të këtij sistemi dhe se kush ka të drejtë të gjenerojë cilin lloj të informatës. Rregullorja e UT-së për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT (Materiali 1.7) përcakton të drejtat dhe kufizimet në raport me menaxhimin e shënimeve që ndërlidhen me procesin edukativ dhe administrativ përgjatë studimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte</p>	<p>Sipas RVB, departamenti ruan të gjitha të dhënat për studentët në hyrje dhe dalje, si dhe kryen studime të tregut për punësimin e tyre.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Referuar studimit “Alumni në Master i Shkencave në Psikologji Klinike: rezultate të studimit, 2021” rezulton se 79% të diplomuarve nga programi i MSH-PK janë të punësuar. Shumica prej atyre që janë të punësuar punojnë në fushën përkatëse apo që ndërlidhet me fushën e studimit (Materiali 4.8). Nga (Materiali 4.14) konstatohet se ka shënime për numrin e psikologëve klinik të licencuar përgjatë viteve, në 2019 janë 32 të licensuar, në 2020 janë 32 dhe ne 2021 jane 30 të licensuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në Statutin e UT parashikohet përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse në nivel të Universiteti. Bazuar në nenin 129 të statutit studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësinë e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senatin Akademik; - Këshillin e Etikës; - Komisionet e përhershme të lejuara me statut; <p>Këshillat e studentëve;</p> <p>Në kuadër të këshillave të studentëve ata kanë të drejtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e UT-së dhe njësive kryesore; 2. Të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimit të UT-së, rregulloret për veprimtaritë mësimore, si dhe të drejtën për të studiuar; 3. Të japin opinionet e tyre për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga njësiti kryesore dhe/ ose njësiti bazë; 4. Të marrin pjesë në përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët dhe të bëjnë



	<p>propozime në lidhje me to dhe me bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose me ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>5. Të organizojnë së bashku me njësitë kryesore ose vetëm veprimtari të ndryshme shkencore, shoqërore, kulturore, artistike, sportive etj;</p> <p>Në mënyrë më specifike në kuadër të rregullores së programit të studimit në vlerësim <i>Materiali 3.6</i>, koordinatori është i obliguar të koordinojë veprimtarinë dhe të mbajë kontakte me studentët për të lehtësuar përmbushjen e objektivave të programit. Në të njëjtin dokument neni 31 thekson se studentët duhet të përfaqësohen në organet drejtuese të programit master shkencor psikologji klinike dhe të marrin pjesë në vlerësimin e veprimtarisë të programit master shkencor psikologji klinike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshillat Studentorë të Fakulteteve mund të jenë organe më të afërta në raport me programin e vlerësuar. Studentët sipas RVB vlerësojnë pedagogët dhe lëndët të cilat më pas shqyrtohen nga pedagogët dhe drejtuesi i departamentit (e cekur në intervista me pedagogë). GVJ ka shqyrtuar format e vlerësimit. Materialetë tjera relevante për këtë kriter janë <i>Materiali 2.19 raport periodik i NJSBC</i>. UT disponon më një paketë të instrumenteve (<i>Materiali 1.14</i>) të strukturuar për vlerësimin e cilësë përpara çdo provimi, para diplomimit, vlerësimi i pedagogut etj. Nga vizita në institucion GVJ ka konstatuar se studentët vlerësojnë pedagogët përmes formularëve në fund të semestrit dhe se kanë qenë pjesë e GVB në dorëzimin e raportit të VB. IAL ka Politika për mbëshjtetjen e studentëve dhe stukturave të tyre organizative (<i>Materiali 2.26</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe duke zbatuar aktet ligjore në fuqi. Statuti dhe rregullorja parashikojnë procedurë joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme, mobilitetet e studentëve dhe ripranimin në programin e studimit.</p> <p>IAL ka procedurë specifike për procesin e njohjes së studimeve paraprake apo njohjen e lëndëve të mëparshme nga një studim paraprak që realizohet përmes komisioneve ad hoc</p>

plota apo të pjesshme të mëparshme.									
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Studentët me Vendimin e Dekanit të FSHS për ngritjen e GVB janë pjesë e ekipit të vlerësimit përfshirë edhe programit master shkencor psikologji klinike. <i>Dokumenti 1.6 rregullore për cilësi UT</i> në një nga parimet themelore të menaxhimit të cilësisë përcakton fokusin tek studenti. Studentët marrin pjesë në vlerësimin e pedagogëve. Gjatë diskutimit të GVJ me studentët e programit konstaton se në bazë të përgjigjeve të dhëna studentët kanë ndjesi të përfshirjes dhe komunikimit të lirë si me pedagogët ashtu edhe me menaxhmentin e programit në adresimin e çështjeve.								
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë mekanizma për ankimim në raport me vlerësimet apo çështjet e tjera. FSHS (<i>Materiali 2.26 Informacion për bazën rregullatore të ankimimit të studentëve</i>), bazohet në rregulloren e UT ku studentëve ju garantohet e drejta e ankimimit për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit. Përgjegjësi i departamentit nëse verifikon shkelje të korrigjueshme, në bashkëpunim me komisionin e provimit, bëjnë korrigjimet e duhura. Në rast se përgjegjësi i departamentit e gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, i propozon dekanit i cili pasi është njohur me të gjithë procedurën merr vendim. Nëse ai e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rizhvillimin e provimit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyhet</th> <th>Përmbyhet pjesërisht</th> <th>Përmbyhet kryesisht</th> <th>Përmbyhet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht				X
Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht						
			X						

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose	Duke u bazuar në (<i>Evidencën 4.8 të dhëna të plota për kërkimin shkencor në kuadër të programit të studimit</i>) janë dokumentuar 19 botime, 74 artikuj shkencor, 132 referime në konferenca

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	shkencore dhe 7 monografi. Në dokumentin e cekur cekën se janë 36 projekte nga të cilat 5 kanë qenë projekte shkencore ndërkombëtare <i>(Materiali 4.12 Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e e programit të studimit).</i>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	FSHS si pjesë e UT, ka dokumentuar marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet në rajon dhe partnerë të tjerë me të cilët bashkëpunon në kuadër projektësh dhe realizimit të praktikave profesionale. Më specifikisht RVB cek se ka marrëveshje me Universitetin "Hasan Prishtina", Universiteti i Lozanës dhe Universitetin e Tetovës. <i>(Materiali 3.10-raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.	Nga takimi me stafin dhe studentët GVJ konstaton se ka një bashkëpunim midis studentëve dhe pedagogëve në studimet e përbashkëta, që ndodhin qoftë në kuadër të moduleve apo lëndëve përkatëse, apo qoftë të projekteve të cilat janë inicuar apo implementuar nga stafi akademik. Nga dokumentacioni i shqyrtuar personeli akademik punon me studentët vetëm në punimet e diplomës si studime e punime shkencore <i>(4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit).</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Në RVB përmendet revista AJPR e cila nuk mund të gjendet online. Në diskutim me stafin akademik është përmendur se UT ka mekanizma financiar për pagesën e shpenzimeve eventuale për publikime në revistat ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS apo Web of Science.
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Përkundër entuziazmit të personelit akademik për përfshirjen e studentëve në studime inovative, <i>GVJ konstaton se është relativisht e vështirë të sigurohen fonde apo edhe studime për patenta në fushën e psikologjisë klinike.</i>
Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Nga diskutimet me studentët dhe stafin akademik GVJ konstaton se personeli akademik ofron ndihmë dhe asistencë të nevojshme në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës. Poashtu RVB cek se stafi akademik luan një rol aktiv duke ndihmuar studenët në gjenerimin e ideve dhe përzgjedhjen e fushës së tyre kërkimore dhe ofron asistencë në kryerjen e analizave, matjeve dhe studimeve dhe përpunimit të rezultateve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	në kuadër të realizimi të diplomës. Për më shumë neni 6 (Dokumenti 4.5 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit) përcakton përgjegjësitë dhe drejtat e udhëheqësit ku i kërkohet mbështetja e duhur akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit</p>	<p>DPP dhe programi i Psikologjisë Klinike ka marrëveshje të ndryshme me organizata vendore për të mundësuar praktikën për studentët. Në RVB në kriterin aktual përmenden bashkëpunimet ndërkombëtare dhe jo ato që janë me organizmat shkencorë kombëtarë.</p> <p>Bazuar në dokumentin “Lista e projekteve 4 vitet e fundit” dhe dokumentin “Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit”, dëshmohet se FSHS/DPP ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe vendase dhe të huaja në fushën e projekteve, studimeve rajonale dhe kërkimit shkencor. (Materiali 6/5. Lista e projekteve 4 vitet e fundit), dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL; (Materiali 87/4.12 Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit, e-ASCAL).</p> <p>FSHS tregon se bashkëpunon me institucione homologe jashtë vendit në kuadër të projekteve për mobilitetin e personelit dhe studentëve. Sipas të dhënave për dy vitet e fundit (2020-2021; 2021-2022), rezultojnë 8 studentë dhe 8 pedagogë të cilët kanë përfituar nga projektet bashkëpunuese për mobilitet. (Materiali 74/3.20 Te dhena për mobilitetin e studenteve dhe të pedagogëve, e-ASCAL).</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe</p>	<p>GVJ konstaton se modulet për metodat e hulumtimit dhe modulet e tjera në program (Materiali 4.7 - Programet mësimore</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>të lëndëve të programit të studimit) nga studentët kërkohet që të dorëzojnë punime shkencore që kërkojnë shqyrtim literature dhe analizë të dhënave në disa raste. Të gjitha këto aktivitete në kuadër të moduleve mundësojnë vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. GVJ konstaton se modulet për metodat e hulumtimit dhe modulet e tjera në program (<i>Materiali 4.7 - Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>), nga studentët kërkohet që të dorëzojnë punime shkencore që kërkojnë shqyrtim literature dhe analizë të dhënave në disa raste. Të gjitha këto aktivitete në kuadër të moduleve mundësojnë vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore.</p>	<p>Siç është cekur në standardin II.8, njësia përgjegjëse për programin e studimit, angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe/ose studentët për realizimin e këtyre objektivave. Në RVB (2022), DPP argumenton se “Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve të DPP-së në një sërë projektesh e studimesh me karakter kërkimor shkencor zhvillon dijet dhe kompetencat profesionale të tyre”. Disa prej projekteve ku është angazhuar stafi akademik dhe/ose studentët e tyre janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shkolla e Drejtorëve (CSL); 2) AKKSHI; 3) Validimi i instrumentit të orientimit profesional VISA si pjesë e marrëveshjes me Risi Albania dhe Universitetin e Lozanës; 4) Sfida për përmirësimin e mësimin online – projekt kërkimor, mbështetur nga AMSHC - Forumi Shqiptar Social Ekonomik – Aset; 5) Projekti kombëtar i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve “Për trajnimin e mësuesve 2019-2021”, në bashkëpunim me Fondacionin “Joscelyn”; 6) Implementation of Articles 16 & 12 of the Istanbul Convention – country report – UN Women & EËP EN; 7) Project Evaluation: “Support for the network for the catholic education institutions in Albania.” Commissioned by Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar – KKEKSH;

	<p>8) Improving the Nutrition Status of school age children in Albania, ACER and UNICEF, Methodologist and coordinator for communication for behaviour change, 2020;</p> <p>9) The causes of unethical behaviours and corruption in Albanian Education system, National Study in all Albanian education levels, Methodologist and data analyst, conducted by ACER and supported by Mary Eorld Loreto, 2020;</p> <p>10) National study for needs assessment targeting LGBTI in the project “Supporting LGBTI+ People in Albania through Empoerment Services, Standardization of Social Services and Changing of Negative Stereotypes” by “Streha” Center and German Embassy, 2020;</p> <p>11) Evaluation Report “My school is a safe place” UNICEF and YËCA: Methodologist and Report Eriter”, 2020;</p> <p>12) Bashkëpunimi me rrjetin Rajonal Western Balkans European Social Survey për të promovuar Anketën Sociale Europiane;</p> <p>13) Bashkëpunimi me GIZ për hartimin e një kurrikule për praktikantët e pastrimit të parave;</p> <p>Nga vizita në institucion dhe në bisedat me studentë është konstatuar se profesorët përfshijnë studentët në projektet kërkimore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>FSHS ndjek një politikë e cila inkurajon bashkëpunimin me kërkuesit e huaj. Në dokumentin “Politika për bashkëpunim dhe partneritetin (2020)” theksohet se politika e bashkëpunimit dhe e partneritetit të FSHS vlerëson se kërkimet cilësore mund të arrihen përmes lidhjeve, partneriteteve dhe bashkëpunimeve me institucione me të njëjtën qasje (fq/2). (<i>Dokumenti 44/2.23 Politika për bashkëpunim dhe partneritetin</i>).</p> <p>Sipas dokumentit “Raporti periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikim dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit, 2016-2021”, në pikën 1.5 “Për bashkëpunimin e brendshëm dhe të jashtëm”, DPP shpjegon se njësisia bazë “ka patur një sërë bashkëpunimesh shkenore me oragnizata dhe universitete homologe” (fq. 3). Në pikën 1.8 të këtij dokumenti, theksohet se “Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar me institucionet homologe mund të arrihet</p>

	<p>nëpërmjet rrjetëzimit me departamente të ngjashme dhe institucione kërkim. Shkëmbimi i pedagogëve dhe studentëve mundësohet edhe nga projekti Erasmus plus, por edhe nëpërmjet formave të tjera të bashkëpunimit, si studimet e përbashkëta ndërkombëtare. Zhvillimi i konferencave ndërkombëtare, ka hapur rrugën e bashkëpunimit me institucione të ngjashme jashtë vendit” (fq.4-5). (Materiali 86/4.11, Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit; e-ASCAL).</p> <p>Nga vizita ne institucion, GVJ mësoi se “Departamenti ka zhvilluar konferenca në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë të mbështetura nga buxheti i fakultetit”. Në këto konferenca kanë marrë pjesë edhe hulumtues të huaj. Një mënyrë tjetër e integritit të studiuesve të huaj është përmes ligjeratave që mbahen nga ekspertët ndërkombëtarë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>IAL dhe programi synon ndërkombëtarizimin të shpalosur në dokumentet strategjike të zhvillimit dhe ato rregullatore. Me shqyrtimin e dokumentacionin nuk vërehet ndonjë politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve në aktivitete ndërkombëtare (Dëshmi 3.2 - Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve), në këtë dokument ceket se në vitin 2020-2022 në total 8 student kanë qenë pjesë e programit Erasmus+. FSHS ka politika për mobilitetin e personelit dhe të studentëve (2.24 Politika për mobilitetin e personelit dhe të studentëve) në këtë dokument përcaktohet procesi i mobilitetit për studentët që shkojnë në universitete të tjera me program mobiliteti. Ky dokument sqaron hapat që duhet të ndërmerren nga studentët para dhe pasi të kthehen nga studimet.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Në standardin 2.8 kriteri 2, janë renditur projektet ndërkombëtare në të cilat ka qenë angazhuar DPP. Në Standardin 3.4, kriterin 8, thekohet: “Në RVB mund të konstatohet se ka bashkëpunime ndërkombëtare në hulumtime me partnerë ndërkombëtarë. Sipas RVB (2022), DPP raporton se një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe organizimi i leksioneve të hapura me tematika të caktuara, ku ftohen lektorë, studiues apo profesionistë të ndryshëm, vendas apo të huaj. Një shëmbull i mirë është leksioni i hapur me temë mbi psikodramën dhe vlerësimin e pacientit përmes metodave</p>

	të sociometrisë, organizuar në 2019, me lektorë të psikoterapisë nga Shoqata Shqiptare e Psikoterapisë dhe Instituti i Beogradit për Psikodramën”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka në funksion Zyrën e Këshillimit për Karrierë e cila ofron informim për studentët në baza individuale dhe për çeshtje specifike. (Dokumenti 2.25 Rregullore e shërbimit të Karrierës). Referuar RVB tutoriati dhe këshillimi akademik përmes zyrës së karrierës dhe këshilluesit të karrierës në cdo department, janë gjithashtu në shërbim të informimeve mbështetjes së studentit në cdo aspect.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çeshtje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstaton se mekanizimi i zyrës për këshillimin e karrierës (përmendur në kriterin 1, Dokumenti 2.25 Rregullore e shërbimit të Karrierës), ofron mbështetje që ndihmon në informimin, këshillimin dhe adresimin e çeshtjeve të ndryshme që ndërlihen me procesin mësimor dhe programin e studimit dhe përgratitjes së tyre për tregun e punës. Dokumenti 2.26 - Politikat për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative, ku përcaktohen objektivat e mbështetjes: mbështetja e FSHS për studentët si një përgjegjësi institucionale, si përgjegjësi e personelit dhe partnerëve; Përcaktimi i qasjes: studenti në qendës të veprimitarisë së FSHS, Identifikimi i llojeve të nevojave për mbështetje institucionale dhe nga personeli; Specifikimi i strukturave procedurave edhe udhezimeve për mbështetjen e studentëve. Për më shumë dokumenti përcakton fushat e mbështetjes: mbështetje personale për individë dhe grupe; mbështetje

X3 

	<p><i>akademike; mbështetje financiare; mbështetje psikologjike; mbështetje për zhvillimin e karrierës.</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se studentët kanë vlerësim të lartë për gadishmërinë e stafit akademik për të adresuar zgjidhje për probleme të ndryshme të lidhura me mbarëvajtjen e programit e studimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sipas RVB dhe vizitës në IAL, Zyra për Këshillim të Karrierës është mekanizëm zyrtar për ofrimin e informatave për punësim apo aktiviteteve të tjera relevante për studentët. <i>Dokumenti 2.25 Rregullore e shërbimit të Karrierës</i>, thekson se në këtë njësi punon së paku një person me orar të plotë. <i>Shërbimi i karrierës mbështet studentët aktual dhe të diplomuar të FSHS që të zhvillojnë potencialin e tyre për një karrierë të suksesshme. Shërbimi i karrierës ka për mision që nënpermjet informimit, orientimit, këshillimit, trajnimit të mbështesë studentët gjatë studimeve në FSHS dhe pas diplomimit që të shfrytëzojnë potencialet e tyre për zhvillimin e karrierës individuale, që të bëjnë zgjedhje të përshtatshme arsimore, të arrijnë sukses akademik, të orientohen në tregun e punës, të konkurrojnë me sukses në tregun e punës dhe të menaxhojnë me sukses karrierën.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Sipas RVJ, Zyra e Karrierës mbështet studentët përgjatë edukimit tyre dhe pas diplomimit me punësimin e tyre. Në studimin e DPP me temë "Alumni në Master Shkencor në Psikologji Klinike. Rezultate mbi punësimin" (2021), raportohet se studentët e diplomuar në MSH në PK, pjesëmarrës në studim, janë punësuar kryesisht në sektorin publik (41.4%), ndjekur nga ai jofitimprurës (28.6%) dhe privat (20%).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	PK	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

				X
--	--	--	--	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ duke u bazuar në shyrtrimin e dokumentacionit të dorëzuar konstaton se IAL dhe programi Master i Shkencave të Psikologji Klinike kanë politika dhe procedura të qarta të kontrollit të cilësisë brenda institucionit. Janë disa nivele të sigurimit të cilësisë. Se pari është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në Nivel Institucional (KPSSC) dhe Ekipi i Vlerësimit të Brendshëm (EVB). IAL ka politika të shkruara për sigurimin e cilësisë (<i>Materiali 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë</i>) ku caktohen parimet për menaxhimin e cilësisë, standardet për sigurimin e brendshëm të cilësisë, qëllimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, fushat dhe qasje të vlerësimeve nëkuadër të sigurimit të cilësisë, elementet që garantojnë cilësinë, veprimtari onitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi dhe si përdoren të dhënat e monitorimit të vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Dy njësitë e përmendura në kriterin 1, KPSSC dhe EVB i njësisë kryesore, të cilët bashkëpunojnë me stafin akademik, zyrën për burime njerëzore dhe njësitë e tjera në fakultet që siguron përfshirjen e stafit akademik. Nuk ka dëshmi të dorëzuar në përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ligji për arsimin e lartë 80-2015 cek në nenin 6 se “Sigurimi i brendshëm i cilësisë” është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë në IAL, që zhvillohet nga vetë institucionet. (<i>Materiali 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë</i>) në këtë drejtim përcakton se kjo njësi ka së paku një person që punon me kohë/orar</p>

	të plotë. Dokumenti i përmendur përcakton politikat dhe detyrat e njësive të sigurimit të cilësisë.			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017", Universiteti i Tiranës ka aplikuar për herë të parë për akreditimit të programit Master i Shkencave në "Psikologji" me profil: Psikologji Klinike. Referuar RVB Departamenti harton raporte periodike vjetore për ecurinë e departamentit. Këto raporte qarkullohen në departament nëpërmjet e-mailit. (Materiali 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së Njësive të Sigurimit të Cilësisë)			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Institucioni që ofron programin e studimit të marrë në vlerësim, ka plane strategjike në nivele të ndryshme përfshirë 1.4 Strategjia e zhvillimit të UT 2019-2023; 2.3. Strategjitë e Zhvillimit të FSHS 2018-2023; 3.2 Strategjia e Zhvillimit të DPP; 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit e-ASCAL). Më saktësisht në (Dokumentin 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së Njësive të Sigurimit të Cilësisë) përcaktohet se në fillim të çdo viti akademik NJSC, harton planin e veprimtarisë monitoruese dhe vlerësuese dhe ia paraqet dekanit të FSHS, ajo përgatit paketën me instrumentet dhe metodologjinë e përpunimit të dhënave dhe të informacionit. Po ashtu kjo njësi përkrah GVB.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nënvizues	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për	Dokumenti 1.11 Manuali i Cilësisë i UT, përcakton organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

XB 

<p>monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>brendshëm të cilësisë. Në këtë drejtim organograma (<i>Materiali 2.5</i>) e FSHS specifikon njsitë e posaçme për monitorim, shqyrtim, mbikëqyrje dhe rishikim të programeve si Komisioni i Sigurimit të Cilësisë (KSC) dhe Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC). Gjatë takimit me përgjegjësen e departamentit u konstatua se propozimi për hapjen e programeve dhe riorganizimin e tyre fillon nga njësitet bazë, dhe bëhet në përputhje me strategjinë e UT. FSHS ka Zv. Dekanin për ciklin e dytë të studimeve që merret me organizimin e procesit mësimor dhe rishikimin sistematik të planeve mësimore.</p> <p>(<i>Materiali 2.12 - Vendim për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë</i>);</p> <p>(<i>Materiali 2.13 Përshkrimi i veprimtarisë së njësisë së sigurimit të cilësisë së FSHS</i>);</p> <p>(<i>Materiali 2.6 – Struktura e programeve të studimit të FSHS për të tre ciklet e studimit</i>);</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>IAL dhe programi në vlerësim i nënshtrohen mekanizmave formale të shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të caktuar me rregulloret dhe udhëzimet e UT. NJSC në bazë të <i>Evidencës 2.13</i>, përcakton së këto vlerësime behen në bazë të rregullta, kjo përfshin se kjo njësi përkrah dhe asiston GBV në përgaditje të raportit të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>RVB përshkruan se bëhen vlerësime të rregullta vjetore për punën e departamentit në përgjithësi duke përdorur metodat sistematike si vlerësimi i lëndëve, diskutimi me pedagogë. Në dokumentin “Paketa e instrumenteve të cilësisë (miratuar nga Senati i UT më 23.12.2020)”, janë përfshirë formularë që institucioni përdor si instrumente për të siguruar të dhëna nga burime të ndryshme, si: Vlerësimi i lëndës nga studenti, Vlerësimi i studentëve që diplomohen, Raporti i studentëve, Vlerësimi për pedagogun, Formular për shqyrtimin e progresit të kërkimit të studentit (cikli i tretë), Raport i punëdhënësit, Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu, Formular i vlerësimit nga personeli akademik, Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut. (<i>Materiali 1.14, Instrumentet për vlerësim</i>).</p>

<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>NJSC në bazë të <i>Evidencës 2.13</i> informon komunitetin e FSHS dhe publikun për rezultatet e monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit përmes formave të ndryshme të komunikimit. <i>Evidencë 2.19</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet e dorëzuara si evidencë në e-ASCAL, më shumë duken se janë në formë të indikatorëve ose përqëndrohen në fakultetin në përgjithësi, sesa për programin i cili vlerësohet. (<i>Evidenca nr.2.18- Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019 – 2020, 2020-2021</i>).</p> <p>Megjithatë, nga vizita në institucion GJV konfirmoi se rezultatet e e vlerësimit të brendshëm, diskutohen në të gjitha njësitë e UT, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Mbështetur në të dhënat e paraqitura në raportet e vlerësimit të brendshëm, institucioni harton planet vjetore të punës së njërive bazë, përpilon urdhra e merr vendime në nivel institucional që orientojnë njësitë bazë e kryesore lidhur me zhvillimin e kulturës së cilësisë në institucion.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes së plotë</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo</p>	<p>Sipas RVB, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm harton raporte periodike për veprimtarinë mësimore dhe veprimtari të tjera që lidhen me programin e marrë në vlerësim. Këtu përfshihen edhe raportet e vetëvlerësimit institucional, për njësi të caktara akademike që kanë filluar të bëhen në kuadër të procesit të akreditimit përmes GVB. Raportet vjetore për veprimtaritë e kryera (<i>Materiali 2.18-1 dhe 2.18-2</i>) përmbajnë informata në raport me zhvillimet dhe arttjet brenda IAL.</p>



vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Sipas RVB, FSHS/DPP ka ndërtuar një sistem të unifikuar të vlerësimit me instrumente dhe metoda të ndryshme sic është raporti i vetvlerësimit i dorëzuar për akreditim. UT ka zhvilluar “ <i>Paketën e instrumenteve të cilësisë</i> ” (2020), ku janë pasqyruar pyetësorë, anketa, etj, që aplikohen në procesin e vlerësimit dhe monitorimit të punës së personelit akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor (<i>Materiali 15/1.14 Paketa e instrumenteve të cilësisë</i>).
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	UT ka hartuar “ <i>Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT</i> ” (2021), ku përcaktohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të personelit akademik të UT të të gjitha kategorive, duke filluar nga personeli me i ri e deri tek profesorët (fq. 6). Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësimor, si dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë. Niveli i arritjes që rezulton nga vlerësimi synon të reflektohet në përfitime, korrigjime ose rekomandime për të ardhmen ndaj anëtarëve të personelit akademik (fq.7). IAL ka udhëzime dhe informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit (<i>Materiali 2.19 Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit</i>), e cila i referohet dokumenteve të tjera si Manualit të cilësisë të UT, 2020. Po ashtu IAL posedon Rregulloren për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ ne UT (<i>Materiali 1.7</i>). FSHS ka bazën rregullatore për mësimdhënien dhe të nxënit e cila përmbledh nenet dhe dokumentet relevante në bazë të cilave drejtohen parimet e mësimdhënies dhe të nxënit (<i>Materiali 2.6</i>).
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të	Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi. Siaps “ <i>Rregullores së Sigurimit të Cilësisë në FSHS (2020)</i> ”, <i>Neni 15 “Metodologjia e punës së NJSC</i> ”, pika 3 shprehet se NJSC, për çdo veprimtari monitoruese dhe vlerësuese përgatit paketën me instrumentet dhe metodologjinë e përpunimit të të

personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.

dhënave dhe informacionit. Në *Nenin 21* “Burime dhe instrumente të vlerësimit të brendshëm”, përcaktohet se Vlerësimi i brendshëm bazohet në (c) Vlerësimet e drejtuesve (d) Vlerësimet e ekspertëve (e) Vlerësimet e kolegëve (f) Vlerësimet e studentëve (g) Vlerësimet e të diplomuarve (h) Vlerësimet e bashkëpunëtorëve (i) Vlerësimet e punëdhënësve (j) Të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, plotësimit të formularëve të vlerësimit, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit; (gj) Analizave bibliometrike. (*Dokumenti 2.14, e-ASCAL*).

Në dokumentin “Paketa e instrumenteve të cilësisë (miratuar nga Senati i UT më 23.12.2020)”, janë përfshirë formularë që institucioni përdor si instrumente për të siguruar të dhëna nga burime të ndryshme, si: Vlerësimi i lëndës nga studenti, Vlerësimi i studentëve që diplomohen, Raporti i studentëve, Vlerësimi për pedagogun, Formular për shqyrtimin e progresit të kërkimit të studentit (cikli i tretë), Raport i punëdhënësit, Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu, Formular i vlerësimit nga personeli akademik, Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut. (*Materiali 1.14, e-ASCAL*).

Referuar dokumentit “*Format për raportin vjetor për veprimtaritë e kryera*”, pika 2 e saj, informohet se “*Përgjegjësi i departamentit përmes koordinatorëve të programeve dhe studentëve monitoron dhe vlerëson vazhdimisht mësimdhënien, ku çdo semester zhvillon pyetësorin e studentëve, si dhe harton raporte mbi pyetësorin e studentëve dhe të pedagogëve*” (fq. 2).

DPP dëshmon se përfshin ish-studentët e diplomuar në MSH-PK, në studime me qëllim përmirësimin e treguesve të cilësisë së programit të studimit që ofron. Struktura përgjegjëse për programin, ka kryer studim me temë “*Alumni në Master Shkencor në Psikologji Klinike. Rezultate mbi punësimin*” (2021), ku informohet për numrin dhe sektorët e punësimit të studentëve të diplomuar në MSH në PK (*Matriali 4.14. Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve të programit; e-ASCAL*).

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	--	------------------------------	-----------------------------	------------------------------



Standardi VI. 4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sikurse është cekur edhe në vlerësimin e standardeve paraprake (IV.2), përbërja e NJSBC/EVB garanton përfaqësim të plotë të të gjithë aktorëve të brendshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. NJSC/EVB/GVB ka përfshirë përfaqësues të studentëve në vlerësimin të brendshëm të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Institucioni ka ngritur KPSSC me përfaqësi nga fakultete, institute, struktura të sigurimit të cilësisë në Rektorat dhe studentët</p> <p><i>(Evidenca nr.1.6- Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidenca nr.1.11 - Manuali i Cilësisë; Evidenca nr.2.19- Raport periodik i NJSBC (ose raport vjetor i NJSBC); Raport Vlerësimin të Brendshëm, 2022, e-ASCAL). (Evidenca nr.1.2- Statuti UT)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>IAL që ofron programin e studimit në vlerësim, ka bazë të mjaftueshme ligjore/rregullatore për rolet dhe përgjegjësitë e palëve të caktuara që mund të kontribuojnë në sigurimin e cilësisë së programit në vlerësim. Detyrat e tyre specifikohen në rregulloren e UT, Rregulloren e FSHS (2018), Rregulloren e NSBC (2020), Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Rregulloren e NJSC (2020).</p> <p><i>(Evidenca nr.1.6- Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidenca nr.1.11 - Manuali i Cilësisë; Evidenca 1.3, Raporti Periodik i NJSBC ose raporti vjetor; Materiali 2.12 - Vendim për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë; Materiali 2.13 Përshkrimi i veprimtarësë së njësisë së sigurimit të cilësisë së FSHS).</i></p>



<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FSHS/DPP ka përfshirë të gjithë aktorët relevantë në procesin e VB dhe vizita në terren ka dëshmuar përfshirjen e të gjitha palëve në vlerësim, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. GVJ konstaton se në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, FSHS ka ngritur Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të njësisë bazë, i përbërë nga: (5) anëtarë personel akademik dhe (1) një student i programit të studimit master i shkencave në psikologji klinike. Kryetari i grupit është i kategorisë Profesor.</p> <p><i>(Evidenca nr.2.17- Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS).</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se ekipi në fjalë është përzgjedhur nga personat që nuk kanë pozita udhëheqëse për të siguruar një objektivitet më të lartë. Studentët kanë qenë të përfshirë në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. FSHS ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj) <i>(Evidenca nr.1.6- Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidenca nr.1.11 - Manuali i Cilësisë; Evidenca nr.2.17- Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS).</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Referuar RVB (2022) vërehet se në përbërjen e GVB nuk ka ekspertë të jashtëm të përfshirë në vlerësimin e cilësisë së brendshme. Por, nga vizita në institucion, GVJ mësoi se institucioni bashkëpunon dhe këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me ekspertë të jashtëm të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e shërbimeve të shëndetit mental dhe psikologjisë klinike, duke marrë prej tyre mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> <p>DPP planifikon takime pune, tryeza të rrumbullakta, si dhe vendos komunikim të drejtpërdrejtë me institucionet partnere, jo vetëm për realizimin e praktikës profesionale, por edhe për të përfituar nga konsultimi me ekspertë të ndryshëm nga këto</p>

	institucione lidhur me sfidat për të përmirësuar programin e studimit MSH-PK, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë së UT/FSHS, Manuali i Cilësisë dhe dokumente të tjera rregullatore janë publike në faqen e internetit të UT/FSHS dhe të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara.</p> <p><i>(Evidenca nr.1.6- Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidenca nr.1.11 - Manuali i Cilësisë).</i></p> <p>Gjithashtu, në faqen e web-it të FSHS, aktualisht mund të gesh të publikuara edhe raportet e EVB të viteve 2017 dhe 2018.</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Raportet me rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit bëhen duke ruajtur anonimitetin e stafit akademik dhe nuk ka ndonjë indikacion mbi cenimin lirisë për të dhënat personale apo ndonjë shkelje tjetër etike. <i>(Evidenca nr.1.6- Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidenca nr.1.9- Privatësia në UT)</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Sipas RVB (2022) në bazë të përfundimeve të dala nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë, fillimisht njësia bazë dhe njësia kryesore angazhohen për të adresuar problemet e identifikuar.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se njësia bazë harton një plan veprimi që konsiston në përmirësimin e pikave të dobëta,</p>

	si plani tematik për trajnimin e stafit ose veprimtari ekstrakurrikulare me studentët, etj.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	IAL që ofron programin e studimit ka mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë që funksionojnë përmes vlerësimit të brendshëm në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe në nivel të programit Master i Shkencave në Psikologji Klinike (<i>Evidenca nr.1.6- Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Rregullore e Cilësisë së FSHS; Evidenca nr.1.11 - Manuali i Cilësisë</i>). Akreditimi është një nga masat e përmendura në RVB (2022) dhe që institucioni është duke e zbatuar për herë të parë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Në RVB (2022) deklarohet se institucioni ka një strukturë të posaçme sikurse Njësia e Sigurimit të Cilësisë e cila funksionon në mënyrë të organizuar dhe kontribuon në ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve për rëndësinë e sigurimit të cilësisë. Kjo njësi organizon veprimtari të tilla si: java e orientimit, siguron procesin për vlerësimin e lëndëve dhe përfshirjen e studentëve në vlerësimet e programeve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se çdo fillim viti akademik, Njësia e Sigurimit të Cilësisë planifikon veprimtaritë periodike me personelin dhe me studentet për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Psikologji, me profil Psikologji Klinike"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. UT/FSHS ka një përvojë të gjatë, të konsoliduar dhe vlerësohet si institucion lider në fushën e Arsimit Lartë në Shqipëri;
2. UT/FSHS/DPP që ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike, ka projektuar strategji të qarta për zhvillimin institucional, sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, zgjerimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe synon ndërkombëtarizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim;
3. UT/FSHS ndjek procedura të qarta për rekrutimin e stafit akademik;
4. Stafi akademik me kohë të plotë që mbulon programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike është i kualifikuar me grada e tituj, dhe demonstroi përkushtim për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Trupa akademike ka përvojë akademike dhe praktike që përshtatet me programin aktual dhe specifikën e lëndëve/moduleve që mbulon në programin e studimit të marrë në vlerësim;
5. FSHS/DPP përgjegjës për programin e studimit të marrë në vlerësim, demonstroi angazhim në projekte ndërkombëtare që mbështesin shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve;
6. FSHS/DPP, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional për organizimin dhe përmbushjen e qëllimeve të praktikës profesionale, si dhe veprimtarive të tjera mësimore për realizimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike;
7. FSHS/DPP demonstroi se bën përpjekje të vazhdueshme për të qenë në kontakt me tregun e punës, duke u mundësuar studentëve praktikë profesionale dhe mundësi punësimi. Përqindja e studentëve të punësuar është inkurajuese për programin e marrë në vlerësim.
8. UT/FSHS përfshin studentët në procese të ndryshme të ngritjes së cilësisë dhe vendimmarrjes. Struktura përkatëse e sigurimit të cilësisë aplikon vlerësimin periodik të lëndëve/moduleve nga ana e studentëve për të siguruar të dhëna mbi format e mësimdhënies dhe stafin akademik;
9. Infrastruktura fizike e FSHS-së është e përshtatshme për mbarëvajtjen e programit në vlerësim. Klasat janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor;



10. FSHS është abonuar në platforma online dhe shfrytëzon bibliotekat online për nevoja mësimore dhe kërkimore, si EuroPS – Services; Publications | UNRISD; Springer; Journals.Sage Pub; Wiley dhe U-library-COBISS;
11. Studentët janë të kënaqur me klimën pozitive institucionale dhe ndërveprimin me stafin akademik të angazhuar në program;

b. Pika të dobëta:

1. Mospërputhje përsa i përket koherencës midis dokumenteve rregullatore të Institucionit, si Statuti i UT, Rregullore e UT, Rregullore e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike (2019) etj; *(Standarti I.2, kriteri 2, 3);*
2. Mospërputhje për disa kategori të veprimtarive formuese të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, me ngarkesën respektive në kredite të përcaktuar sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; *(Standarti II.1, kriteri 6);*
3. Mosmbulimi në masën 70% i ngarkesës mësimore të programit të studimit nga staf akademik efektiv, përcaktuar sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, krijon pasiguri në planifikimin e ngarkesës vjetore dhe mund të çojë në zgjidhje të detyrueshme duke angazhuar staf akademik me kontratë, ose duke rritur ngarkesën e stafit efektiv; *(Standarti II.5, kriteri 2).*
4. Një pjesë e personelit akademik me kohë të pjesshme (PAK) e angazhuar në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, rezultojnë të jetë me nivel MSc të kualifikimit. *(Standarti II.2, kriteri 3).*

Rekomandime

1. Të sigurohet koherenca e nevojshme dhe të harmonizohen përcaktimet në dokumentet rregullatore në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe programi studimor;
2. Të rishikohet rigrupimi i lëndëve në planin mësimor të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike sipas kategorive të veprimtarive formuese (A - E), dhe ngarkesës përkatëse në kredite, në përputhshmëri me aktet nënligjore në fuqi (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018);



3. Të pasqyrohet në Planin Mësimor informacioni i nevojshëm për formën e kontrollit të dijeve/shlyerjes së lëndëve/moduleve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F);
4. Institucioni të rekrutojë staf akademik efektiv, për të mbuluar ngarkesën e orëve mësimore në auditor mbi masën 70%, në përputhshmëri me aktet nënligjore në fuqi;
5. Institucioni të rekrutojë staf akademik me kontratë me nivel kualifikimi sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë";
6. Të konsiderohet në të ardhmen mundësia për të krijuar një laborator të dedikuar lëndëve me natyrë praktike në fushën e psikologjisë klinike, përfshi edhe laboratorin e informatikës;
7. Të shtohen përpjekjet institucionale për të parashikuar rritje të buxhetit për sigurimin e literaturës së nevojshme në mbështetje të programit të studimit të marrë në vlerësim;
8. Të analizohet programi nga perspektiva e dokumentit të Federatës Europiane të Psikologjisë për certifikim në psikologji dhe specializimet përkatëse që synojnë unifikimin e certifikimit të psikologëve në BE.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Psychology, with a Clinical Psychology profile"

a. Strengths and Affirmations:

1. UT/FSS has a long, consolidated experience and is regarded as a leading institution in the field of Higher Education in Albania;
2. UT/FSS/DPP that offers the second cycle study program Master of Science in Clinical Psychology, has designed clear strategies for institutional development, ensuring the quality of teaching and scientific research, expanding collaborations and partnerships at the national and international level, as well as aiming at the internationalization of the study program under evaluation;
3. UT/FSS follows clear procedures for the recruitment of academic staff;
4. The full-time academic staff covering the second-cycle Master of Science in Clinical Psychology study program are qualified with degrees and titles and demonstrate commitment to ensuring the quality of teaching and research. The academic body has academic and practical experience that adapts to the current program and the specificity of the subjects/modules it covers in the study program taken into assessment;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

5. FSS/DPP responsible for the program of study taken in the evaluation, demonstrates engagement in international projects that support the exchange of academic staff and students;
6. FSS/DPP, has implemented a cooperation agreement at the institutional level for the organization and fulfillment of the goals of professional practice, as well as other educational activities for the realization of the study program of the second cycle Master of Science in Clinical Psychology;
7. FSS/DPP demonstrates that it makes continuous efforts to be in contact with the labor market, providing students with professional practice and employment opportunities. The percentage of employed students is encouraging for the program under evaluation;
8. UT/FSS involves students in various quality improvement and decision-making processes. The relevant quality assurance structure applies periodic evaluation of courses/modules by students to provide data on teaching methods and academic staff;
9. The physical infrastructure of FSHS is suitable for the smooth running of the program under evaluation. The classrooms are equipped with the necessary logistics for the realization of the learning process;
10. FSS is subscribed to online platforms and uses online libraries for teaching and research needs, such as EuroPS - Services; Publications | UNRISD; Springer; Journals.Sage Pub; Wiley and U-library-COBISS;
11. Students are satisfied with the positive institutional climate and the interaction with the academic staff engaged in the program;

b. Weaknesses:

1. Inconsistencies in terms of coherence between the Institution's regulatory documents, such as the UT Statute, UT Regulations, Regulations of the second cycle Master of Science in Clinical Psychology (2019), etc.; (*Standard I.2, criteria 2, 3*);
2. Inconsistency for some categories of formative activities of the Master of Science in Clinical Psychology study program, with the respective load in credits determined according to CMD No. 41, dated 24.01.2018; (*Standard II.1, criterion 6*);
3. Failure to cover 70% of the teaching load of the study program by effective academic staff, determined according to CMD No. 418, dated 10.05.2017, creates uncertainty in planning the annual workload and may lead to mandatory solutions by engaging academic staff with a contract, or by increasing the workload of effective staff; (*Standard II.5, criterion 2*)

X3



4. A part of the part-time academic staff (PAS) engaged in the implementation of the Master of Science in Clinical Psychology study program, turns out to be at the MSc level of qualification; (*Standard II.2, criterion 3*)

Recommendations

1. To ensure the necessary coherence and harmonize the definitions in the regulatory documents at the university, faculty, department and study program level;
2. To revise the regrouping of subjects in the curriculum of the second cycle Master of Science in Clinical Psychology according to the categories of formative activities (A - E), and the corresponding load in credits, in compliance with the by-laws in force (CMD No. 41, dated 24.01.2018);
3. To reflect in the Curriculum the necessary information for the form of knowledge control/settlement of subjects/modules, specifying the subjects that are settled by exam (E) and the subjects/modules or practices that are settled by signature (S);
4. The institution should recruit effective academic staff, to cover the load of teaching hours in the auditorium above 70%, in compliance with the by-laws in force;
5. The institution should recruit academic staff with a contract with a qualification level according to the provisions of Law No. 80/2015 "On Higher Education and Scientific Research in the Republic of Albania";
6. To consider in the future the possibility of creating a laboratory dedicated to subjects of a practical nature;
7. To increase the institutional efforts to foresee an increase in the budget for the provision of the necessary literature in support of the study program taken in the evaluation;
8. The program should be analyzed in the perspective of the document of the European Federation of Psychology, for certification in psychology and the relevant specializations aimed at the unification of the certification of psychologists in the EU.

Handwritten signature and a circular stamp.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushjen plotësisht	Përmbushjen pjesërisht	Përmbushjen kryesisht	Përmbushjen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

XB 